



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

Numër | 10
Dhjetor | 2016

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 10

BOTUES © Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Departamenti i Analizave Ekonomike dhe i Stabilitetit Financiar
33 Garibaldi, Prishtinë 10 000
Tel: ++381 38 222 055
Fax: ++381 38 243 763

Faqja e internetit www.bqk-kos.org

Adresa elektronike economic.analysis@bqk-kos.org

KRYEREDAKTOR Arben MUSTAFA

AUTORË
Zana GJOCAJ
Krenare MALOKU BAKIJA
Arta NUSHI
Bejtush KIÇMARI
Taulant SYLA
Arta HASHIMI

REDAKTOR TEKNIK Butrint BOJAJ

SHKURTESAT:

| | |
|--------|--|
| AJN | Asetet e Jashtme Neto |
| APR | Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut |
| ASK | Agjencia e Statistikeve të Kosovës |
| ATM | Bankomatë (<i>anglisht: Automated Teller Machines</i>) |
| ATP | Agjensionet për Transferimin e Parave |
| BERZH | Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim |
| BPV | Bruto Produkti Vendor |
| BQE | Banka Qendrore Evropiane |
| BQK | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës |
| CIS | Commonwealth of Independent States |
| DST | Të Drejtat Speciale të Tirazhit |
| EJL | Evropa Juglindore |
| EQL | Evropa Qendrore dhe Lindore |
| FKPK | Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës |
| FMN | Fondi Monetar Ndërkombëtar |
| HHI | Indeksi Herfindahl-Hirschman |
| IHD | Investimet e Huaja Direkte |
| IMF | Institucionet Mikro-Financiare |
| KJP | Kreditë joperformuese |
| KMA | Kthimi Mesatar në Asete |
| KMK | Kthimi Mesatar në Kapital |
| KNK | Kthimi në Kapital |
| KTD | Korporatat Tjera Depozituese |
| MEF | Ministria e Financave |
| MNI | Margjina Neto e Interesit |
| OJSHEF | Organizatat Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare |
| POS | Pika të Shitjes (<i>anglisht: Point of Sales</i>) |
| pp | Pikë Përqindje |
| PPT | Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë |
| PTK | Posta dhe Telekomit i Kosovës |
| RLI | Indeksi i Sundimit të Ligjit (<i>angl.: Rule of Law Index</i>) |
| TMK | Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit |
| TVSH | Tatimi mbi Vlerën e Shtuar |

Vërejtje: Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2016),
Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 10, Prishtinë: BQK.
Çdo korigjim i nevojshëm bëhet në verzionin elektronik.

PËRMBAJTJA:

| | |
|--|-----|
| 1. Fjala e Guvernatorit | 13 |
| 2. Përmbledhje | 15 |
| Vlerësimi i përgjithshëm i rreziqeve ndaj stabilitetit financiar | 19 |
| 3. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor | 21 |
| 4. Ekonomia e Kosovës | 30 |
| 5. Sistemi Financiar i Kosovës | 36 |
| 5.1. Karakteristikat e Përgjithshme | 36 |
| 5.2. Ekspozimi ndaj sektorit të jashtëm | 37 |
| 6. Sektori Bankar i Kosovës | 40 |
| 6.1. Struktura e Sektorit Bankar | 40 |
| 6.2. Aktiviteti i Sektorit Bankar | 41 |
| 6.3. Performanca e Sektorit Bankar | 54 |
| 6.4. Rreziqet e Sektorit Bankar | 57 |
| 6.5. Analiza Stres-Test | 70 |
| 6.6. Infrastruktura Financiare në Kosovë | 75 |
| 7. Sektori Pensional | 78 |
| 8. Sektori i Sigurimeve | 81 |
| 8.1. Aktiviteti i sektorit të sigurimeve | 81 |
| 8.2. Performanca financiare e sektorit të sigurimeve | 83 |
| 9. Sektori mikrofinanciar dhe Ndihmësit Financiar | 84 |
| 9.1. Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar | 84 |
| 9.2. Performanca e sektorit mikrofinanciar | 88 |
| 9.3. Ndihmësit Financiar | 89 |
| 10. Shtojca statistikore | 91 |
| 11. Referencat | 111 |

| | |
|--|-----------|
| LISTA E FIGURAVE | 19 |
| Figura 1. Harta e stabilitetit financiar | 19 |
| Figura 2. Rritja vjetore e BPV-së në eurozonë | 21 |
| Figura 3. Shkalla e inflacionit në eurozonë | 21 |
| Figura 4. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së | 22 |
| Figura 5. Rritja vjetore e kreditimit dhe shkalla e KJP-ve në vendet kryesore në eurozonë | 22 |
| Figura 6. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar në vendet kryesore të eurozonës | 22 |
| Figura 7. Rritja vjetore e kredive dhe depozitave në vendet e rajonit | 23 |
| Figura 8. Norma e këmbimit të euros ndaj valutave kryesore | 24 |
| Figura 9. Struktura e aseteve të PCH-së | 25 |
| Figura 10. Ecuria e kredive dhe depozitave të PCH –së | 25 |
| Figura 11. Treguesit e efikasitetit të PCH –së | 26 |
| Figura 12. Struktura e aseteve të RBI-së | 27 |
| Figura 13. Ecuria e kredive dhe depozitave të RBI-së | 27 |
| Figura 14. Treguesit e efikasitetit të RBI-së | 27 |
| Figura 15. Struktura e aseteve të NLB Group | 28 |
| Figura 16. Ecuria e kredive dhe depozitave të NLB group | 29 |
| Figura 17. Treguesit e efikasitetit të NLB Group | 29 |
| Figura 18. Ndryshimi mesatar vjetor i IÇK-së | 30 |
| Figura 19. Importet eksportet dhe bilanci tregtar | 31 |
| Figura 20. Pranimet e remitencave | 32 |
| Figura 21. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve | 32 |
| Figura 22. Ecuria e tregut të letrave me vlerë | 33 |
| Figura 23. Shuma e shpallur dhe e ofertuar | 33 |
| Figura 24. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë sipas afatit të maturimit | 34 |
| Figura 25. Normat mesatare të interesit të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës sipas maturimit | 34 |
| Figura 26. Raporti i mbulimit shumë e ofertuar/shumë e shpallur në vendet e rajonit | 34 |
| Figura 27. Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë të qeverive në vendet e rajonit | 35 |
| Figura 28. Struktura e aseteve të sistemit financiar | 36 |
| Figura 29. Ndërmjetësimi financiar sipas sektorëve | 36 |
| Figura 30. Ndërmjetësimi financiar i sektorit bankar në vendet e Ballkanit Perëndimor | 36 |
| Figura 31. AJN-të sipas sektorëve financiarë | 37 |
| Figura 32. Ekspozimi i jashtëm sipas sektorëve financiar | 37 |
| Figura 33. Struktura e aseteve në sektorin e jashtëm | 38 |
| Figura 34. Struktura e detyrimeve të jashtme | 38 |
| Figura 35. Struktura e aseteve të sektorit bankar | 40 |
| Figura 36. Shkalla e koncentrimit në sektorin bankar | 40 |
| Figura 37. Struktura e aseteve të sektorit bankar | 41 |
| Figura 38. Asetet e sektorit bankar | 41 |

| | |
|--|----|
| Figura 39. Struktura e letrave me vlerë ----- | 42 |
| Figura 40. Kontributi i sektorëve në rritjen e gjithsej kredive----- | 42 |
| Figura 41. Struktura e kredive sipas sektorëve në vendet e rajonit ----- | 42 |
| Figura 42. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike----- | 43 |
| Figura 43. Kreditë sipas veprimtarisë ekonomike ----- | 43 |
| Figura 44. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit ----- | 44 |
| Figura 45. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit për ndërmarrje dhe ekonomi familjare - | 44 |
| Figura 46. Gjithsej kreditë dhe kreditë e reja ----- | 45 |
| Figura 47. Kreditë e reja ----- | 45 |
| Figura 48. Kreditë e reja sipas sektorëve----- | 45 |
| Figura 49. Kreditë e reja sipas sektorëve dhe qëllimit të përdorimit ----- | 45 |
| Figura 50. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve të nërmarrjeve ---- | 46 |
| Figura 51. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kredite ndaj ndërmarrjeve ----- | 47 |
| Figura 52. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet----- | 47 |
| Figura 53. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve nga ekonomitë familjare ----- | 47 |
| Figura 54. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ekonomive familjare ----- | 48 |
| Figura 55. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare ----- | 48 |
| Figura 56. Depozitat e e sektorit bankar ----- | 49 |
| Figura 57. Depozitat e ndërmarrjeve ----- | 49 |
| Figura 58. Depozitat e e jorezidentëve----- | 50 |
| Figura 59. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit----- | 50 |
| Figura 60. Depozitat e afatizuara ----- | 50 |
| Figura 61. Norma mesatare e interesit ----- | 51 |
| Figura 62. Normat mesatare të interesit në Kosovë dhe në vendet e rajonit ----- | 51 |
| Figura 63. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare | 51 |
| Figura 64. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas qëllimit----- | 52 |
| Figura 65. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas maturimit----- | 52 |
| Figura 66. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas veprimtarisë ekonomike ----- | 52 |
| Figura 67. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare, sipas qëllimit----- | 53 |
| Figura 68. Norma mesatare e interesit në depozita----- | 53 |
| Figura 69. Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve ----- | 53 |
| Figura 70. Normat mesatare të interesit në depozitat e ekonomive familjare ----- | 54 |
| Figura 71. Performanca financiare e sektorit bankar ----- | 54 |
| Figura 72. Struktura e të hyrave të sektorit bankar----- | 54 |
| Figura 73. Shpenzimet e sektorit bankar ----- | 55 |
| Figura 74. Shpenzimet e sektorit bankar, ndryshimi vjetor----- | 55 |
| Figura 75. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar----- | 56 |
| Figura 76. Raporti shpenzime/ të hyra ----- | 56 |

| | |
|---|----|
| Figura 77. Kreditë dhe depozitat e sektorit bankar----- | 58 |
| Figura 78. Raporti asete likuide “gjithëpërfshirëse”/detyrime afatshkurtra ----- | 58 |
| Figura 79. Rezervat e sektorit bankar ----- | 59 |
| Figura 80. Hendeku i likuiditetit ----- | 59 |
| Figura 81. Raporti KJP/gjithsej kreditë ----- | 60 |
| Figura 82. Gjithsej kreditë dhe KJP-të----- | 60 |
| Figura 83. Raporti KJP/gjithsej kreditë në Kosovë dhe në disa vende të Ballkanit Perëndimor | 60 |
| Figura 84. KJP-të sipas veprimtarisë ekonomike ----- | 61 |
| Figura 85. Struktura e kredive sipas klasifikimit----- | 61 |
| Figura 86. KJP-të dhe provionet ----- | 61 |
| Figura 87. Koncentrimi i rrezikut kreditor ----- | 62 |
| Figura 88. Kapitalizimi i sektorit bankar ----- | 62 |
| Figura 89. Kapitali rregullator dhe APR-të ----- | 62 |
| Figura 90. TMK në sektorin bankar në Kosovë dhe në vendet e rajonit ----- | 63 |
| Figura 91. Struktura e kapitalit rregullator ----- | 63 |
| Figura 92. Struktura e kapitalit të klasit të parë ----- | 63 |
| Figura 93. Struktura e kapitalit të klasit të dytë----- | 64 |
| Figura 94. Raporti i APR-ve ngaj gjithsej aseteve të sektorit ----- | 64 |
| Figura 95. Struktura e APR-ve sipas peshës së rrezikut ----- | 64 |
| Figura 96. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë ----- | 66 |
| Figura 97. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj ----- | 66 |
| Figura 98. Hendeku i aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit----- | 67 |
| Figura 99. Asetet e sektorit pensional ----- | 78 |
| Figura 100. Kontributet e arkëtuara sipas fondeve të pensionale ----- | 78 |
| Figura 101. Struktura e investimeve të sektorit pensional----- | 79 |
| Figura 102. Përformanca financiare e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës----- | 79 |
| Figura 103. Përformanca financiare e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve ----- | 79 |
| Figura 104. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve ----- | 81 |
| Figura 105. Asetet e sektorit të sigurimeve ----- | 81 |
| Figura 106. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve ----- | 81 |
| Figura 107. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve ----- | 82 |
| Figura 108. Bruto primet e arkëtuara ----- | 82 |
| Figura 109. Struktura e primeve bruto të shkruara----- | 82 |
| Figura 110. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara ----- | 83 |
| Figura 111. Dëmet e paguara ----- | 83 |
| Figura 112. Asetet e sektorit mikrofinanciar----- | 84 |
| Figura 113. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar ----- | 85 |
| Figura 114. Kreditë ndaj ekonomive familjare sipas maturimitetit ----- | 85 |
| Figura 115. Struktura e kredive ndaj ndërmarrjeve ----- | 85 |
| Figura 116. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve----- | 86 |

| | |
|--|----|
| Figura 117. Kreditë ndaj ndërmarrjeve sipas maturitetit ----- | 86 |
| Figura 118. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar ----- | 86 |
| Figura 119. Struktura e lizingut----- | 87 |
| Figura 120. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar ----- | 87 |
| Figura 121. Norma mesatare e interesit në kredi ----- | 87 |
| Figura 122. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar ----- | 88 |
| Figura 123. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar ----- | 88 |
| Figura 124. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore ----- | 88 |

LISTA E TABELAVE ----- 37

| | |
|--|----|
| Tabela 1. Numri i institucioneve financiare ----- | 37 |
| Tabela 2. Struktura e aseteve të sektorit bankar ----- | 41 |
| Tabela 3. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake të sektorit bankar----- | 49 |
| Tabela 4. Tregues kyç të efikasitetit të sektorit bankar----- | 56 |
| Tabela 5. Tregues të kapacitetit të sektorit bankar----- | 57 |
| Tabela 6. Indikatorët e rreziqeve të sektorit bankar----- | 57 |
| Tabela 7. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë - | 67 |
| Tabela 8. Rezultatet e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë----- | 69 |
| Tabela 09. Përmbledhje e rezultateve të stres-testit: rreziku kreditor ----- | 73 |
| Tabela 10. Përmbledhje e rezultateve të stres-testit: rreziku i likuiditetit----- | 74 |
| Tabela 11. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SEKN-së ---- | 75 |
| Tabela 12. Rrjeti i sektorit bankar ----- | 77 |
| Tabela 13. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela ----- | 77 |
| Tabela 14. Struktura e sektorit pensional----- | 78 |

LISTA E KUTIVE ----- 25

| | |
|--|----|
| Kutia 1. Performanca e grupeve më të mëdha bankare që operojnë në Kosovë ----- | 25 |
| Kutia 2. Identifikimi i bankave me rëndësi sistemike në Kosovë ----- | 67 |

1. Fjala e Guvernatorit

Ambienti i jashtëm makroekonomik gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 u karakterizua me zhvillime pozitive, ku masat lehtësuese të ndërmarra nga Banka Qendrore Evropiane (BQE) ndikuan në rikuperimin e kreditimit dhe përsheptimin e rritjes ekonomike. Norma e inflacionit, megjithatë, vazhdoi të mbetet në nivel më të ulët se sa objektivi i BQE-së. Zhvillime të ngjashme karakterizuan edhe vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, të cilat në përgjithësi shënuan rritje të aktivitetit të sistemit financiar dhe rritje të përsheptuar të ekonomisë.

Ekonomia e Kosovës ka vazhduar të shënojë normë pozitive të rritjes ekonomike edhe gjatë vitit 2016. Burimet kryesore të financimit të rritjes ekonomike ishin burimet e brendshme si kreditimi bankar dhe shpenzimet publike, përderisa të hyrat nga sektori i jashtëm u karakterizuan me një performancë më të pafavorshme si pasojë e rënies së eksporteve, remitencave dhe investimeve të huaja direkte. Kosova vazhdon të ketë shkallë të kënaqshme të stabilitetit fiskal, të shprehur përmes raporteve relativisht të ulëta të deficitit buxhetor dhe borxhit publik ndaj Bruto Produktit Vendor. Zhvillimet në nivelin e përgjithshëm të çmimeve kanë vazhduar të jenë reflektim i zhvillimeve të çmimeve në sektorin e jashtëm, duke u karakterizuar me preisone të lehta deflacioniste.

Sektori bankar i Kosovës vazhdoi të zgjerojë aktivitetin ndërmjetësues me një ritëm të përsheptuar, duke rritur kështu rolin e tij në financimin e ekonomisë së vendit. Rritja e vazhdueshme e konkurrencës dhe gjendja e shëndoshë e sektorit bankar ka luajtur rol të rëndësishëm në lehtësimin e standardeve kreditore dhe përmirësimin e kushteve kreditore nga bankat, ku duhet theksuar vazhdimin e rënies së normës së interesit në kredi e cila tashmë gjendet në nivel të përafërt me mesataren e vendeve tjera të rajonit. Këto zhvillime kanë lehtësuar në masë të konsiderueshme qasjen në financimin bankar dhe kanë nxitur rritjen e kërkesës për kredi. Sektori bankar i Kosovës ka vazhduar të financojë aktivitetin e tij kryesisht përmes depozitave të mbledhura brenda vendit, rrjedha e të cilave ka mundësuar zgjerimin e qëndrueshëm të aktivitetit kreditor. Megjithatë, rënia e normës së interesit në depozita në vitet e fundit ka nxitur ndryshimin e strukturës së depozitave në favor të depozitave të transferueshme, gjë që mund të paraqet vështirësi për rritjen e kreditimit afatgjatë nga bankat. Bankat që operojnë në Kosovë kanë vazhduar të avancojnë infrastrukturën financiare, ku po vërehet rritje e vazhdueshme e shërbimeve bankare dixhitale, të cilat mundësojnë qasje më të lehtë dhe me kosto më të ulët për shfrytëzuesit e tyre. Transaksionet bankare të realizuara përmes këtyre shërbimeve po shënojnë rritje të konsiderueshme, gjë që flet për rritje të depërtimit të këtyre shërbimeve te qytetarët dhe bizneset.

Sektori bankar vazhdon të ketë normë të kënaqshme të profitabilitetit, gjë e cila paraqet një shtyllë të rëndësishme mbi të cilën bazohet shkalla e lartë e qëndrueshmërisë që ka ky sektor. Norma e kapitalizimit dhe e likuiditetit vazhdojnë të qëndrojnë në nivele mjaft më të larta se sa normat minimale të kërkuara nga Banka Qendrore, gjë që tregon për kapacitetin e lartë që ka sektori bankar për të përballuar tronditje të mundshme. Norma, edhe ashtu mjaft e ulët, e kredive joperformuese shënoi rënie të mëtejme gjatë vitit 2016, duke përforcuar edhe më shumë qëndrueshmërinë e sektorit bankar. Ekspozimi i ulët ndaj valutave të huaja, si dhe normat kryesisht fikse të interesit si në kredi ashtu edhe në depozita, kanë bërë që ekspozimi i këtij sektori ndaj rrezikut të tregut të jetë mjaft i ulët.

Ngjashëm me sektorin bankar, rritje e aktivitetit është regjistruar edhe te komponentët tjerë të sistemit financiar të Kosovës, duke përfshirë fondet pensionale, kompanitë e sigurimeve dhe institucionet mikrofinanciare. Investimet e fondeve pensionale gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 u karakterizuan me performancë pozitive, duke kontribuar kështu në rritjen e vlerës së kursimeve pensionale të qytetarëve. Performancë më të brishtë financiare vazhdon të ketë

sektori i sigurimeve, i cili edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 u ballafaqua me humbje. Ndërsa, sektori mikrofinanciar shënoi rritje të theksuar të kreditimit dhe përmirësim të treguesve të profitabilitetit, gjë që flet për një përmirësim të theksuar të performancës së përgjithshme të këtij sektori.

Raporti i Stabilitetit Financiar paraqet një nga publikimet e rregullta të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, i cili në baza gjysëmvetore i ofron publikut një vlerësim të stabilitetit financiar në Kosovë përmes analizës së detajuar të zhvillimeve ekonomike e financiare relevante për stabilitetin financiar.

Bedri HAMZA

Guvernator

2. Përmbledhje

Aktiviteti ekonomik në eurozonë gjatë vitit 2016 është rikuperuar gradualisht, mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme. Norma mesatare e rritjes reale në eurozonë në gjysmën e parë të vitit 2016 ishte rreth 1.7 përqind (1.5 përqind në gjysmën e parë të vitit 2015). Rikuperimi i vazhdueshëm i aktivitetit në eurozonë është ndikuar pozitivisht nga përmirësimi i kushteve të financimit, kryesisht si rezultat i politikave ekspansioniste dhe masave jokonvencionale të ndërmarra nga BQE, si dhe përmirësimit të kushteve në tregun e punës dhe çmimeve të ulëta të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare. Përforsimi i kërkesës në eurozonë është reflektuar pozitivisht në zhvillimet ekonomike të vendeve në Ballkanin Perëndimor. Mbështetur kryesisht nga rritja e eksporteve dhe investimeve, në gjashtëmujorin e parë 2016, vendet në Ballkanin Perëndimor janë karakterizuar me një rritje mesatare të BPV-së prej rreth 3 përqind.

Eurozona u karakterizua me presione të dobëta inflacioniste gjatë vitit 2016, përderisa në gjysmën e parë të vitit 2016, shkalla mesatare e inflacionit ishte rreth 0.6 përqind. Ndikimi i politikave ekspansioniste monetare në nivelin e çmimeve në eurozonë ka rezultuar të jetë i kufizuar, kryesisht si pasojë e rënies së theksuar të çmimeve të energjisë gjatë vitit 2016. Ngjashëm me eurozonën, vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizuan me presione të dobëta inflacioniste, që kryesisht i atribuohen zhvillimeve të çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2016, shkalla mesatare e inflacionit në vendet në Ballkanin Perëndimor ishte rreth 0.2 përqind.

Mbështetur kryesisht nga rritja e kërkesës për kredi dhe përmirësimi i kushteve të kreditimit, aktiviteti kreditues në eurozonë është rikuperuar gjatë vitit 2016 dhe ka shënuar një rritje vjetore prej 2.7 përqind në qershor 2016. Gjithashtu, indikatorët e profitabilitetit dhe indikatorët kryesor të shëndetit financiar shënuan përmirësim gjatë vitit 2016 kundrejt vitit paraprak. Vendet kryesore të eurozonës u karakterizuan me nivel të kënaqshëm të likuiditetit në sektorin bankar si dhe me përmirësim të cilësisë së portfolios kreditorë. Ngjashëm me vendet në eurozonë, gjatë gjysmës së parë të vitit 2016, kreditimi në vendet e Ballkanit Perëndimor shënoi rritje, kryesisht si rezultat i standardeve më të lehtësuara të kreditimit nga bankat si dhe rritjes së kërkesës për kredi. Edhe indikatorët kyç të shëndetit financiar gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 u karakterizuan me ecuri pozitive.

Ekonomia e Kosovës u karakterizua me zgjerim të aktivitetit gjatë vitit 2016 kundrejt vitit paraprak. Sipas vlerësimeve preliminare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, vlera nominale e BPV-së në gjashtë muajt e parë të vitit 2016 arriti në 2.73 miliard euro, që në terma real, përkon me një rritje mesatare vjetore prej 3.5 përqind. Aktiviteti i përgjithshëm në vend u mbështet kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme, përderisa neto eksportet ndikuan negativisht në normën e rritjes ekonomike. Në gjysmën e parë të vitit 2016, rritja reale e ekonomisë së Kosovës është mbështetur kryesisht nga rritja në aktivitetin e sektorit të ndërtimitarisë, sektorit të hoteleve dhe restoranteve, transportit dhe magazinimit, tregtisë, etj., përderisa rënie të aktivitetit vlerësohet të kenë shënuar industria nxjerrëse, afarizmi me pasuri të patundshme dhe administrimi publik. Për vitin 2016, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se norma reale e rritjes ekonomike do të jetë rreth 3.6 përqind.

Ngjashëm me eurozonën dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2016, zhvillimet në nivelin e përgjithshëm të çmimeve në Kosovë u karakterizuan me presione të lehta deflacioniste me ç'rast norma e inflacionit ishte -0.02 përqind. Kosova vazhdon të ketë pozicion të qëndrueshëm fiskal. Në qershor 2016, buxheti i Kosovës regjistroi bilanc pozitiv buxhetor prej rreth 20.3 milionë euro, krahasuar me bilancin negativ buxhetor prej rreth 21.1

milione euro të shënuar deri në qershor të vitit 2015. Në këtë periudhë, borxhi publik arriti në 821.9 milionë euro, ndërsa si përqindje e BPV-së, në 13.8 përqind.

Përderisa vlera e shtuar nga sektorët prodhues në vend mbetet e ulët, rritja e kërkesës së brendshme është përkthyer në rritje të importit, duke ndikuar kështu në rritjen e deficitit të llogarinë rrjedhëse. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale arriti vlerën prej 327.0 milionë euro, një rritje prej 57.6 përqind krahasuar me vitin paraprak, kryesisht si pasojë e rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarive të të ardhurave parësore dhe dytësore. Në anën tjetër, bilanci pozitiv në llogarinë e shërbimeve shënoi rritje. Gjatë vitit 2016, sektori i jashtëm i Kosovës u karakterizua me rënie të remitencave të pranuar në vend dhe rënie të Investimeve të Huaja Direkte (IHD). Pas tre vitesh rritjeje të vazhdueshme, remitencat e pranuar në vend u karakterizuan me një rënie vjetore prej 2.7 përqind dhe shënuan vlerën prej 329.8 milionë euro në qershor 2016. Në të njëjtën periudhë, vlera e IHD-ve të pranuar në Kosovë rezultoi të jetë përgjysmuar në 84.8 milionë euro, nga 161.7 milionë euro sa ishte në qershor të vitit 2015.

Spektori financiar i Kosovës gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 u karakterizua me rritje të qëndrueshme të aktivitetit në të gjithë sektorët përbërës. Rrjedhimisht, shkalla e ndërmjetësimit financiar në Kosovë, e shprehur si raport i aseteve të sistemit financiar ndaj BPV-së, ka arritur në 85.1 përqind nga 82.5 përqind sa ishte një vit më parë. Sektori bankar kishte kontributin kryesor në rritjen e aktivitetit të sektorit financiar. Kreditimi i sektorit bankar përshejtoi rritjen vjetore në 8.4 përqind, duke arritur kështu vlerën prej 2.17 miliardë euro. Kreditë për ekonomi familjare, kryesisht ato konsumuese, kishin kontributin kryesor në rritjen e gjithsej kreditimit, përderisa rritje shënuan edhe kreditë për ndërmarrje. Zhvillimet në kreditimin e ekonomive familjare reflektojnë si kërkesën më të lartë për kredi konsumuese ashtu edhe lehtësimin e standardave kreditore të ndikuara nga rritja e konkurrencës në tregun kreditor në vend. Ndërsa, aktiviteti kreditues ndaj ndërmarrjeve është karakterizuar me shtërngim të standardeve të kreditimit. Kreditë për ndërmarrje vazhdojnë të dominojnë strukturën e gjithsej kredive, në kuadër të cilave kreditë për sektorin e tregtisë përbëjnë kategorinë kryesore me pjesëmarrje prej 51.9 përqind. Kreditë për sektorin e tregtisë shënuan ngadalësim të rritjes gjatë kësaj periudhe, ndërsa sektorët ekonomik të cilët përgjithësisht kanë pjesëmarrje më të ulët në kreditimin bankar, siç janë sektori i shërbimeve financiare dhe patundshmërive, sektori i minierave si dhe ai i bujqësisë shënuan rritje të theksuar. Sektori i bujqësisë, përkundër rritjes së lartë në vitet e fundit, vijon të ketë pjesëmarrje të ulët në gjithsej kreditimin bankar. Në aspektin e maturimit, kreditë me maturitet më të gjatë kanë vazhduar të rrisin pjesëmarrjen si rezultat i rritjes së kërkesës për kredi më të gjata si dhe përmirësimit të kushteve kreditore nga ana e bankave të cilat kanë rritur afatin e maturimit të ofruar.

Burim kryesor i financimit të aktivitetit të sektorit bankar vazhdojnë të jenë depozitat, të cilat arritën vlerën 2.69 miliardë euro duke shënuar rritje vjetore prej 4.6 përqind. Ritmi i rritjes së depozitave shënoi ngadalësim për të dytin vit me radhë, me ç'rast depozitat e ndërmarrjeve u karakterizuan me ngadalësim më të theksuar të normës së rritjes. Depozitat e afatizuara, të cilat deri në gjysmën e dytë të vitit 2015 dominonin strukturën e depozitave sipas maturitetit, vazhduan rënien por me ritëm më të ngadalshëm. Ndërsa, depozitat e transferueshme, të cilat tani përbëjnë mbi 50 përqind të depozitave të sektorit, vazhduan të rrisin pjesëmarrjen në gjithsej depozitat. Rënia e depozitave të afatizuara është rezultat i ambientit me norma të ulëta të interesit në depozita që ka dekurajuar afatizimin e depozitave nga depozitorët.

Norma mesatare e interesit në kredi vazhdoi trendin rënës edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2016, ndërsa norma mesatare e interesit në depozita shënoi rritje të lehtë për të dytin vit me radhë. Norma mesatare e interesit për kreditë e reja zbriti në 7.2 përqind nga 7.6 përqind sa ishte në qershor të vitit të kaluar, përderisa norma mesatare e interesit në depozita u ngrit në

1.0 përqind nga 0.8 përqind. Rënia më e theksuar e normës së interesit në kredi ndikoi që diferenca në mes të normës së interesit në kredi dhe normës së interesit në depozita të zvogëlohet në 6.2 përqind nga 6.8 përqind në qershor 2015. Normat mesatare të interesit në kredi dhe depozita në sektorin bankar të Kosovës qëndrojnë në nivel të përafërt me mesataren e normave të interesit të vendeve të rajonit.

Treguesit e performancës dhe shëndetit financiar vazhdojnë të reflektojnë shkallë të lartë të stabilitetit të sektorit. Profiti i realizuar gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 arriti në 37.7 milionë euro, që paraqet rënie krahasuar me vitin paraprak i cili shënoi vitin me profitin më të lartë historik të sektorit. Megjithatë, treguesit e profitabilitetit si Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) qëndruan në nivel të lartë, në 2.5 dhe 20.6 përqind respektivisht, që janë dukshëm më të lartë se niveli i rajonit Pozita e likuiditetit të sektorit bankar vazhdon të jetë në nivel të qëndrueshëm, përkundër rritjes së përshpejtuar të kreditimit që ndikoi në rritjen e raportit të kredive ndaj depozitave në 80.7 përqind. Raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra qëndroi në 41.5 përqind, që është mjaft mbi minimumin rregullator prej 25 përqind. Pozita e kapitalizimit të sektorit vazhdon të reflektojë qëndrueshmëri dhe aftësi të lartë të sektorit bankar për të përballuar humbjet potenciale. Treguesi i kapitalizimit zbriti lehtësisht në 18.7 përqind si rezultat i rënies së kapitalit të klasit të dytë, por cilësia e kapitalit rregullativ është rritur si rezultat i rritjes së kapitalit të klasit të parë të mbështetur nga profiti i akumuluar ndër vite. Pjesëmarrja e kapitalit të klasit të parë në gjithsej kapitalin rregullativ në qershor 2016 arriti në 87.5 përqind nga 83.6 një vit më parë.

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor ka vazhduar të bie, duke u pasqyruar me rënie të mëtejme të normës së kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në 5.3 përqind, të ndikuar si nga rritja më e lartë e kredive ashtu edhe nga përmirësimi i kualitetit të kredive. Po ashtu, mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizione për humbje nga kreditë është rritur në 119.9 përqind, që tregon për mbrojtje të mirë të sektorit nga humbjet e mundshme nga kreditë. Norma e kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në qershor 2016 ishte në nivelin më të ulët që nga fundi i vitit 2010, si dhe vazhdon të mbetet në nivelin më të ulët krahasuar me vendet e rajonit që mesatarisht kanë një normë të KJP-ve prej 14.9 përqind.

Ekspozimi ndaj rrezikut të tregut vazhdon të jetë i ulët. Raporti i pozicionit të agreguar neto të hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë ka shënuar rritje në 1.8 përqind, por që mbetet në nivel të ulët krahasuar me nivelin maksimal të lejuar rregullator prej 30 përqind. Kreditë në valutë të huaj kanë shënuar rënie duke zvogëluar pjesëmarrjen, edhe ashtu mjaft të ulët, në gjithsej kreditë në 0.2 përqind në qershor 2016. Kreditë dhe depozitat ndikohen nga lëvizjet e normave të interesit kryesisht vetëm në maturim për faktin se bartin normë fikse të interesit. Hendeku negativ për intervalin e shkurtër të maturimit 'deri në 30 ditë' është ngushtuar në krahasim me vitin paraprak, gjë që ulë ekspozimin e sektorit bankar ndaj rrezikut të rritjes së mundshme të normës së interesit. Ndërsa, hendeku kumulativ deri në 1 vit rezultoi pozitiv dhe më i gjerë krahasuar me periudhën paraprake, duke e rritur ekspozimin ndaj rrezikut të rënies së mundshme të normës së interesit.

Bankat kanë krijuar sistem, politika dhe procedura të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut operacional. Edhe në gjysmën e parë të vitit 2016, ky rrezik është menaxhuar në mënyrë adekuate duke mos pasur raste të materializimit të tij, dhe duke ndarë kapitalin e nevojshëm për mbulimin e këtij rreziku në pajtueshmëri me kërkesat rregullatore.

Po ashtu, rezultatet e analizës stres-test vazhdojnë të sygjerojnë aftësi të lartë të sektorit bankar për të përballuar tronditjet e mundshme në kualitetin e portofolit kreditor dhe në nivelin e kapitalizimit, që mund të pasojnë nën skenarët hipotetik të rritjes së normës së KJP-ve, zhvlerësimit të euros, zvogëlimit të normave të interesit për asetet dhe rritjen e normave të interesit për detyrimet si dhe dështimit të kredimarrësve më të mëdhenjë. Poashtu, sektori

bankar ka treguar aftësi për të ruajtur gjendjen e likuiditetit nën supozime hipotetike të tërheqjeve të konsiderueshme të depozitave.

Infrastruktura bankare gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 vazhdoi të zgjerohet. Rritja e numrit të bankomatëve rezultoi me rritje të numrit dhe vlerës së tërheqjeve përmes bankomatëve, ndërsa rritja e numrit të pajisjeve POS rezultoi në rritje të numrit të transaksioneve të shitjeve përmes POS-ve, mirëpo në vlerë më të ulët krahasuar më vitin paraprak. Gjatë kësaj periudhe, numri i transaksioneve të kryera përmes sistemit ndërbankar të pagesave në Kosovë u rrit për 16.1 përqind duke arritur në 5.4 milionë, ndërsa vlera e transaksioneve të kryera u rrit për 15.7 përqind dhe arriti në 3.9 miliardë euro. Po ashtu, është shënuar rritje e numrit të gjithsej llogarive bankare, llogarive bankare E-banking, si dhe numrit të kartelave debitore dhe kreditore. Të gjitha këto zhvillime ndikuan në rritjen e efikasitetit të shërbimeve bankare.

Me rritje të aktivitetit u karakterizuan edhe sektorët tjerë përbërës të sistemit financiar, që përfshijnë sektorin pensional, sektorin e sigurimeve dhe sektorin e institucioneve mikrofinanciare. Sektori pensional vazhdoi të ketë rritje të aseteve, ku vlera e aseteve të sektorit deri në qershor 2016 arriti në 1.33 miliard euro duke shënuar rritje vjetore prej 12.4 përqind. Sektori pensional gjithashtu vazhdoi të shënojë performancë të mirë financiare, me rritje të çmimit të aksionit në mjetet e investuara dhe rrjedhimisht kthim pozitiv nga investimet. Sektori i sigurimeve ka shënuar rritje të aktivitetit, ku në qershor 2016 vlera e aseteve të sektorit arriti në 163.6 milionë euro, që përkon me rritje vjetore prej 8.3 përqind. Mirëpo, performanca financiare e këtij sektori vazhdon të jetë jo e kënaqshme si rezultat i humbjes së realizuar edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2016. Sektori mikrofinanciar është sektori me rritjen më të madhe të aseteve në sistemin financiar, ku deri në qershor 2016 u karakterizua me rritje të theksuar vjetore prej 16.9 përqind, duke arritur vlerën 136.0 milionë euro. Po ashtu, në këtë vit sektori mikrofinanciar u karakterizua me përmirësim të performancës financiare në krahasim me tre vitet e fundit, duke realizuar rritje të profitit, gjë që u pasqyrua në përmirësimin e indikatorëve të profitabilitetit.

Vlerësimi i përgjithshëm i rreziqeve ndaj stabilitetit financiar

Zhvillimet në treguesit kryesor të rreziqeve ndaj stabilitetit financiar të Kosovës janë përmbledhur në figurën 1, që paraqet Harta e Stabilitetit Financiar të Kosovës.¹ Harta e stabilitetit prezanton në mënyrë grafike lëvizjen e shkallës së rrezikut në kategoritë kryesore të rrezikut ndaj stabilitetit financiar si dhe mundëson krahasimin me notën mesatare historike të rrezikut për kategoritë përkatëse. Rritja e distancës nga qendra e hartës për treguesit reflekton rritje të rrezikut dhe zvogëlim të aftësisë për përballimin e goditjeve ndaj stabilitetit financiar dhe anasjelltas.

Në përgjithësi, gjysma e parë e vitit 2016

është karakterizuar me rënie të rrezikut në shumicën e treguesve në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, me ç'rast niveli i rrezikut të shumicës së treguesve gjithashtu qëndroi mjaft nën nivelin mesatar historik të rrezikut.


Rreziku ndaj stabilitetit financiar që buron nga ekonomia e jashtme ka shënuar rënie të lehtë në vitin 2016 si pasojë e rritjes më të lartë të BPV-së së partnerëve tregtarë në TM1 2016 dhe rënies së mëtejme të normave bazë të interesit. Në përgjithësi, rreziku për stabilitetin financiar nga ekonomia e jashtme mbetet në nivel të ulët, duke qëndruar mjaft nën nivelin mesatar historik.

Rreziku nga ekonomia e brendshme është zhvendosur drejt qendrës në TM2 2016 duke shënuar rënie. Kjo rënie e rrezikut i atribuohet hendekut më të ulët të BPV-së krahasuar me TM2 2015. Rënie e rrezikut është shënuar edhe nga zhvillimet në kursin valutor që u karakterizuan me më pak luhajtje. Ndërsa, borxhi i jashtëm i Kosovës dhe deficit i llogarisë rrjedhëse janë rritur. Rreziku nga inflacioni gjithashtu ka treguar tendencë rritëse në TM2 2016 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ndërsa rreziku nga ambienti ligjor mbetet në nivel të njëjtë. Përkundër rënies së rrezikut të përgjithshëm në vitin e fundit, ai mbetet në nivel pak më të lartë se niveli mesatar historik.

Rreziku që buron nga ekonomitë familjare ka shënuar ngritje të lehtë në vitin 2016, por që mbetet nën nivelin mesatar historik. Ndërsa, rreziku nga ndërmarrjet dhe qeveria është zhvendosur drejt qendrës duke shënuar rënie. Rritja e rrezikut për ekonomitë familjare buron kryesisht nga remitencat, të cilat po shënojnë rënie që nga TM4 2015. Përmirësime në këtë kategori janë shënuar nga rritja e kreditimit për sektorin e ekonomive familjare si dhe përmirësimi i cilësisë së portofolit kreditor. Ndërmarrjet shënuan rënie të rrezikut kryesisht si rezultat i përmirësimit të theksuar të cilësisë së portofolit kreditor dhe përmirësimit të raportit të ndërmarrjeve të regjistruara dhe atyre të mbyllura. Ndërsa, nëntreguesi i vlerës së shtuar në BPV nga sektori i tregtisë shënoi përkeqësim si rrjedhojë e ngadalësimit të aktivitetit në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë në vitin 2016. Rreziku nga sektori qeveritar ka shënuar rënie duke reflektuar zhvillimet pozitive si zvogëlimi i rrezikut sovran, rënia e deficitit fiskal dhe rritja e raportit të të hyrave tatimore ndaj BPV-së. Ndërsa, madhësia e borxhit qeveritar ndaj BPV-së si dhe shpenzimet për borxhin kanë shënuar rritje.

Rreziku i brendshëm për sektorin bankar, i lidhur me strukturën e sektorit bankar si dhe me nivelin e kapitalizimit dhe profitabilitetit kanë shënuar rënie të theksuar. Rreziku nga struktura e sektorit bankar ka rënë si rezultat i zhvillimeve pozitive në pothuajse të gjithë komponentët e tij, me theks të veçantë në rënie të rrezikut nga devijimi negativ ndaj normës mesatare të kapitalizimit të sektorit bankar, që nënkupton se bankat me normë më të ulët të kapitalizimit kanë rritur kapitalin rregullativ duke konvergjuar drejt mesatares së sektorit. Diversifikimi i portfolios së kredisë dhe burimeve të financimit të bankave është rritur, gjithashtu duke kontribuar në rënie të rrezikut. Përdërisa shkalla e përgjithshme e

Figura 1. Harta e stabilitetit financiar



¹ Metodologjia e plotë e modelit të Hartës së Stabilitetit Financiar për Kosovën paraqitet në Materialin Studimor të BQK-së Nr. 6.

koncentrimin të aseteve të tri bankave më të mëdha ka shënuar rënie, përqendrimi i kredisë për ndërmarrjet nga pesë bankat me kreditimin më të lartë për këtë sektor, ka qëndruar në nivel të njëjtë. Rreziku i lidhur me kapitalizimin dhe profitabilitetin shënoi rënie në TM2 2016 krahasuar me vitin paraprak duke reflektuar përmirësimin e cilësisë së portofolit kreditor, rënien e ekspozimeve të mëdha kreditore dhe rritjen e kapitalit aksionar. Ndërsa, komponentët të cilat shënuan ngritje të lehtë të rrezikut janë të hyrat nga interesi, fitimi para taksave si dhe norma e adekuatshmërisë së kapitalit, e cila u zvogëlua si rrjedhojë e rënies së kapitalit të klasit të dytë.

Rreziku i brendshëm i lidhur me likuiditetin dhe financimin e sektorit ka shënuar rritjen më të lartë dhe reflekton rritjen e rrezikut në të gjithë komponentët e tij. Raporti kredi/depozita ka shënuar rritje më të theksuar si rezultat i rritjes më të shpejtë të kreditimit. Rritja e rrezikut është ndikuar edhe nga ngadalësimi i trendit të rritjes së depozitave për ekonomitë familjare, rritja e detyrimeve ndaj jorezidentëve, rritja e theksuar e hendekut të likuiditetit për afatin e maturimit deri në 3 muaj si dhe rënia e raportit të aseteve likuide. Sidoqoftë, duhet theksuar se, përkundër rritjes së rrezikut të stabilitetit financiar të lidhur me likuiditetin dhe financimin, që reflekton ngritjen e këtij rreziku krahas ecurisë së zhvillimit të tij historik, pozita e likuiditetit të sektorit mbetet e kënaqshme gjykuar në bazë të nivelit të parametrave kryesorë të likuiditetit të cilët janë në nivele mjaft më të favorshme se normat referente dhe niveli minimal i kërkuar me rregulloren përkatëse.²

² Raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra në TM2 2016 ishte 41.5 përqind krahasuar me minimumin prej 25 përqind. Raporti i kredive ndaj depozitave qëndroi në 80 përqind, që është niveli i rekomandueshëm nga BQK.

3. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor


Eurozona

Eurozona është karakterizuar me rikuperim gradual të kërkesës së brendshme. Ky rikuperim është ndikuar nga përmirësimi i kushteve të financimit, si rezultat i politikave ekspansioniste dhe masave jokonvencionale të ndërmarra nga BQE, si dhe përmirësimit të kushteve në tregun e punës dhe çmimeve të ulëta të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare. Përforsimi i kërkesës në eurozonë është reflektuar pozitivisht në zhvillimet ekonomike të vendeve në Ballkanin Perëndimor në muajt e parë të vitit 2016, që u karakterizuan me rritje të eksporteve dhe investimeve. Norma mesatare vjetore e rritjes reale të BPV-së në eurozonë në gjashtë muajt e parë të vitit 2016 ishte 1.7 përqind, krahasuar me normën mesatare të rritjes prej 1.5 përqind të shënuar në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 2). Politikat ekspansioniste dhe masat jokonvencionale të ndërmarra nga BQE në kuadër të programit të lehtësimit sasior kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve të financimit në eurozonë. Për më tepër, përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve në tregjet e punës dhe çmimet e ulëta të naftës janë përkthyer në rritje të të ardhurave të disponueshme, duke ndikuar kështu në rritjen e konsumit të brendshëm. Megjithatë, në tremujorin e dytë të vitit 2016, si pasojë e pasigurive të ngritura rreth rezultateve të referendumit në Mbretërinë e Bashkuar për dalje nga BE-ja, besueshmëria e bizneseve në eurozonë u përkeqësua.

Rritja e aktivitetit ekonomik mbeti kryesisht e koncentruar në ekonomitë qendrore të eurozonës, gjegjësisht në Gjermani, Francë dhe Spanjë, përderisa vendet tjera të eurozonës vazhduan të karakterizohen me rritje të dobët ekonomike. Parashikimet e BQE-së sugjerojnë se rritja reale e BPV-së në vitin 2016 pritet të jetë 1.7 përqind. Kjo rritje pritet të mbështetet kryesisht nga masat e programit të lehtësimit sasior, çmimet e ulëta të naftës dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve në tregun e punës.


Norma e inflacionit në eurozonë vazhdoi të jetë nën objektivin e BQE-së. Në qershor 2016, shkalla mesatare e inflacionit ishte 0.0 përqind. Masat e reja të ndërmarra nga BQE-ja në mars 2016 në kuadër të programit të lehtësimit sasior kishin si qëllim parësor evitimin e deflacionit dhe rikthimin e shkallës së inflacionit më afër caktuar prej 2 përqind. Megjithatë, ndikimi i politikave ekspansioniste monetare në nivelin e çmimeve në eurozonë ka rezultuar të jetë i kufizuar, kryesisht si pasojë e çmimeve të ulëta të naftës dhe rënies së çmimeve të energjisë në këtë periudhë. Projektionet e BQE-së për vitin 2016, të publikuara në muajin shtator, sugjerojnë se shkalla mesatare e inflacionit në eurozonë pritet të jetë 0.2 përqind (figura 3).

Figura 2. Rritja vjetore e BPV-së në eurozonë



Burimi: Eurostat (2016)

Figura 3. Shkalla e inflacionit në eurozonë, në përqindje



* Parashikim i BQE-së
Burimi: Eurostat (2016)


Lansimi i programit të gjerë stimules që nga marsi i vitit 2016 ka ndikuar drejtpërdrejtë në rënien e mëtutjeshme të normave 1 mujore dhe 12 mujore të interesit të kreditimit ndërbankar Euribor (figura 4). Gjithashtu, BQE-ja ka vazhduar të mbajë normën e interesit në operacionet kryesore të rifinancimit në zero përqind (figura 4).

Eurozona në dy vitet e fundit është karakterizuar me rimëkëmbje të aktivitetit të kreditimit. Kjo duke pasur parasysh që dy vite më parë, kreditimi kishte shënuar rënie, ndërsa deri në qershor të këtij viti u shënuar normë e përsheptuar e rritjes prej 2.7 përqind (1.2 përqind deri në qershor 2015). Rritja e kreditimit ishte më e theksuar në Francë (4.5 përqind) dhe Gjermani (3.7 përqind), përderisa në vendet si Greqia, Austria dhe Spanja, kreditimi mbeti në territor negativ edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 (figura 5). Poashtu edhe vlera e depozitave, në mesatare, shënoi rritje vjetore. Rritjen më të lartë të depozitave e shënoi Franca (4.0 përqind) derisa Greqia u karakterizua me rënie prej 12.6 përqind.

Indikatorët e profitabilitetit, siç janë Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK), në mesatare, shënuan rritje. Greqia e cila vitet paraprake është karakterizuar me situatë të brishtë të profitabilitetit, këtë vit shënoi përmirësim duke realizuar kthim pozitiv në mesataren e kapitalit dhe të asetëve (figura 6).


Rritje shënuan edhe indikatorët kryesor të shëndetit financiar. Niveli mesatar i kapitalizimit të sektorit bankar, shprehur përmes raportit të kapitalit rregullativ ndaj mjeteve të peshuara me rrezik, u përmirësua në 18.7 përqind nga 17.9 përqind në vitin paraprak. Rritje më të theksuar të nivelit të kapitalizimit realizoi Greqia duke arritur në 16.2 përqind nga 10.3 përqind, si rezultat i përmirësimit të nivelit të profitabilitetit. Në Gjermani niveli i kapitalizimit qëndroi në nivel të ngjashëm me vitin paraprak në rreth 18 përqind, në Austri në 16.3 përqind (16.5 përqind në qershor 2015), 17.2 përqind në Francë (16.3 përqind në qershor 2015), dhe 14.6 përqind në Spanjë (14.4 përqind në qershor 2015). Po ashtu niveli i shfrytëzimit të kapitalit në financimin e

Figure 4. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së




Burimi: Euribor (2016) dhe BQE (2016)

Figure 5. Rritja vjetore e kreditimit dhe shkalla e KJP-ve në vendet kryesore të eurozonës, qershor 2016



Burimi: FMN (2016)

Figure 6. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar në vendet kryesore të eurozonës, qershor 2016



Burimi: FMN (2016)

aktivitetit financiar në vendet e eurozonës, i matur përmes levës financiare, shënoi rritje të lehtë në mesatarisht 8.1 përqind nga 8.0 përqind në vitin paraprak.

Cilësia e portfolios kreditore, në ekonomitë kryesore të eurozonës shënoi përmirësim ku në mesatare niveli i kredive jo-performuese u zvogëlua në 10.9 përqind nga 11.7 përqind. Përjashtim bën Greqia e cila u karakterizua me rritje të normës së KJP-ve në 37.0 përqind³ (33.4 përqind deri në qershor 2015). Nivelin më të ulët të kredive joperformuese, në kuadër të vendeve me kreditim mbi mesataren e eurozonës, e mban Gjermania me normë rreth 3.0 përqind dhe Franca me normë 3.9 përqind (figura 5).

Vendet kryesore të eurozonës gjithashtu u karakterizuan me nivel të kënaqshëm të likuiditetit në sektorin bankar, ku në qershor 2016 niveli mesatar i asetëve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra ishte 80.0 përqind (71.5 përqind). Gjermania dhe Holanda qëndrojnë në nivelet më të larta të likuiditetit, ku asetet likuide tejkalojnë detyrimet afatshkurtëra për 153.1 përqind dhe 169.7 përqind, respektivisht.


Ballkani Perëndimor

Performanca e aktivitetit ekonomik në Ballkanin Perëndimor vazhdoi të përforcohet. Rritja e kërkesës në eurozonë, si partner kryesor tregtar për vendet në Ballkanin Perëndimor, u përkthye në përmirësim të pozicionit të neto eksporteve të rajonit. Rritja e eksporteve, së bashku me rritjen e investimeve, paraqitën kontribues të rëndësishëm në rritjen prej 2.6 përqind të BPV-së në Ballkanin Perëndimor në gjysmën e parë të vitit 2016. Për tërë vitin 2016, parashikimet e FMN-së sugjerojnë për një normë mesatare të rritjes vjetore të BPV-së prej 3.4 përqind. Me përjashtim të Maqedonisë, të gjitha vendet tjera të rajonit pritet të shënojnë përsheptim të rritjes së BPV-së.

Ngjashëm me eurozonën, vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizuan me presione të dobëta inflacioniste, që kryesisht i atribuohen zhvillimeve të çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Në gjatë muajt e parë të vitit 2016, vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizuan me një shkallë mesatare të inflacionit prej 0.3 përqind, përderisa për vitin 2016, FMN ka parashikuar për këto vende një normë mesatare të inflacionit prej 0.4 përqind.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2016, kreditimi në rajon shënoi rritje, kryesisht si rezultat i standardeve më të lehtësuara të kreditimit nga bankat si dhe rritjes së kërkesës për kredi. Rritjen më të shpejtë të kreditimit deri në qershor 2016 e shënoi Serbia (9.5 përqind), pasuar nga Kosova (8.4 përqind) dhe Maqedonia (3.8 përqind). Në anën tjetër, me rënie vjetore të kreditimit u karakterizuan Kroacia (5.8 përqind), Mali i Zi (0.2 përqind) dhe Shqipëria (0.04 përqind). Sektori bankar në vendet e rajonit u karakterizua gjithashtu edhe me rritje të nivelit të përgjithshëm të depozitave, ku rritja më e shpejtë vjetore u regjistrua në Mal të Zi (9.3 përqind), Serbi (9.0 përqind) dhe Bosnjë (7.3 përqind), ndërkaq rritja më e ngadalshme u shënuar në Shqipëri (2.1 përqind) (figura 7).

Figura 7. Rritja vjetore e kredive dhe depozitave në vendet e rajonit, qershor 2016



Burimi: Bankat Qendrore të vendeve përkatëse (2016)

³ Te dhenat e fundit në dispozicion janë për Mars 2016

Edhe indikatorët kyç të shëndetit financiar gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 u karakterizuan me ecuri pozitive, megjithëse në nivel lehtësisht më të ulët se vitin paraprak.

Indikatorët e profitabilitetit të shprehur si raport i Kthimit në Mesataren e Kapitalit (KMK) dhe Kthimit në Mesataren e Aseteve (KMA) shënuan rritje vjetore në shumicën e vendeve të rajonit, me përjashtim të Shqipërisë.


Cilësia e portfolios kreditore shënoi përmirësim, ku niveli mesatar i KJP-ve zbriti në rreth 14.9 përqind deri në qershor 2016 (17.2 përqind në qershor 2015). Niveli më i ulët i KJP-ve prej 7.2 përqind u regjistrua në Maqedoni, ndërsa niveli më i lartë prej 20.2 përqind ishte në Serbi.

Deri në qershor 2016, mesatarja e raportit të kapitalit rregullator ndaj asetëve të peshuara me rrezik u zvogëlua në 17.3 përqind (17.5 në qershor 2015). Ndërsa, leva financiare shënoi rritje të lehtë në mesatarisht 14.1 përqind nga 14.0 përqind sa ishte në qershor 2015.

Poashtu edhe pozicioni i likuiditetit, i shprehur si raport i asetëve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra qëndroi në nivel lartë, megjithëse krahasuar me vitin paraprak u zvogëlua në të gjitha vendet, dhe në mesatare zbriti në 43.1 përqind nga 45.0 përqind.

Vendimet e BQE-s për të mos ndryshuar më tej normat e interesit pas ndryshimeve të fundit në mars të këtij viti, janë reflektuar në forcimin e monedhës së euros kundrejt valutave kryesore (figura 8). Norma mesatare e këmbimit të euros ndaj dollarit amerikan deri në qershor 2016 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak u vlerësua për 0.3 përqind. Ndaj sterlinës britanike dhe ndaj frankës zvicerane, euro u vlerësua për 6.6 përkatësisht 3.9 përqind. Sa i përket valutave të vendeve të rajonit, deri në qershor 2016, euro është vlerësuar kundrejt dinarit serb për mesatarisht 1.6 përqind, përderisa është zhvlerësuar kundrejt kunës kroate dhe lekut shqiptar për 1.0 përqind dhe 1.5 përqind, respektivisht.

Figura 8. Norma e këmbimit të euros ndaj valutave kryesore



Burimi: BQK (2016)

Kutia 1. Performanca e grupeve më të mëdha bankare që operojnë në Kosovë⁴

ProCredit Holding – PCH (Gjermani)

Vlera e gjithsej asetëve të grupit bankar ProCredit Holding (PCH) zbriti në 6.0 miliardë euro në qershor 2016, që paraqet 0.9 përqind rënie vjetore. Rënia e lehtë e asetëve të PCH mund të jetë pasojë e zvogëlimit të asetëve financiare, si atyre të mbajtura deri në maturim ashtu edhe asetëve financiare të tregtueshme. Sipas shtrirjes rajonale, struktura e asetëve të grupit është e përqendruar në Evropën Juglindore, pasuar nga Gjermania dhe Amerika Jugore (figura 9). Për PCH-në, Kosova është një nga vendet më të rëndësishme sepse përfaqëson rreth 12.7 përqind të gjithsej asetëve të grupit.

Në qershor 2016, pjesa më e madhe e asetëve të grupit ishte e investuar në vendet e Evropës Juglindore⁵, rajon i cili u karakterizua me rritje solide ekonomike. Rritja ekonomike në këtë rajon mund të ketë ndikuar në rritjen e pjesëmarrjes së asetëve të këtij rajoni në gjithsej asetet e grupit. Gjermania, si tregu i dytë më i rëndësishëm, u karakterizua me rritje ekonomike që u mbështet kryesisht nga konsumi privat dhe rritja e shpenzimeve qeveritare për kërkuesit e azilit.

Vendet e Evropës Lindore po ashtu gjatë këtij viti patën zhvillim pozitiv ekonomik, duke ndikuar kështu në rritjen e njësive nga këto vende në pjesëmarrjen e gjithsej asetëve të PCH grupit. Ekonomia e Gjeorgjisë deri në qershor të vitit 2016 shënoi rritje vjetore ekonomike prej 3.0 përqind, e mbështetur kryesisht nga rritja e shpenzimeve qeveritare. Po ashtu ekonomitë e Ukrainës dhe e Moldovës dolën nga recesioni në këtë vit dhe deri në qershor 2016 shënuan rritje ekonomike prej 1.4 përqind dhe 1.8 përqind përkatësisht. Nxitësi kryesor në rritjen e ekonomisë në këto dy vende ishte rritja e konsumit privat.

Në Amerikën Jugore⁶, në qershor 2016 pati rënie të asetëve të njësive të PCH-së, kryesisht si pasojë e ecurisë së rritjes ekonomike në vendet në fjalë. Bolivia dhe Kolumbia u karakterizuan me ngadalësim të rritjes ekonomike krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa Ekuadori regjistroi rënie ekonomike në gjashtëmuorin e parë të këtij viti. Zhvillimet ekonomike në këto vende u ndikuan nga vlerësimi i dollarit si dhe nga rënia e çmimit të naftës që është produkti kryesor i eksporteve të këtyre vendeve.

Modeli i biznesit të grupit PCH vazhdon të jetë tradicional, ku aktiviteti kredidhënës financohet kryesisht nga depozitat e rezidentëve. Në qershor 2016, gjithsej kreditë e grupit shënuan rritje të ngadalësuar në krahasim me vitin paraprak. Kreditë arritën vlerën prej 4.1 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 2.8 përqind. Rritja e ngadalësuar e gjithsej kredive ishte rezultat i mbylljes së njësive në Amerikën Qendrore

Figure 9. Struktura e asetëve të PCH-së, në përqindje





Figura 10. Ecuria e kredive dhe depozitave të PCH-së, në përqindje



⁴ Bazuar në raportet vjetore të publikuara nga ProCredit Holding, Raiffeisen Bank International, dhe Nova Ljubljanska Banka.

⁵ Vendet e Evropës Juglindore: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kosova, Maqedonia, Rumania dhe Serbia.


⁶ Bolivia, Ekuadori dhe Kolumbia.

dhe Meksikë. Kosova ka kontribuar me rritje prej 4.9 përqind në rritjen e gjithsej portfolios kreditore të grupit. PCH ka ndjekur strategjinë e promovimit të kreditimit ndaj ndërmarrjeve më shumë se sa kreditimin ndaj ekonomive familjare. Në qershor 2016, depozitat arritën vlerën prej 3.8 miliardë euro që paraqet një rritje vjetore prej 4.5 përqind (figura 10).

Grupi PCH shënoi përmirësim të indikatorit të përgjithshëm të efikasitetit, shprehur përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave, i cili është më i ulët në krahasim me vitin paraprak (figura 11). Përmirësimi i atribuohet rënies më të theksuar prej 10.7 përqind të shpenzimeve operacionale krahasuar me rënie e të hyrave operacionale prej 8.5 përqind. Rënia e shpenzimeve të përgjithshme ishte rezultat i reduktimit të shpenzimeve të interesit prej 11.6 përqind, shpenzimeve për personelin që shënuan rënie vjetore prej 12.8 përqind, si dhe reduktimit të shpenzimeve administrative që shënuan rënie vjetore prej 8.9 përqind. Ndërsa, në kuadër të të hyrave të përgjithshme, të hyrat nga interesi shënuan rënie vjetore prej 7.9 përqind, kryesisht si rezultat i rënies së normave të interesit në kredi. Gjithashtu, të hyrat nga tarifat dhe komisionet shënuan rënie vjetore prej 2.0 përqind.

Përkundër zvogëlimit të shpenzimeve të përgjithshme, rënia e theksuar e të hyrave të përgjithshme ndikoi që profiti i grupit deri në qershor 2016 të jetë dukshëm më i ulët krahasuar me atë të qershorit 2015. Në qershor 2016, profiti i realizuar zbriti në 29.3 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 11.4 përqind. Rënia e profitit ndikoi në përkeqësimin e normës së Kthimit Mesatar në Kapital (KMK), e cila zbriti në 9.5 përqind krahasuar me 11.6 përqind sa ishte në qershor 2015. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (TMK) u rrit në 13.3 përqind dhe vazhdon t'i përmbushë kërkesat rregullatore të mjaftueshmërisë së kapitalit (figura 11). Në qershor 2016, raporti i kredive ndaj depozitave u zvogëlua në 108.7 përqind nga 110.4 përqind sa ishte në qershor 2015, si rezultat i rritjes më të shpejtë të depozitave krahas rritjes vjetore të kredive.

Figura 11. Treguesit e efikasitetit të PCH-së, në përqindje



Performanca e grupit në pjesën e mbetur të vitit 2016 pritet të përmirësohet si rezultat i zhvillimeve makroekonomike pozitive⁷ dhe kushteve të favorshme në tregjet financiare në vendet në të cilat operon grupi. Rajoni i Evropës Juglindore (përfshirë Kosovën) ku PCH ka të koncentruar pjesën më të madhe të aseteve kryesisht pritet të shënoj përsheptim të rritjes ekonomike. Gjithashtu edhe Gjermania pritet të shënoj rritje solide ekonomike në pjesën e mbetur të vitit, të ndikuar kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme (konsumit publik dhe privat), e mbështetur nga kushtet e favorshme në tregun e punës dhe çmimi i ulët i naftës i cili ka ulur çmimet e konsumit. Vendet e Evropës Lindore do të ketë përmirësim të mëtutjeshëm gjatë pjesës së mbetur të këtij viti. Ndërsa, tregu i Amerikës Jugore pritet të ndikohet negativisht nga zhvillimet në tregun e çmimeve të naftës, duke marrë parasysh që nafta paraqet produktin kryesor në eksport.


Raiffeisen Bank International – RBI (Austri)

Vlera e gjithsej aseteve të grupit bankar Raiffeisen Bank International (RBI) në qershor 2016 ishte 114.0 miliardë euro, që paraqet një rënie të lehtë vjetore prej 0.4 përqind. Sipas shtrirjes rajonale, Austria mbanë pozitën udhëheqëse në strukturën e aseteve, pasuar nga Evropa Qendrore si treg tjetër mjaft i rëndësishëm për grupin. Pjesa tjetër përfshinë asetet e njësive në Azi dhe Amerikë të cilat janë planifikuar të reduktohen apo të shiten deri në fund të vitit 2017 (figura 12). Raiffeisen Bank që operon në Kosovë vazhdon të ketë pjesëmarrje mjaft të ulët prej 0.77 përqind në gjithsej asetet e RBI-së.

⁷ Pritjet për të ardhmen bazohen në parashikimet e FMN-së.

Pjesa më e madhe e vendeve në të cilat operon RBI shënuan rritje ekonomike në gjysmën e parë të vitit. Më konkretisht, rajoni i Evropës Qendrore u karakterizua me rritje solide ekonomike. Kjo rritje erdhi si rezultat i rritjes ekonomike në Gjermani, rimëkëmbjes ekonomike më të lartë në Poloni dhe Sllovaki dhe politikave monetare ekspansioniste në Republikën Çeke dhe Hungari. Po ashtu, rajoni i Evropës Juglindore u karakterizua me përshpejtim të rritjes ekonomike, përderisa rajoni i Evropës Lindore shënoi rënie ekonomike, por që është dukshëm më e ulët krahasuar me vitin paraprak. Austria, në gjysmën e parë të vitit 2016, shënoi përshpejtim të rritjes së ekonomisë kryesisht si rezultat i rritjes së konsumit të brendshëm ndikuar nga reforma në tatim e cila rriti konsumin privat. Rritja e investimeve kontribuoi gjithashtu në rritje ekonomike, përderisa performanca e eksporteve mbetet ende e dobët.


Figura 12. Struktura e asetëve të RBI-së, në përqindje



Burimi: Raiffeisen Bank International (2016)

Modeli i biznesit të grupit bankar RBI vazhdon të bazohet kryesisht në aktivitetin kredidhënës, të financuar nga depozitat. Pas tri viteve rënie të aktivitetit kreditor, në qershor 2016 kreditimi i RBI shënoi rritje (figura 13). Gjithsej kreditë shënuan rritje vjetore prej 1.3 përqind, duke arritur në 70.8 miliardë euro. Kjo rritje ishte rezultat i rritjes së kredive për ndërmarrje të mëdha dhe atyre individuale si rezultat i blerjes së biznesit me klientë privat dhe kredit kartela të njëjës nga bankat e cila operon në Republikën Çeke. Vlera e depozitave deri në gjysmën e parë të vitit 2016 zbriti në 68.9 miliardë euro, duke shënuar një rënie të lehtë vjetore prej 0.1 përqind. Kjo rënie ishte si rezultat i rënies së depozitave të ndërmarrjeve të mëdha, veçanërisht në zyrën qendrore të grupit në Poloni dhe në Sllovaki. Ndërsa, depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje si rezultat i rritjes së depozitave në Republikën Çeke e pasuar nga blerja e një njësie të biznesit, gjithashtu edhe nga rritja e depozitave në njësitë e Rusisë dhe Sllovakisë. Si rrjedhojë e rritjes të kredive krahas rënies së nivelit të depozitave, raporti i kredive ndaj depozitave u rrit në 102.7 përqind në qershor 2016, rritje për 1.4 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.


Figura 13. Ecuria e kredive dhe depozitave të RBI-së, në përqindje



Burimi: Raiffeisen Bank International (2016)

RBI shënoi përkeqësim të indikatorit të përgjithshëm të efikasitetit, shprehur përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave, i cili në gjysmën e parë të vitit 2016 u rrit në krahasim me vitin paraprak (figura 14). Kjo rritje prej 5.0 pikë përqindje i atribuohet rritjes prej 1.8 përqind të shpenzimeve të përgjithshme administrative, krahas rënies së të hyrave operacionale prej 6.5 përqind në qershor 2016. Në kuadër të gjithëj të hyrave, të hyrat nga interesi shënuan rënie vjetore prej 13.4 përqind si rrjedhojë e nivelit të ulët të normës së interesit në një pjesë të madhe të vendeve të

Figura 14. Treguesit e efikasitetit të RBI-së, në përqindje



*KMK - 2016 e analizuuar
Burimi: Raiffeisen Bank International (2016)

Grupit. Në këtë drejtim mund të ketë ndikuar edhe mbajtja e nivelit më të lartë të aseteve likuide të cilat kanë normë më të ulët të kthimit, si dhe rënia e gjithsej stokut të kredive në RBI Austri dhe njësisë në Azi.


Në kuadër të shpenzimeve operacionale, shpenzimet e personelit u karakterizuan me rritje vjetore prej 6.8 përqind deri në qershor 2016, ndërsa shpenzimet tjera administrative shënuan rënie prej 1.4 përqind. Deri në qershor 2016, RBI ka ndarë 33.3 përqind më pak provizione për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë, ku pjesa më e madhe e provizioneve i atribuohet ndërmarrjeve të mëdha. Zvogëlimi i shpenzimeve për provizione ishte më i theksuar në Ukrainë, dhe në pjesën më të madhe të vendeve të Evropës Qendrore dhe Juglindore. Deri në qershor 2016, grupi RBI regjistroi profit neto në vlerë prej 210 milionë euro krahasuar me fitimin prej 276 milionë euro në vitin e kaluar. Profiti më i ulët i realizuar gjatë këtij gjashtëmujori ndikoi në përkeqësimin e lehtë të Kthimit Mesatar në Kapital (KMK) në 10.6 përqind, krahasuar me 10.9 përqind sa ishte në qershor 2015. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit në qershor 2016 qëndroi Kurse, raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive u zvogëlua në 10.4 përqind, krahasuar me 12.0 përqind sa ishte në qershor 2015, përderisa mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizione arriti në 72.1 përqind nga 66.8 përqind sa ishte në qershor 2015. RBI vazhdon të jetë e vetmja nga tri grupet bankare kryesore që operojnë në Kosovë që tregton aksionet e saj në bursë. Çmimi për aksion të RBI-së në bursën e Vjenës në ditën e fundit të qershorit 2016 u zvogëlua në 11.28 euro, krahasuar me 13.05 euro sa ishte në ditën e fundit të qershorit 2015.

Zhvillimet ekonomike në vendet ku vepron grupi RBI pritet të ndikojnë pozitivisht në performancën e grupit. Ekonomia e Austrisë pritet që në gjashtë muajt e mbetur të shënojë rritje ekonomike, të nxitur nga kërkesa e brendshme. Po ashtu investimet pritet të rriten gjatë vitit 2016 dhe 2017, ndikuar nga normat e ulëta të interesit dhe çmimet e ulëta të naftës. Ngjashëm, ekonomitë e Evropës Juglindore pritet që gjatë vitit 2016 të kenë ritëm të përsheptuar të rritjes ekonomike. Trend pozitiv të rritjes ekonomike pritet të kenë edhe në vendet e Evropës Qendrore si rezultat i rritjes ekonomike në Gjermani që është partneri më i madh tregtar i këtyre vendeve. Ndërsa, ekonomia e Rusisë pritet që edhe gjatë vitit 2016 të shënojë rënie, por më të ulët se sa rënia e vitit 2015.

Nova Ljubljanska Banka- NLB (Slloveni)

Grupi bankar NLB deri në qershor 2016 u karakterizua me rritje të të aktivitetit krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Vlera e gjithsej aseteve të grupit gjatë këtij gjashtëmujori ishte 11.8 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 1.6 përqind. Sa i përket shtrirjes rajonale, Sllovenia, që është vend i origjinës të grupit bankar NLB, përfaqëson tregun kryesor të gjithsej aseteve të grupit. Evropa Juglindore paraqet tregun e dytë më të rëndësishëm për grupin NLB dhe pjesa e mbetur e aseteve të grupit janë të investuara në rajonin e Evropës Perëndimore dhe Evropës Qendrore (figura 15). NLB Banka që operon në Kosovë, në qershor 2016, kishte pjesëmarrje prej 4.0 përqind në gjithsej asetet e grupit.

Figura 15. Struktura e aseteve të NLB Group, në përqindje




Burimi: Nova Ljubljanska Banka (2016)

Edhe grupi NLB ndjekë një model tradicional të biznesit duke marrë parasysh që aktiviteti i grupit është kryesisht kredidhënës dhe financohet nga depozitat. Grupi NLB gjatë kësaj periudhe u karakterizua me rritje të aktivitetit kredidhënës. Në qershor 2016, vlera e gjithsej kredive ishte 6.7 miliard euro, që paraqet rritje të lehtë vjetore prej 0.5 përqind. Depozitat u karakterizuan me rritje të përsheptuar prej 4.1 përqind, krahasuar me rënie prej 0.5 përqind në vitin paraprak, vlera e të cilave në qershor 2016 arriti në 9.1 miliard euro (figura 16). Rritja më e ulët e kredive, krahas rritjes më të lartë të depozitave, ka ndikuar që raporti kredi/depozita të zvogëlohet në 73.8 përqind nga 76.4 sa ishte në qershor 2015.

Grupi NLB deri në qershor 2016 ka shënuar përmirësim të treguesit kyç të efikasitetit të shprehur përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave. Treguesi shënoi rënie vjetore për 0.8 pikë përqindje, duke zbritur në nivelin prej 58.7 përqind (figura 16). Ky rezultat i atribuohet rënies më të ulët të të hyrave operacionale prej 0.2 përqind, në krahasim me rënien e shpenzimeve operacionale të cilat u zvogëluan për 1.5 përqind. Të hyrat neto nga interesi shënuan rënie prej 7.8 përqind, të ndikuar nga shitja e një pjese të kredive jo-performuese. Po ashtu, të hyrat nga tarifrat dhe komisionet shënuan rënie vjetore prej 3.0 përqind.

Figura 16. Ecuria e kredive dhe depozitave të NLB Group, në përqindje




Burimi: Nova Ljubljanska Banka (2016)

Ndërsa, të hyrat nga jo-interesi shënuan rritje të theksuar prej 17.4 përqind. Në kuadër të shpenzimeve operacionale, shpenzimet për personelin shënuan rritje vjetore prej 2.1 përqind në qershor 2016, përdërisa shpenzimet e përgjithshme dhe administrative shënuan rënie vjetore prej 4.3 përqind. Grupi arriti që deri në qershor 2016 të regjistroj profit prej 69.5 milionë euro (53.4 milionë në qershor 2015), në të cilin profit kontribuuan kryesisht njësitë e NLB në Slloveni dhe në Evropën Juglindore, ndërsa njësitë në rajonet tjera kishin rënie të profitit. Rritja e profitit u reflektua edhe në normën e kthimit në kapital (KMK) e cila u përmirësua në 9.4 përqind nga 7.8 përqind sa ishte në qershor 2015.

Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit në qershor 2016 qëndroi në 16.6 përqind, që ishte më i lartë krahasuar me normën prej 15.9 përqind një vit më parë, dhe mjaft mbi nivelin minimal prej 8 përqind të përcaktuar me kërkesat rregullatore (figura 17). Faktori kyç në këtë përmirësim ishte rënia e regjistruar në asetet e peshuara me rrezik, kryesisht në segmentin e rrezikut kreditor. Ecuri pozitive u shënuan edhe në cilësinë e portofolit kreditor, ku raporti ndërmjet kredive joperformuese dhe gjithsej kredive u zvogëlua në 17.9 përqind në qershor 2016, krahasuar me 24.6 përqind sa ishte në qershor 2015. Për më tepër, mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizione u përmirësua në 76.0 përqind krahasuar me 69.4 përqind në qershor 2015.

Figura 17. Treguesit e efikasitetit të NLB Group, në përqindje



*KMK - 2016 e aktualizuar
Burimi: Nova Ljubljanska Banka (2016)

Zhvillimet ekonomike në vendet ku operon grupi NLB pritët të ndikojnë pozitivisht në performancën e grupit. Sllovenia pritët që edhe gjatë pjesës së mbetur të vitit 2016 të ketë trend pozitiv të rritjes ekonomike por me shkallë më të moderuar për shkak të pritjeve për më pak investime publike.

Megjithatë, zgjerimi i konsumit të brendshëm dhe investimeve private në vend do të jenë faktorët mbështetës në rritjen e BPV-së.


4. Ekonomia e Kosovës

Ekonomia e Kosovës në vitin 2016, sipas parashikimeve të BQK-së, pritet të shënojë rritje prej rreth 3.6 përqind. Kjo rritje pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme, ndërsa neto eksportet parashihet të vazhdojnë të kenë kontribut negativ në rritjen e BPV-së.

Vlerësimet preliminare të ASK-së sugjerojnë rritje të aktivitetit ekonomik prej 3.5 përqind në gjysmën e parë të vitit 2016, rritje e gjeneruar kryesisht nga rritja e investimeve (14.6 përqind) dhe rritja e konsumit (4.5 përqind). Në këtë periudhë, neto eksportet vlerësohet të jenë karakterizuar me thellim të konsiderueshëm të deficitit tregtar (16.4 përqind). Në gjysmën e parë të vitit 2016, rritja reale e ekonomisë së Kosovës është mbështetur kryesisht nga rritja në aktivitetin e sektorit të ndërtimitarisë (5.3 përqind), sektorit të hoteleve dhe restoranteve (10.9 përqind), transportit dhe magazinimit (7.3 përqind), tregtisë (3.9 përqind), etj., përderisa rënie të aktivitetit vlerësohet të kenë shënuar industria nxjerrëse (5.0 përqind), afarizmi me pasuri të patundshme (4.4 përqind) dhe administrimi publik (1.6 përqind).

Gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2016, zhvillimet në nivelin e përgjithshëm të çmimeve vazhduan të karakterizohen me presione të lehta deflacioniste (-0.02 përqind). Çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit shënuan rritje prej 10.9 përqind, pasuar nga rritja e çmimeve të shërbimeve shëndetësore për 3.2 përqind, dhe rritja e çmimeve të veshmbathjes për 2.6 përqind. Në anën tjetër, rënie e çmimeve është shënuar te shërbimet e transportit, të cilat shënuan rënie për 4.3 përqind, pasuar nga kategoria e rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse të cilat shënuan rënie për 3.8 përqind (figura 18). Me rënie prej 0.6 përqind u karakterizuan edhe çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike, të cilat përfaqësojnë rreth 39.2 përqind të shportës së konsumatorit kosovar.

Figura 18. Ndryshimi mesatar vjetor i IÇK-së, në përqindje



Burimi: ASK (2016)

Të hyrat buxhetore⁸ deri në qershor 2016 arritën vlerën bruto prej 756.2 milionë euro. Nëse zbriten 19.5 milionë euro kthime të TVSH-së dhe tatimeve tjera nga Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës, atëherë të hyrat buxhetore shënuan vlerën neto prej 736.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 14.0 përqind. Në të njëjtën periudhë, shpenzimet buxhetore⁹ arritën vlerën prej 716.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7.4 përqind. Rrjedhimisht, gjatë kësaj periudhe, buxheti i Kosovës regjistroi bilanc pozitiv buxhetor prej rreth 20.3 milionë euro, krahasuar me bilancin negativ buxhetor prej rreth 21.1 milionë euro të shënuar deri në qershor të vitit 2015. Borxhi publik, në qershor të vitit 2016, ka arritur në 821.9 milionë euro që është për 26.6 përqind më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ndërsa si përqindje e PBB-së ka arritur në 13.8 përqind nga 11.2 përqind sa ishte në qershor 2015.

Deri në qershor të vitit 2016, sektori i jashtëm u karakterizua me përkeqësim të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale arriti vlerën prej 327.0

⁸ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk janë përfshirë të hyrat nga huamarrjet, pranimet nga privatizimi, të hyrat e dedikuara të AKP-së, pranimet nga grantet e përgjithshme të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

⁹ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk janë përfshirë pagesat e kryeqjës së borxhit, pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pagesat nga depozitat në mirëbesim.

milionë euro, një rritje prej 57.6 përqind krahasuar me vitin paraprak, kryesisht si pasojë e rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarive të të ardhurave parësore dhe dytësore. Në anën tjetër, bilanci pozitiv në llogarinë e shërbimeve shënoi rritje.

Deficiti tregtar i mallrave arriti vlerën prej 1.1 miliardë euro në qershor 2016, që paraqet një rritje vjetore prej 10.4 përqind (figura 19). Gjithsej eksporti i mallrave deri në qershor 2016 arriti vlerën 152.4 milionë euro, një rënie vjetore prej 5.6 përqind. Rënia e vlerës së eksportit të mallrave gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet rënies së eksporteve të metaleve bazë, që njëherësh kanë edhe pjesëmarrjen më të lartë në strukturën e gjithsej eksporteve të vendit (rreth 40 përqind). Rënia e vlerës së gjithsej eksporteve të metaleve


bazë u zvogëlua kryesisht si pasojë e rënies së prodhimit të nikelit në ekonominë e vendit, si dhe rënies së çmimit të metaleve në tregjet ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe. Me rënie u karakterizuan edhe eksportet e tekstilit dhe artikujve të tekstilit, si dhe eksportet e makinerive dhe pajisjeve elektrike. Në anën tjetër, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2016, eksportet e produkteve minerale shënuan rritje, kryesisht si rezultat i rritjes së vlerës së eksportit të energjisë elektrike. Gjithashtu, eksportet e produkteve të plastikës dhe gomës, si dhe eksportet e produkteve të lëkurës shënuan rritje në periudhën raportuese.

Vlera e gjithsej mallrave të importuara deri në qershor 2016 arriti në 1.3 miliardë euro, një rritje vjetore prej 8.3 përqind. Në kuadër të importit të mallrave, me rritje u karakterizua importi i metaleve bazë, importi i makinerive dhe i pajisjeve mekanike dhe elektrike, importi i mjeteve të transportit si dhe importi i produkteve ushqimore. Rënia e vlerës së eksporteve dhe rritja e vlerës së mallrave të importuara rezultoi në zvogëlim të shkallës së mbulueshmërisë së importeve me eksporte në 11.7 përqind në gjashtëmujorin e parë të vitit 2016 (13.5 në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015).

Tregtia në shërbime u karakterizua me rritje të bilancit pozitiv deri në qershor 2016 në 172.6 milionë euro, një rritje vjetore prej 30.4 përqind. Eksporti i shërbimeve shënoi rritje vjetore prej 2.6 përqind, duke arritur vlerën prej 329.7 milionë euro, përderisa vlera e importit të shërbimeve shënoi rënie prej 16.9 përqind dhe regjistroi vlerën prej 157.1 milionë euro. Në kuadër të shërbimeve të eksportuara, shërbimet e udhëtimit u karakterizuan me rritje vjetore prej 7.9 përqind, përderisa kategoria e shërbimeve kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit u karakterizua me rënie prej 20.4 përqind. Sa i përket importit të shërbimeve, dy kategoritë kryesore të shërbimeve, gjegjësisht shërbimet e transportit dhe të udhëtimit, shënuan rënie vjetore prej 17.4 përqind përkatësisht 19.1 përqind.

Llogaria e të ardhurave parësore deri në qershor 2016 kishte bilanc pozitiv prej 48.6 milionë euro, i cili është për 16.8 përqind më i ulët krahasuar me vitin e kaluar. Bilanci më i ulët i të ardhurave parësore i atribuohet kryesisht nivelit më të ulët të të ardhurave nga kompenzimi i punëtorëve (8.9 përqind) dhe të ardhurave nga investimet (5.6 përqind).

Figura 19. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar, në miliardë euro



Burimi: ASK (2016)


Deri në qershor 2016, llogaria e të ardhurave dytësore shënoi vlerën prej 518.1 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 4.4 përqind. Bilanci më i ulët i të ardhurave dytësore kryesisht i atribuohet zvogëlimit të vlerës së remitencave të pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore. Pas tre vitesh rritjeje të vazhdueshme, remitencat e pranuar në vend u karakterizuan me një rënie vjetore prej 2.7 përqind dhe shënuan vlerën prej 329.8 milionë euro (figura 20).

Gjithashtu, rënia në e shënuar në kategorinë e të ardhurave dytësore i atribuohet edhe nivelit më të ulët të donacioneve dhe granteve të ndryshme, si dhe reduktimit të shpenzimeve nga institucionet e ndryshme ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

Vlera e IHD-ve të pranuar në Kosovë deri në qershor 2016 rezultojnë të jetë përgjysmuar në 84.8 milionë euro, nga 161.7 milionë euro sa ishte në qershor të vitit paraprak. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, me zvogëlim të vlerës u karakterizuan të dy format e IHD-ve, kapitali dhe fondi i investimeve në aksione si dhe investimet në instrumentet e borxhit. Kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, që përbën rreth 74.1 përqind të gjithsej IHD-ve, shënoi vlerën 62.8 milionë euro që është për 45.6 përqind më e ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjithashtu, IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit shënuan vlerën prej 22.0 milionë euro, që janë për 52.5 përqind më të ulëta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (figura 21).


Zvogëlim i IHD-ve në Kosovë u evidentua sidomos në sektorin e patundshmërive, në sektorin e ndërtimit dhe në sektorin e shërbimeve financiare. Në anën tjetër, sektorët e ekonomisë që u karakterizuan me rritje të IHD-ve ishin sektori i shërbimeve tregtare dhe sektori i bujqësisë. Sa i përket origjinës së IHD-ve, Zvicra paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD deri në qershor të vitit 2016 (26.0 milionë euro), pasuar nga Turqia me 17.8 milionë euro, Shqipëria me 17.4 milionë euro, Austria me 11.3 milionë euro, etj.

Figura 20. Pranimet e remitencave



Burimi: BQK (2016)

Figura 21. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro




Burimi: BQK (2016)

4.1 Tregu i Letrave me Vlerë

Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës që nga fillimi i operimit ka treguar trend pozitiv të rritjes dhe zhvillimit. Numri dhe vëllimi i ankandeve të letrave me vlerë ka shënuar rritje gjatë periudhës pesëvjeçare, që është reflektuar si nga oferta ashtu edhe nga kërkesa. Numri i ankandeve të realizuara u rrit nga 6 në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2012 në 11 në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2016. Në tri vitet e fundit, numri i ankandeve të realizuara ishte i njëjtë, mirëpo shuma e emetuar shënoi rritje (figura 22). Në periudhën janar - qershor 2016, gjithsej shuma e emetuar e letrave me vlerë arriti në 250.0 milionë euro nga 210.0 milionë sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Për më tepër, fillimi i emetimit të fletëobligacioneve qeveritare që nga viti 2014 ka ndikuar në rritjen e afatit të maturimit. Në fund të muajit qershor 2016, afati mesatar i maturimit të letrave me vlerë u rrit në 23.5 muaj, krahasuar me 15.4 muaj në qershor 2015 dhe 11.7 muaj në qershor 2014.¹⁰


Figura 22. Ecuria e tregut të letrave me vlerë



Burimi: BQK (2016)

Investimet në letra me vlerë konsiderohen si instrumente atraktive dhe të sigurta për bankat dhe institucionet tjera financiare. Kjo reflektohet nga shuma e ofertuar nga subjektet pjesëmarrëse në ankande, e cila vazhdimisht ka tejkaluar shumën e shpallur nga qeveria. Në gjysmën e parë të vitit 2016, shuma e shpallur në ankande ishte për 16.3 përqind më e lartë krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2015, përderisa shuma e ofertuar e subjekteve pjesëmarrësve shënoi rritje prej 67.9 përqind. Shuma e ofertuar për investime në letra me vlerë deri në qershor 2016 ishte 552.6 milionë euro, përderisa shuma e shpallur ishte 250.0 milionë euro. Rrjedhimisht, raporti i shumës së ofertuar ndaj shumës së shpallur për periudhën janar - qershor 2016 ishte 2.21 (1.53 janar - qershor 2015) (figura 23).

Figura 23. Shuma e shpallur dhe e ofertuar, në milionë euro.



Burimi: BQK (2016)

Struktura e letrave me vlerë sipas llojit të instrumentit të emetuar ka pësuar ndryshime. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2016, shuma e emetuar e fletëobligacioneve përbën 36 përqind të gjithsej shumës së emetuar të letrave me vlerë krahasuar me 23.8 përqind sa ishte në gjysmën e parë të vitit 2015. Kjo për faktin se emetimi i fletëobligacioneve shënoi rritje në numër dhe në vlerë. Këtë periudhë janë emetuar katër fletëobligacione qeveritare në vlerë prej 90 milionë euro krahasuar me tri të tilla në vlerë prej 50 milionë euro në gjysmën e parë të vitit paraprak. Ndërsa, numri i ankandeve për bono të thesarit shënoi rënie në shtatë nga tetë sa ishin në gjysmën e parë të vitit 2015, përderisa vlera e tyre mbeti e njëjtë në 160 milionë euro.


¹⁰ Afati mesatar i maturimit është llogaritur si mesatare e thjeshtë e afateve të maturimit të letrave me vlerë që ende nuk kanë maturuar në fund të periudhës së cekur në analizë.

Kategoria kryesore e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës u përfaqësua nga bonot e thesarit me maturim deri në një vit, të cilat kishin pjesëmarrje prej 44.0 përqind. Kategoria e dytë ishte ajo e fletëobligacioneve qeveritare me maturim deri në dy vite, për dallim nga periudha paraprake kur bonot e thesarit me maturim 182 ditë përfaqësonin kategorinë e dytë të letrave me vlerë (figura 24). Kurse, fletëobligacionet qeveritare me afat maturimi pesë vite, që filluan të emetohen gjatë pjesës së dytë të vitit 2015, në gjysmën e parë të vitit 2016 përfaqësuan 6.0 përqind të gjithsej letrave me vlerë.

Norma e përgjithshme mesatare e interesit në letrat me vlerë zbriti në 1.02 përqind, krahasuar me 1.83 përqind në vitin paraprak. Në rënie kontribuoi konkurrenca në mes të pjesëmarrësve për të investuar në letra me vlerë të qeverisë së Kosovës, pasi që këto instrumente po përfaqësojnë një produkt relativisht të ri në tregun e brendshëm financiar që ofron kthime të favorshme në kushtet kur normat e interesit në tregjet e jashtme janë të ulëta, dhe në anën tjetër, likuiditeti në sektorin bankar të Kosovës është duke qëndruar në nivel mjaft të lartë. Norma më e lartë e interesit prej 3.5 përqind u regjistrua në fletëobligacionet me afat maturimi 5 vite, ndërsa norma më e ulët prej 0.3 përqind u regjistrua në bonot e thesarit me afat maturimi 91 ditë (figura 25). Përjashtuar fletobligacionet 5 vjeçare të cilat nuk janë emetuar gjatë gjysmës së parë të vitit të kaluar prandaj dhe nuk kanë krahasim me këtë vit, të gjitha kategoritë e tjera të letrave me vlerë bartin norma më të ulëta të interesit krahasuar me vitin paraprak.


Tregu i letrave me vlerë në vend qëndron mjaft mirë në krahasim me vendet e rajonit¹¹ për sa i përket normave të interesit si dhe raportit të ofertimit ndaj shumës së shpallur të letrave me vlerë nga qeveritë e vendeve përkatëse. Në gjysmën e parë të vitit 2016, Kosova regjistroi

Figura 24. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë sipas afatit të maturimit, në përqindje




Burimi: BQK (2016)

Figura 25. Normat mesatare të interesit të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës sipas maturimit



Burimi: BQK (2016)

Figura 26. Raporti i mbulimit shumë e ofertuar/shumë e shpallur në vendet e rajonit




Burimi: Bankat Qendrore të vendeve përkatëse (2016)

¹¹ Në vendet e rajonit janë përfshirë: Shqipëria, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi. Në dy vitet e fundit Mali i Zi nuk është përfshirë për shkak të disponueshmërisë së të dhënave.

raportin më të lartë të ofertës ndaj shumës së shpallur nga qeveria (figura 26). Ky tregues ishte mjaft i lartë edhe në Shqipëri dhe Serbi. Ndërsa, Maqedonia regjistroi ofertimin më të ulët nga subjektet pjesëmarrëse duke shënuar raport 0.92 ndaj shumës së shpallur për letrat me vlerë. Po ashtu, Kosova ka pozicion më të favorshëm edhe për sa i përket normës së interesit në letrat me vlerë të qeverisë. Norma mesatare e interesit për këtë instrument në Kosovë ishte më e ulëta krahasuar me vendet e rajonit (figura 27). Ndërsa, norma mesatare më e lartë e interesit në letrat me vlerë të qeverisë u regjistrua në Serbi.

Figura 27. Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë të qeverive në vendet e rajonit, në përqindje



Burimi: Bankat Qendrore të vendeve përkatëse (2016)

5. Sistemi Financiar i Kosovës

5.1. Karakteristikat e Përgjithshme

Sistemi financiar i Kosovës po vazhdon të rritet në mënyrë të qëndrueshme. Në qershor 2016, vlera e gjithsej asetëve të sistemit arriti në 5.1 miliardë euro, një rritje vjetore prej 7.3 përqind. Rritja ishte kryesisht rezultat i zgjerimit të aktivitetit të sektorit bankar dhe performancës pozitive të fondeve pensionale. Sektori mikrofinanciar dhe i sigurimeve kontribuan në rritjen e gjithsej asetëve të sistemit, por në shkallë më të ulët. Sektori i ndihmësve financiar vazhdon të ketë peshë të ulët në kuadër të sistemit financiar në vend.

Struktura e sistemit financiar të Kosovës vazhdon të dominohet nga sektori bankar (figura 28). Sektori i dytë për nga madhësia janë fondet pensionale, të cilat po vazhdojnë të rrisin pjesëmarrjen në kuadër të gjithsej asetëve të sistemit. Pjesëmarrja e sektorëve tjerë financiar në gjithsej asetet e sistemit vijon të jetë e përafërt me vitet paraprake.

Shkalla e ndërmjetësimit financiar në Kosovë, llogaritur si raport i asetëve të sistemit financiar ndaj Bruto Produktit Vendor (BPV), është rritur gjatë kësaj periudhe. Në qershor 2016, norma e ndërmjetësimit financiar në vend arriti në rreth 85 përqind krahasuar me 83 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 29). Përkundër rritjes së shënuar në periudhën e fundit, shkalla e ndërmjetësimit financiar e sektorit bankar në Kosovë vazhdon të jetë relativisht e ulët krahasuar me vendet e rajonit. Rrjedhimisht, në raport me madhësinë e ekonomisë, ekziston ende hapësirë për rritje të shkallës së ndërmjetësimit financiar. Zhvillime të ngjashme vërehen edhe nëse shikohet raporti i kredive të lëshuara nga sektori bankar dhe BPV-së. Megjithatë, rritja e vazhdueshme e kreditimit në Kosovë po bënë që Kosova të shënojë përmirësim në këtë tregues dhe të afrohet gradualisht drejt mesatares së vendeve të rajonit (figura 30).

Figura 28. Struktura e asetëve të sistemit financiar




Figura 29. Ndërmjetësimi financiar sipas sektorëve





Figura 30. Ndërmjetësimi financiar i sektorit bankar në vendet e Ballkanit Perëndimor (raporti i kredive ndaj BPV-së)



Sa i përket numrit të institucioneve financiare që e përbëjnë sistemin financiar, gjendja mbetet pothuajse e njëjtë krahasuar me vitin paraprak. Sektori i ndihmësve financiarë ishte i vetmi sektor në të cilin u shtuan 3 institucione të reja, duke quar numrin e tyre në 46. Si rrjedhojë, në qershor 2016, numri i gjithsej institucioneve financiare të licencuara për të operuar në vend arriti në 91 (tabela 1).

Tabela 1. Numri i institucioneve financiare¹²

| Përshkrimi | Qershor 2013 | Qershor 2014 | Qershor 2015 | Qershor 2016 |
|--|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Bankat komerciale | 9 | 10 | 10 | 10 |
| Kompanitë e sigurimeve | 13 | 13 | 15 | 15 |
| Fondet pensionale | 2 | 2 | 2 | 2 |
| Ndihmësit financiar | 40 | 41 | 43 | 46 |
| Institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare | 18 | 18 | 18 | 18 |

Burimi: BQK (2016)


5.2 Ekspozimi ndaj sektorit të jashtëm¹³

Vlera e asetëve të jashtme neto (AJN) të sistemit financiar të Kosovës në qershor 2016 arriti në 2.6 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 3.9 përqind. Ekspozimi i sistemit financiar ndaj sektorit të jashtëm në qershor 2016 ishte i ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Asetet e jashtme përbënin 47.4 përqind të gjithsej asetëve të sistemit financiar (48.9 përqind në qershor 2015). Në anën tjetër, detyrimet e jashtme përbënin 8.6 përqind të gjithsej detyrimeve të sistemit (8.1 përqind në qershor 2015) (figura 31).

AJN-të e BQK-së përfaqësojnë pjesën më të madhe të gjithsej AJN-ve të sistemit financiar me pjesëmarrje prej 49 përqind, pasuar nga fondet pensionale me pjesëmarrje prej 41.6 përqind. Bilancit pozitiv të gjithsej AJN-ve i kontribuojnë edhe AJN-të e sektorit bankar me pjesëmarrje prej 12 përqind ndërsa, sektori mikrofinanciar ishte i vetmi që shënoi bilanc negativ prej 2.6 përqind të gjithsej AJN-ve (figura 31).


Ekspozimi i BQK-së ndaj sektorit të jashtëm është mjaft i theksuar ku asetet e jashtme përbëjnë 96.6 përqind të gjithsej asetëve të BQK-së, kryesisht në formë të depozitave në bankat jashtë vendit dhe të letrave me vlerë të huaja. Ndërsa detyrimet ndaj sektorit të jashtëm përbëjnë 17.8 përqind të gjithsej detyrimeve të BQK-së, kryesisht në formë të llogarisë

Figura 31. AJN-të sipas sektorëve financiarë



Burimi: BQK (2016)

Figura 32. Ekspozimi i jashtëm sipas sektorëve financiar, qershor 2016



Burimi: BQK (2016)

¹² Numri i institucioneve financiare paraqet numrin e institucioneve që janë të licencuara të operojnë në tregun e Kosovës. Në kuadër të kategorisë së institucioneve mikrofinanciare janë përfshirë edhe pesë institucioneve financiare jobankare të licencuara për aktivitet kredidhënës.

¹³ Në këtë kontekst, sistemi financiar nuk përfshinë Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.


me FMN. Sektori i fondeve pensionale vazhdon të jetë sektori i dytë më i ekspozuar ndaj sektorit të jashtëm, ku 81.2 përqind e aseteve të fondeve pensionale janë të investuara jashtë vendit, kryesisht në formë të aksioneve dhe ekuiteteve tjera. Sektori bankar vazhdoi të ketë ekspozimin më të ulët ndaj sektorit të jashtëm, ndërsa sektori i sigurimeve nuk ka pothuajse fare ekspozim ndaj sektorit të jashtëm. Raporti i aseteve të jashtme ndaj gjithsej aseteve të sektorit bankar është 15.5 përqind, përderisa raporti i detyrimeve të jashtme ndaj gjithsej detyrimeve të sektorit bankar është 6.4 përqind, duke reflektuar shkallën e ulët të mbështetjes së sektorit bankar në financimin e jashtëm. Për dallim nga sektorët tjerë, sektori mikrofinanciar ka ndërveprim me sektorin e jashtëm vetëm në kuadër të detyrimeve, ku 50.2 përqind e aktivitetit të këtij sektori financohet nga jashtë. Kjo për arsye se sektori mikrofinanciar shfrytëzon linjat kreditore të jashtme për të financuar aktivitetin kreditues, duke pasur parasysh se IMF-të nuk kanë të drejtë ligjore të pranojnë depozita.

Vlera e aseteve të sistemit financiar në sektorin e jashtëm arriti në 3.17 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 5.9 përqind (figura 33).¹⁴ Në rritjen e aseteve të jashtme ndikoi rritja e investimeve të BQK-së prej 14.2 përqind në sektorin e jashtëm, kryesisht në formë të letrave me vlerë. Po ashtu edhe investimet e fondeve pensionale kanë shënuar rritje vjetore prej 1.9 përqind, ndërsa sektori bankar shënoi rënie prej 6.7 përqind në qershor 2016, duke u karakterizuar me rënie të investimeve në sektorin e jashtëm për të dytin vit me

radhë. Zvogëlimi i ekspozimit të sektorit bankar u reflektua kryesisht në kreditimin e sektorit të jashtëm dhe në depozitat jashtë vendit, të cilat shënuan rënie vjetore prej 5.8 përkatësisht 22.1 përqind. Kjo rënie mund të ketë ndodhur si rezultat i rritjes së përsheptuar të kreditimit për ekonominë vendore dhe, në anën tjetër, ngadalësimit të rritjes së depozitave në sektorin bankar.


Kategoria kryesore e aseteve në sektorin e jashtëm janë depozitat, mirëpo në qershor 2016 kjo kategori shënoi rënie të theksuar vjetore prej 17.2 përqind. Këto depozita i përkasin bankave komerciale dhe BQK-së dhe arsyeja e rënies së tyre mund të ndërlidhet me vendimin e BQE-së për të mbajtur nivelin e normës së interesit të depozitave në territor negativ. Kategoria e dytë e aseteve të jashtme përbëhet nga aksionet dhe ekuitetet tjera, që i përkasin fondeve pensionale. Në qershor 2016, kjo kategorishënoi ngadalësim të rritjes, krahasuar me periudhën e njëjte të vitit të kaluar. Investimet në letra me vlerë, që janë kategoria e tretë e aseteve të jashtme, shënuan rritje të theksuar vjetore prej 89.8 përqind (rënie

Figura 33. Struktura e aseteve në sektorin e jashtëm, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Figura 34. Struktura e detyrimeve të jashtme, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

¹⁴ Në kuadër të kërkesave të sistemit financiar të Kosovës ndaj sektorit të jashtëm nuk është përfshirë kategoria 'paraja e gatshme'. Në statistikat monetare dhe financiare, kategoria 'paraja e gatshme' që ndodhet në trezorët e bankave komerciale trajtohet si aset i jashtëm (kërkesa ndaj jorezidentëve) për faktin se valuta euro nuk është valutë kombëtare e Kosovës, mirëpo në këtë analizë këto mjete nuk janë trajtuar si të tilla për shkak se ato janë mjete që mbahen në bankat në Kosovë.

prej 50.2 përqind në qershor 2015). Pjesa më e madhe e investimeve në letra me vlerë i përkasin BQK-së, që këtë vit pothuaj kanë trefishuar investimet në letra me vlerë, pas rënies së pësuar në vitin paraprak (figura 33).

Vlera e gjithsej detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm në qershor 2016 arriti në 575.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 16.0 përqind. Në rritjen e detyrimeve të jashtme ndikoi rritja e llogarisë së BQK-së në FMN, pasuar nga rritja e kredive të sektorit bankar dhe të atij mikrofinanciar të marra nga sektori i jashtëm. Struktura e detyrimeve të jashtme vazhdon të dominohet nga llogaria e BQK-së në FMN që shënoi rritje vjetore prej 35.9 përqind, ndërsa kategoria e dytë e detyrimeve të jashtme, që janë kreditë, shënuan rritje vjetore prej 13.9 përqind (figura 34).

6. Sektori Bankar i Kosovës


6.1 Struktura e Sektorit Bankar

Bankat me pronësi të huaj vazhdojnë të dominojnë sektorin bankar të Kosovës, ku nga gjithsej dhjetë banka të licencuara që operojnë në vend, tetë janë me pronësi të huaj.¹⁵ Bankat me pronësi të huaj, në qershor 2016, menaxhuan 89.8 përqind të gjithsej aseteve dhe zotëruan 91.9 përqind të gjithsej kapitalit të sektorit bankar. Nga bankat me pronësi të huaj, pesë prej tyre kanë vend të origjinës Austrinë, Gjermaninë, Slloveninë, Shqipërinë dhe Serbinë, përderisa tri të tjera kanë vend të origjinës Turqinë (figura 35). Në sektorin bankar të Kosovës operojnë edhe dy banka me pronësi vendore.

Sektori bankar vazhdoi të karakterizohet me rënie të shkallës së koncentrimit të tregut edhe gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2016, gjë e cila mund të konsiderohet si tregues i rritjes së konkurrencës në këtë sektor. Pjesëmarrja e tri bankave më të mëdha në gjithsej asetet e sektorit, në qershor 2016 qëndroi në 63.3 përqind, rënie


vjetore prej 2.1 pikë përqindje. Rënia e shkallës së koncentrimit të tregut vërehet edhe përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (IHH), i cili tregon për një rënie të vazhdueshme të koncentrimit (figura 36). Gjatë kësaj periudhe, koncentrimi në kredi ka shënuar rënie më të theksuar kurse koncentrimi në depozita ka shënuar rënie më të ngadalshme. Rënia e koncentrimit, si në kredi ashtu edhe në depozita, erdhi si rezultat i rritjes më të shpejtë të këtyre zërave nga ana e bankave më të vogla. Në qershor 2016, tri bankat më të mëdha shënuan rritje vjetore të kredive prej 4.4 përqind, përderisa kreditë e bankave më të vogla shënuan rritje prej 16.1 përqind. Për sa i përket depozitave, tri bankat më të mëdha shënuan rritje vjetore prej 3.6 përqind, krahasuar me rritjen prej 6.7 përqind në bankat tjera më të vogla.

Figura 35. Struktura e aseteve të sektorit bankar, sipas pronësisë



Burimi: BQK (2016)

Figura 36. Shkalla e koncentrimit në sektorin bankar



Burimi: BQK (2016)


¹⁵ Me banka nënkuptojmë filialet dhe degët e bankave të huaja që janë të licencuara për të operuar në Kosovë.

6.2. Aktiviteti i Sektorit Bankar

6.2.1. Asetet

Asetet e sektorit bankar të Kosovës në qershor 2016 shënuan vlerën prej 3.43 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 5.0 përqind (6.9 përqind në qershor 2015) (figura 37). Norma më e ulët e rritjes në krahasim me vitin paraprak reflekton ritmin më të ngadalshëm të rritjes së depozitave gjatë viteve të fundit. Kontributin më të lartë në rritjen e asetëve të sektorit e kishte rritja e portfolios së kredive, e cila vazhdon të jetë kategoria kryesore e asetëve të sektorit bankar dhe po rritet me ritëm të përshpejtuar. Struktura e asetëve të sektorit bankar mbeti mjaft e ngjashme në krahasim me periudhat paraprake, ku pjesa dërmuese e asetëve (84.9 përqind e gjithsej asetëve) mbetën të investuara në instrumente që sjellin fitim, siç janë kreditë, letrat me vlerë dhe bilancet me bankat komerciale (tabela 2).

Figura 37. Struktura e asetëve të sektorit bankar



Burimi: BQK (2016)


Tabela 2. Struktura e asetëve të sektorit bankar

| Përshkrimi | Qershor 2013 | | Qershor 2014 | | Qershor 2015 | | Qershor 2016 | |
|-------------------------------------|----------------|-----------------|----------------|-----------------|----------------|-----------------|----------------|-----------------|
| | Milionë euro | Pjesëmarrja (%) | Milionë euro | Pjesëmarrja (%) | Milionë euro | Pjesëmarrja (%) | Milionë euro | Pjesëmarrja (%) |
| Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK | 355.4 | 12.8% | 358.2 | 11.7% | 397.4 | 12.2% | 433.2 | 12.6% |
| Bilanci me bankat komerciale | 261.4 | 9.4% | 318.7 | 10.4% | 341.9 | 10.5% | 285.7 | 8.3% |
| Letrat me vlerë | 246.3 | 8.8% | 405.3 | 13.2% | 443.8 | 13.6% | 453.1 | 13.2% |
| Kreditë bruto | 1,825.7 | 65.5% | 1,889.9 | 61.8% | 2,005.2 | 61.3% | 2,173.5 | 63.3% |
| Asetet fikse | 57.6 | 2.1% | 55.2 | 1.8% | 52.7 | 1.6% | 56.5 | 1.6% |
| Asetet tjera | 40.5 | 1.5% | 32.2 | 1.1% | 28.6 | 0.9% | 30.0 | 0.9% |
| Gjithsej asetet | 2,787.0 | 100% | 3,059.5 | 100% | 3,269.6 | 100% | 3,432.1 | 100% |

Burimi: BQK(2016)

Shuma e investimeve të sektorit bankar në letra me vlerë në qershor 2016 arriti në 453.1 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 2.1 përqind (9.5 përqind në qershor 2015) (figura 38). Rritja e investimeve në letra me vlerë i atribuohet rritjes së investimeve në letra me vlerë të qeverive të huaja, për dallim nga viti paraprak kur kontributin kryesor në rritjen e gjithsej investimeve në letra me vlerë e kishin investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Në qershor 2016, investimet në letra me vlerë në sektorin e jashtëm, që kryesisht përbëhen nga fletëobligacionet e qeverive të huaja (figura 39), regjistruan rritje vjetore prej 10.1 përqind (-5.7 përqind në qershor 2015).


Figura 38. Asetet e sektorit bankar, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2016)

Investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës, shënuan rënie vjetore prej 6.2 përqind krahasuar me rritjen e theksuar vjetore prej 31.1 përqind në qershor 2015. Ky zhvillim është rezultat i rritjes së konkurrencës edhe nga akterët e tjerë të tregut si fondet pensionale, kompanitë e sigurimeve, institucionet e tjera publike, të cilët kanë rritur shumën e investuar në letra me vlerë të Kosovës. Investimet në letrat me vlerë të korporatave tjera financiare dhe jo-financiare jashtë vendit, që konsiderohen instrumente me shkallë më të lartë të rrezikut, vazhdojnë të kenë pjesëmarrje të ulët në portofolin e investimeve në letra me vlerë.


Figura 39. Struktura e letrave me vlerë, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Kategoria e parasë së gatshme dhe bilancit me BQK-në gjatë kësaj periudhe shënoi rritje vjetore prej 9.0 përqind (11.0 në qershor 2015). Kjo rritje mund të jetë si rezultat i ambientit me norma të ulëta të interesit që po mbizotërojnë në vendet e Bashkimit Evropian, që ka ndikuar në zhvendosjen e një pjese të mjeteve që bankat mbajnë jashtë vendit drejt parasë së gatshme. Kjo ngase kategoria e bilancit me bankat komerciale ishte e vetmja që u zvogëlua, duke shënuar rënie vjetore prej 16.4 përqind në qershor 2016, krahasuar me rritjen prej 7.3 përqind të shënuar në qershor 2015.

Figura 40. Kontributi i sektorëve në rritjen e gjithsej kreative, në pikë përqindje




Burimi: BQK (2016)

Kreditë

Kreditë mbeten kategoria dominuese e aseteve të sektorit bankar, me pjesëmarrje prej 63.3 përqind. Në qershor 2016, vlera e gjithsej kreative arriti në 2.17 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 8.4 përqind (6.1 përqind në qershor 2015) (figura 40). Përshpejtimi i rritjes së aktivitetit kredidhënës, sipas anketës së kreditimit bankar, mund të jetë nxitur si nga ana e ofertës, gjegjësisht përmirësimi i kushteve të kreditimit ndaj ekonomive familjare, ashtu edhe nga ana e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare.

Figura 41. Struktura e kredive sipas sektorëve në vendet e rajonit



Burimi: Bankat Qendrore të vendeve të rajonit (2016)

Pjesa më e madhe e kredive të sektorit bankar vazhdon të përbëhet nga kreditë për ndërmarrje, të cilat përfaqësojnë 64.8 përqind të gjithsej kreative, ndërsa kreditë për ekonomitë familjare përfaqësojnë 35.0 përqind të gjithsej kreative. Po ashtu edhe në vendet e rajonit, kreditë ndaj ndërmarrjeve dominojnë strukturën e gjithsej kreative (figura 41). Për të dytin vit me radhë, zgjerimi i

kreditimit ndaj ekonomive familjare ka dhënë kontributin kryesor në rritjen e gjithsej kreditimit në vend. Kreditë për ekonomitë familjare shënuan rritje vjetore prej 15.2 përqind, që i atribuohet rritjes së lartë të kredive të reja konsumuese. Ndërsa, kreditë e reja hipotekare që përfaqësojnë 14.8 përqind të gjithsej kredive të reja ndaj ekonomive familjare, shënuan ngadalësim të theksuar të rritjes në gjashtëmujorin e parë të vitit 2016 krahasuar me periudhën paraprake. Ky trend ndërlihet me raportimet e bankave në anketën e kreditimit bankar se ka pasur kërkesë më të lartë për kredi konsumuese krahasuar me kreditë hipotekare.

Kreditë ndaj ndërmarrjeve në qershor 2016 shënuan rritje vjetore prej 5.2 përqind, ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, përkundër rënies vjetore të kredive të reja për ndërmarrje prej 17.4 përqind. Rënia e kredive të reja përkon me rezultatet e anketës së kreditimit bankar sipas së cilës aktiviteti kreditues ndaj ndërmarrjeve është karakterizuar me shtrëngim të kushteve të kreditimit nga ana e bankave përmes aplikimit të normave më të larta të interesit, rritjes së kërkesave për kolateral dhe zvogëlimin të afatit të maturimit në kreditë e ofruara.

Struktura e kredive të ndërmarrjeve sipas veprimtarisë

Struktura e kredive të ndërmarrjeve sipas veprimtarisë ekonomike mbetet e ngjashme me periudhat paraprake (figura 42). Kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë paraqesin kategorinë më të madhe të gjithsej kredive për ndërmarrjet, pasuar nga kreditë e destinuar për sektorin e industrisë së prodhimit, dhe kreditë për sektorin e ndërtimitarisë. Sektori i bujqësisë vijon të ketë qasje më të ulët në kreditimin bankar përkundër rritjes së shënuar në vitet e fundit. Sektorët ekonomik të cilët përgjithësisht kanë pjesëmarrje më të ulët në kreditimin bankar, siç janë sektori i shërbimeve financiare dhe patundshmëri, shërbimeve tjera, minierave dhe ai i bujqësisë shënuan rritje më të theksuar gjatë kësaj periudhe. Këta sektor njëkohësisht kishin edhe kontributin kryesor në ruajtjen e ritmit të rritjes së kreditimit për ndërmarrje ngjashëm me periudhën paraprake (figura 43). Sektori i tregtisë shënoi ngadalësim të rritjes prej 1.1 përqind në qershor 2016 krahasuar me rritjen vjetore prej 8.8 përqind në qershor 2015. Po ashtu edhe kreditë e reja ndaj sektorit të tregtisë gjatë periudhës janar-qershor 2016 shënuan rënie vjetore prej 27.9 përqind krahasuar me rritjen prej 18.6 përqind në periudhën paraprake. Sektori i prodhimtarisë, që në dy periudhat paraprake kishte rritje dyshifrore, në qershor 2016 shënoi rënie vjetore prej 0.6 përqind. Po ashtu, kreditë për sektorin e ndërtimitarisë, për të katërtin vit me radhë u karakterizuan me rënie. Kreditë për sektorin e minierave, në qershor 2016, shënuan rritje vjetore prej 48.8 përqind që paraqet një përmirësim të theksuar krahasuar me rënie vjetore prej 8.5 përqind në qershor 2015.

Figura 42. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike, në përqindje





Figura 43. Kreditë sipas veprimtarisë ekonomike, ndryshimi vjetor




Kreditë për sektorin e shërbimeve financiare dhe patundshmëri, të cilat përfaqësuan 7.2 përqind të gjithsej kredive ndaj ndërmarrjeve në qershor 2016, shënuan rritje vjetore prej 38.3 përqind. Rritja e kreditimit për këtë sektor mund të jenë edhe si rezultat i rritjes së ndërmarrjeve të reja të regjistruara për të ushtruar aktivitet financiar, sigurime dhe patundshmëri, ku deri në qershor 2016 u regjistruan 133 ndërmarrje të reja krahasuar me 57 të tilla të regjistruara në periudhën paraprahe. Po ashtu, sipas të dhënave të fundit nga ASK-ja për rritjen reale të BPV-së sipas sektorëve ekonomik, sektori i aktivitetit financiar dhe të sigurimit ka rritur vlerën e shtuar në rritjen ekonomike të Kosovës, çka sugjeron për rritje të aktivitetit në këtë sektor.

Sektori tjetër i karakterizuar me rritje të kreditimit, ishte sektori i bujqësisë që shënoi rritje prej 10.4 përqind. Vlera e gjithsej kredive për këtë sektor në qershor 2016 arriti në 56.4 milionë nga 51.0 milionë në qershor 2015. Rritja e kreditimit për këtë sektor është nxitur si nga ana e kërkesës për kredi ashtu edhe nga ana e ofertës. Intensifikimi i programeve për subvencione dhe grante në sektorin e bujqësisë ka ndikuar në rritjen e aktivitetit të këtij sektori, duke krijuar kështu kushtet edhe për rritje të kërkesës për kredi. Në anën e ofertës kreditore, bankat kanë lehtësuar kushtet e kreditimit ku vihet re një rënie e vazhdueshme e normave të interesit për kredi bujqësore, të cilat në qershor 2016 kishin një mesatare prej 7.2 përqind (7.3 përqind në qershor 2015, 13.1 përqind në qershor 2014). Kreditë e lëshuara për sektorin e energjetikës, që përfaqësojnë 1.5 përqind të gjithsej kredive ndaj ndërmarrjeve, në qershor 2016 shënuan rritje vjetore prej 5.9 përqind, krahasuar me rritjen prej 12.2 përqind në qershor 2015.

Struktura e kredive sipas afatit të maturimit


Struktura e kredive sipas afatit të maturimit nuk ka pësuar ndryshime të theksuara krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kreditë me afat të gjatë maturimi zgjeruan pjesëmarrjen në gjithsej portofolin e kredive, kundrejt zvogëlimit të pjesëmarrjes së kredive me afat më të shkurtër maturimi. Në qershor 2016 kreditë me afat maturimi 'mbi 2 vite deri në 5 vite' përfaqësuan pjesën më të madhe të gjithsej kredive, të cilat megjithatë zvogëluan pjesëmarrjen për 1.6 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (figura 44). Ndërsa kategoria e dytë e kredive sipas afatit të maturimit, që janë kreditë me maturim 'mbi 5 vite', në qershor 2016 rritën pjesëmarrjen. Pjesa më e madhe e këtyre kredive me maturim 'mbi 5 vite' i përket ekonomive familjare dhe rritja e tyre përkon me rezultatet e anketës së kreditimit bankar se ka pasur përmirësim të kushteve kreditore nga ana e bankave, ndër të cilat rritje të afatit të maturimit të ofruar në kreditë ndaj ekonomive familjare (figura 45).

Figura 44. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Figura 45. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit për ndërmarrje dhe ekonomi familjare, qershor 2016




Burimi: BQK (2016)

Kreditë me afat maturimi ‘mbi 1 deri në 2 vite’, në qershor 2016 zgjeruan pjesëmarrjen në gjithsej kreditë për 0.2 pikë përqindje, ndërsa, kreditë me afat të shkurtër maturimi, gjegjësisht ‘deri në 1 vit’, zvogëluan pjesëmarrjen e tyre për 2.0 pikë përqindje. Kjo gjithashtu përkon me deklaratimet e bankave në anketën e kreditimit bankar, që në periudhën e fundit rritja e kërkesës si nga ndërmarrjet ashtu edhe nga ekonomitë familjare ishte më e theksuar për kredi afatgjata se sa për kredi afatshkurtra.

Kreditë e reja


Kreditë e reja të lëshuara nga sektori bankar deri në qershor 2016 arritën vlerën 533.9 milionë euro, që përkon me rënie vjetore prej 4.0 përqind (figura 46).

Figura 46. Gjithsej kreditë dhe kreditë e reja, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2016)

Figura 47. Kreditë e reja, në milionë euro




Burimi: BQK (2016)

Kreditë e reja ndaj ndërmarrjeve shënuan rënie vjetore prej 17.4 përqind, ndërsa kreditë e reja të destinuara për ekonomitë familjare shënuan rritje vjetore prej 18.7 përqind (figura 47).


Në kuadër të kredive të reja ndaj ndërmarrjeve, kreditë investuese që përfaqësojnë pjesën më të madhe të këtyre kredive (58.7 përqind), shënuan rënie vjetore prej 24.3 përqind (figura 48). Ndërsa, kreditë jo-investuese, të cilat deri në qershor 2016 përfaqësonin 33.9 përqind të kredive të reja ndaj ndërmarrjeve, shënuan rënie vjetore prej 6.7 përqind. Pjesa tjetër e kredive të reja të lëshuara për ndërmarrjet përfaqësohet nga kreditë me kushte favorizuese.

Figura 48. Kreditë e reja sipas sektorëve, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2016)

Figura 49. Kreditë e reja sipas sektorëve dhe qëllimit të përdorimit



Burimi: BQK (2016)

Struktura e kredive të reja ndaj ekonomive familjare vazhdon të dominohet nga kreditë konsumuese të cilat deri në qershor 2016 shënuan rritje vjetore prej 19.4 përqind (figura 49). Ngjashëm, rritje shënuan edhe kreditë e reja hipotekare dhe ato me kushte favorizuese. Kreditë e reja hipotekare u rritën për 10.6 përqind (41.4 përqind në qershor 2015), ndërsa kreditë me kushte favorizuese u rritën për 25 përqind duke rritur pjesëmarrjen në 8.7 përqind të kredive të reja ndaj ekonomive familjare (8.3 përqind në qershor 2015).

Efekti i kredive të reja të lëshuara gjatë gjysmës së parë të këtij viti në rritjen e gjithsej stokut të kredive është zvogëluar nga vlera e kredive të shlyera (write-offs) si dhe kredive të kthyera gjatë periudhës. Përderisa kreditë e reja të lëshuara gjatë gjysmës së parë të këtij viti ndikuan në rritjen e stokut të kredive për afër 38.9 përqind¹⁶, kreditë e shlyera e zvogëluar stokun e kredive për 0.6 përqind ndërsa kreditë e kthyera e zvogëluar këtë efekt për 29.8 përqind.

Anketa e Kreditimit Bankar¹⁷

Rezultatet e fundit të Anketës së Kreditimit Bankar¹⁸ pasqyrojnë zhvillimet në aktivitetin e kreditimit bankar gjatë periudhës mars – gusht 2016 (referuar si P2 2016)¹⁹, si dhe pritjet për aktivitetin kreditues në periudhën shtator 2016 – shkurt 2017 (referuar si P1 2017).


Dinamika e aktivitetit kreditues për **ndërmarrjet** gjatë kësaj periudhe, sipas anketës së kreditimit bankar, rezulton të jetë ndikuar negativisht nga ana e ofertës kreditore. Bankat raportuan se kanë shtrënguar standardet e aplikuara gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ndërmarrjeve për kredi. Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, standardet kreditore për NVM-të u shtrënguan më tepër se sa standardet për ndërmarrjet e mëdha.

Për periudhën shtator 2016 – shkurt 2017, bankat deklaruan që presin shtrëngim të standardeve kreditore për ndërmarrjet në përgjithësi, veçanërisht për kreditë për ndërmarrjet e mëdha (figura 50).

Në kuadër të ofertës kreditore, bankat po ashtu raportuan të kenë shtrënguar kushtet dhe rregullat e kreditimit për ndërmarrjet. Për NVM-të, bankat shtrënguan kushtet e kreditimit kryesisht përmes rritjes së normës mesatare të interesit dhe rritjes së kërkesës për kolateral. Për kreditë e ndërmarrjeve të mëdha, bankat deklaruan të kenë rritur kërkesat për kolateral dhe të kenë zvogëluar maturitetin e ofruar për kredi (figura 51).

Për periudhën shtator 2016 – shkurt 2017, bankat presin shtrëngim të kushteve të kreditimit për të dy kategoritë e ndërmarrjeve, konkretisht, rritje të kërkesës për kolateral. Për ndërmarrjet e mëdha, përveç kërkesave më të larta për kolateral, kushtet e kreditimit pritjet të shtrëngohen edhe përmes rritjes së normës mesatare të interesit së ofruar.

Figura 50. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve të ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2016)


¹⁶ Të dhënat për kredi të reja, të shlyera dhe të kthyera përfshijnë edhe lëvizjet në mjetet jashtëbilancore.

¹⁷ Anketa e Kreditimit Bankar realizohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës me bankat që operojnë në Kosovë. Anketa realizohet dy herë në vit, duke përfshirë periudhën mars – shtator dhe periudhën tetor – shkurt.

¹⁸ Përgjigjet e bankave individuale janë agreguar duke përdorur peshën përkatëse të çdo banke në gjithsej portfolion kreditore të sektorit bankar. Vlerat pozitive e indeksit të standardeve kreditore tregojnë lehtësim dhe vlerat negative tregojnë shtrëngim. Gjithashtu, vlerat pozitive e indeksit të kërkesës për kredi tregojnë rritje të kërkesës dhe vlerat negative tregojnë rënie.

¹⁹ Periudhës shtator – shkurt të cilët vit i referohemi si 'periudha e parë' – P1, ndërsa periudhës mars – gusht të cilët vit i referohemi si 'periudha e dytë' – P2.

Figura 51. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ndërmarrjeve (mars – shtator 2016)



Burimi: BQK (2016)


Faktori kryesor, i deklaruar nga bankat, që ndikoi në shtrëngimin e standardeve kreditore ishte rritja e rrezikut të perceptuar për mosrealizimin e kolateralit.

Gjatë periudhës raportuese, bankat deklaruan rritje të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet. Kërkesa për kredi ka qenë më e lartë veçanërisht nga NVM-të, përderisa sa i përket maturitetit, bankat kanë raportuar përgjithësisht rritje të kërkesës për kreditë afatgjata. (figura 52). Rritja e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, sipas anketës, është mbështetur kryesisht nga rritja e financimit të kapitalit punues dhe financimit të investimeve fikse të ndërmarrjeve. Për periudhën shtator 2016 – shkurt 2017, bankat presin rritje të mëtutjeshme të kërkesës për kredi nga të dy kategoritë e ndërmarrjeve.

Në kuadër të kërkesës për kredi, bankat raportuan për përkeqësim të cilësisë së aplikacioneve të pranuar nga NVM-të, ndërsa përmirësim të cilësisë së aplikacioneve të pranuar nga ndërmarrjet e mëdha.


Rritja e kredive të reja për ekonomitë familjare gjatë periudhës raportuese, sipas anketës së kreditimit bankar, i është atribuar kryesisht lehtësimit të standardeve kreditore të aplikuara nga bankat gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ekonomive familjare dhe përmirësimit të kushteve dhe rregullave të kreditimit, si dhe rritjes së theksuar të kërkesës për kredi. Standarde të lehtësuara kreditore u aplikuan veçanërisht për kreditë konsumuese (figura 53). Në gjashtë muajt e ardhshëm (shtator 2016 - shkurt 2017), bankat presin lehtësim të standardeve kreditore

Figura 52. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet



Burimi: BQK(2016)


Figura 53. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK (2016)

dhe përmirësim të mëtejme të kushteve të kreditimit për të dy kategoritë kredive për ekonomitë familjare, gjegjësisht kreditë konsumuese dhe kreditë për blerje të shtëpive.

Figura 54. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ekonomive familjare (mars – shtator 2016)




Burimi: BQK (2016)

Përmirësimi i kushteve të kreditimit për ekonomitë familjare gjatë periudhës raportuese kryesisht është realizuar përmes uljes së normave të interesit për kreditë, rritjes së madhësisë së kredive të aprovuara, rritjes së maturitetit, zvogëlimit të ngarkesave të tjera nga norma e interesit dhe zvogëlimit të kërkesave për kolateral (figura 54). Në gjashtë muajt e ardhshëm, bankat kanë deklaruar se presin që kushtet e kreditimit përgjithësisht të mbesin të lehtësuara për ekonomitë familjare, me përjashtim të kërkesave për kolateral që priten të shtrëngohen deri në një masë. Rritja e konkurrencës në tregun kreditor në vend ishte faktori kryesor që ndikoi në lehtësimin e standardeve kreditore për ekonomitë familjare.

Përveç ofertës së lehtësuar për kredi, bankat raportuan edhe rritje të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, veçanërisht të kërkesës për kredi konsumuese (figura 55). Kërkesa e rritur nga ekonomitë familjare kryesisht i është atribuar rritjes së besueshmërisë së konsumatorëve, rritjes së shpenzimeve tjera për konsum dhe zhvillimeve në tregun e pasurive të paluajtshme. Gjithashtu, cilësia e aplikacioneve të pranuar, si për kredi konsumuese ashtu edhe për kredi për blerje të shtëpive, rezultojnë të jetë përmirësuar. Për periudhën shtator 2016 – shkurt 2017, bankat presin rritje të mëtejme të kërkesës për kredi nga të dy kategoritë e ekonomive familjare.

Figura 55. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK (2016)

6.2.2. Detyrimet dhe burimet vetanake

Aktiviteti i sektorit bankar të Kosovës vazhdon të financohet kryesisht nga depozitat e mbledhura brenda ekonomisë së Kosovës (tabela 3). Burim tjetër mjaft i rëndësishëm i financimit të sektorit bankar janë burimet vetanake (ekuiteti), të cilat në qershor 2016 shënuan rritje vjetore prej 15.1 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së profitit të realizuar nga bankat.

Tabela 3. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake të sektorit bankar

| Përshkrimi | Qershor 2013 | | Qershor 2014 | | Qershor 2015 | | Qershor 2016 | |
|--|----------------|-----------------|----------------|-----------------|----------------|-----------------|----------------|-----------------|
| | Milionë euro | Pjesëmarrja (%) | Milionë euro | Pjesëmarrja (%) | Milionë euro | Pjesëmarrja (%) | Milionë euro | Pjesëmarrja (%) |
| Bilanci nga bankat tjera | 20.2 | 0.7% | 29.9 | 1.0% | 55.6 | 1.7% | 90.7 | 2.6% |
| Depozitat | 2,201.3 | 79.0% | 2,421.0 | 79.1% | 2,574.6 | 78.7% | 2,692.8 | 78.5% |
| Huatë tjera | 14.8 | 0.5% | 17.9 | 0.6% | 13.1 | 0.4% | 18.7 | 0.5% |
| Detyrimet tjera | 241.3 | 8.7% | 243.4 | 8.0% | 229.3 | 7.0% | 189.1 | 5.5% |
| Borxhi i ndërvarur | 36.3 | 1.3% | 57.3 | 1.9% | 47.3 | 1.4% | 38.1 | 1.1% |
| Burimet vetanake | 272.9 | 9.8% | 289.9 | 9.5% | 349.7 | 10.7% | 402.6 | 11.7% |
| Gjithsej detyrimet dhe burimet vetanake | 2,787.0 | 100% | 3,059.5 | 100% | 3,269.6 | 100% | 3,432.1 | 100% |

Burimi: BQK (2016)


Në kuadër të detyrimeve, rritjen më të lartë vjetore prej 63.1 përqind e ka shënuar kategoria e bilancit nga bankat komerciale. Kjo kategori ka peshë të vogël në financimin e aktivitetit të bankave që operojnë në Kosovë, duke përfaqësuar vetëm 2.6 përqind të gjithsej financimit të sektorit bankar në qershor 2016. Ndërsa, kategoria e borxhit të ndërvarur, e cila përfaqëson vetëm 1.1 përqind të gjithsej financimit, vazhdoi të zvogëlohet edhe gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2016, duke shënuar rënie prej 19.4 përqind (rënie prej 17.4 përqind në qershor 2015). Rritja e profitit të sektorit bankar gjatë periudhës së fundit, e cila ka ndikuar në rritjen e kapitalizimit të sektorit, ka zvogëluar nevojën e shfrytëzimit të borxhit të ndërvarur si instrument për përmbushjen e kërkesave të kapitalit.

Depozitat


Gjithsej depozitat në sektorin bankar të Kosovës në qershor 2016 arritën vlerën prej 2.69 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 4.6 përqind. Depozitat për të dytin vit me radhë shënuan ngadalësim të rritjes.

Depozitat e ekonomive familjare, të cilat janë burim më i qëndrueshëm i financimit në raport me kanalet tjera të financimit, vazhdojnë ta dominojnë strukturën e depozitave të sektorit bankar duke përfaqësuar 74.4 përqind të gjithsej depozitave (figura 56). Vlera e depozitave të ekonomive familjare, në qershor 2016, shënoi rritje vjetore prej 5.2 përqind (rritje prej 6.0 përqind në qershor 2015). Kategoria e dytë më e rëndësishme e depozitave, gjegjësisht depozitat e ndërmarrjeve, kishte një pjesëmarrje prej 20.8 përqind në gjithsej depozitat. Kjo kategori e depozitave pothuajse përgjysmoi ritmin e rritjes, duke shënuar rritje vjetore prej 3.7 përqind në qershor 2016 (rritje prej 7.3 përqind në qershor 2015).

Në strukturën e depozitave të ndërmarrjeve vërehet një rritje e peshës së depozitave të korporatave jofinanciare (ndërmarrjet private). Në anën tjetër, depozitat e korporatave tjera financiare dhe veçanërisht korporatave tjera publike zvogëluan pjesëmarrjen e

Figura 56. Depozitat e sektorit bankar


Burimi: BQK (2016)


Figura 57. Depozitat e ndërmarrjeve, në përqindje


Burimi: BQK (2016)

tyre në gjithsej depozitat e ndërmarrjeve (figura 57). Depozitat e korporatave tjera publike shënuan rënie vjetore prej 20.7 përqind, ndërsa depozitat e korporatave tjera financiare shënuan rënie vjetore prej 10.4 përqind në qershor 2016.

Në pjesën e mbetur të gjithsej depozitave përfshihen depozitat e jorezidentëve me pjesëmarrje prej 3.5 përqind dhe depozitat tjera (qeveria dhe organizatat tjera jo-qeveritare) me pjesëmarrje prej 1.4 përqind. Depozitat e jorezidentëve në qershor 2016 arritën vlerën prej 93.2 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 0.5 përqind (figura 58). Ndërsa, depozitat tjera u karakterizuan me rënie vjetore prej 2.1 përqind kryesisht si rezultat i rënies së depozitave të qeverisë qendrore në bankat komerciale.

Figura 58. Depozitat e jo-rezidentëve




Burimi: BQK (2016)

Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit

Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit në dy vitet e fundit u dominua nga depozitat e transferueshme, për dallim nga vitet paraprake kur pjesa më e madhe e depozitave në sektorin bankar ishin të afatizuara (figura 59). Ky ndryshim i strukturës erdhi pas rënies që shënuan normat e interesit në depozita, të cilat dekurajuan depozitorët që t'i afatizojnë depozitat e tyre.


Depozitat e afatizuara vazhduan trendin e rënies edhe gjatë gjashtëmuajt të parë të vitit 2016, por krahasuar me vitin e kaluar kjo rënie ishte më e ngadalshme. Në qershor 2016, depozitat e afatizuara shënuan rënie vjetore prej 9.5 përqind (rënie prej 27.4 përqind në qershor 2015). Depozitat e afatizuara të ekonomive familjare shënuan rënie vjetore prej 7.4 përqind, ndërsa depozitat e afatizuara të ndërmarrjeve shënuan rënie vjetore prej 13.6 përqind. Trend të ngjashëm të rënies në kuadër të depozitave të afatizuara shënuan edhe depozitat e jorezidentëve dhe depozitat tjera (depozitat e qeverisë dhe organizatave tjera joqeveritare) të cilat përfaqësojnë vetëm 1.7 përqind të gjithsej depozitave të afatizuara.

Figura 59. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit



Burimi: BQK (2016)

Figura 60. Depozitat e afatizuara



Burimi: BQK (2016)

Përderisa vlera e përgjithshme e depozitave të afatizuara ka shënuar rënie, përbrenda strukturës së kësaj kategorie të depozitave vërehet rritje e depozitave të afatizuara me afat më të gjatë maturimi. Në qershor 2016, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, është regjistruar rritje e depozitave me afat të mesëm dhe me afat të gjatë maturimi, kurse depozitat me afat të shkurtër maturimi kanë shënuar rënie (figura 60).


6.2.3. Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kredi vazhdoi të karakterizohet me rënie edhe në qershor 2016. Në anën tjetër, norma mesatare e interesit në depozita shënoi rritje të lehtë për të dytin vit me radhë, mirëpo vazhdon të mbetet në nivel mjaft më të ulët se sa në vitet paraprake. Norma mesatare e interesit për kreditë e reja zbriti në 7.2 përqind krahasuar me 7.6 përqind sa ishte në qershor të vitit të kaluar, përderisa norma mesatare e interesit në depozita u ngrit në 1.0 përqind nga 0.8 përqind në qershor 2015. Rënia më e theksuar e normës së interesit në kredi ndikoi që diferenca në mes të normës së interesit në kredi dhe normës së interesit në depozita të zvogëlohet në 6.2 përqind nga 6.8 përqind sa ishte në qershor 2015 (figura 61). Normat mesatare të interesit në kredi dhe depozita në sektorin bankar të Kosovës qëndrojnë në nivele të përafërta me mesataren e normave të interesit të vendeve të rajonit (figura 62).

Normat e interesit në kredi


Norma mesatare e interesit në kredi vazhdoi trendin rënës si te kreditë ndaj ndërmarrjeve ashtu dhe te kreditë ndaj ekonomive familjare (figura 63). Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve zbriti në 6.8 përqind nga 7.4 përqind sa ishte në qershor 2015 (figura 63). Të gjitha kategoritë e kredive të reja ndaj ndërmarrjeve u karakterizuan me rënie të normave të interesit (figura 64). Norma mesatare e interesit për kreditë investuese zbriti në 6.7 përqind krahasuar me 7.1 përqind sa ishte në qershor 2015, ndërsa norma e interesit për kreditë jo-investuese zbriti në 6.8 përqind krahasuar me 8.0 përqind sa ishte një vit më parë. Norma e interesit në kreditë me kushte favorizuese zbriti në 2.5 përqind në qershor 2016 (2.7 përqind në qershor 2015).

Figura 61. Norma mesatare e interesit




Burimi: BQK (2016)

Figura 62. Normat e interesit në Kosovë dhe vendet e rajonit, qershor 2016



Burimi: BQK, FMN (2016)

Figura 63. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare



Burimi: BQK (2016)


Normat e interesit u zvogëluan për të gjitha kategoritë e afateve të maturimit të kredive ndaj ndërmarrjeve, përveç të atyre me afat maturimi ‘mbi 2 deri në 5 vite’ që u karakterizuan me një rritje të lehtë të normës së interesit prej 0.13 pikë përqindje. Kategoria e kredive me afat maturimi ‘mbi 2 deri në 5 vite’, e cila përfaqëson pjesën më të madhe të gjithsej kredive, bartë normën më të lartë të interesit prej 7.5 përqind. Zvogëlimi më i theksuar i normës së interesit në 5.6 përqind nga 7.3 përqind u shënua te kreditë ndaj ndërmarrjeve me afat maturimi ‘mbi 5 deri 10 vite’ (figura 65).

Me rënie të normave të interesit u karakterizuan pothuajse të gjitha kategoritë e kredive sipas veprimtarive ekonomike. Rënia më e theksuar e normës së interesit ishte në kreditë ndaj sektorit të industrisë, që në qershor 2016 zbriti në 6.7 përqind nga 7.7 përqind një vit më parë. Nga të gjitha veprimtaritë e tjera ekonomike, ky sektor mbanë nivelin më të ulët të normës së interesit. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë shënoi rënien e dytë më të lartë duke u zvogëluar në 7.2 përqind nga 7.7 përqind sa ishte në qershor 2015 (figura 66). Sektori i shërbimeve, që përbënë pjesën më të madhe të stokut të kredive, po ashtu u karakterizua me rënie të normës së interesit në 6.8 përqind nga 7.2 përqind në qershor 2015.

Sa i përket kredive ndaj ekonomive familjare, norma mesatare e interesit u zvogëlua në 7.8 përqind nga 8.2 përqind sa ishte në qershor 2015. Zvogëlimi më i theksuar i normës së interesit u regjistrua te kreditë hipotekare nga 7.2 përqind në 6.2 përqind. Ndërsa, në kreditë konsumuese norma e interesit u zvogëlua në 8.0 përqind nga 8.4 përqind sa ishte në qershor 2015 (figura 67).


Në kuadër të kredive hipotekare, kreditë me maturim më afatgjatë kishin norma më të favorshme të interesit krahasuar me ato afatshkurtra. Norma më e ulët e interesit prej 5.5 përqind u regjistrua në kreditë hipotekare me afat maturimi ‘mbi 10 vite’, ndërsa më e larta prej 6.5 përqind u regjistrua në ato me afat maturimi ‘mbi 2 deri në 5 vite’. Kreditë me afat maturimi ‘mbi 10 vite’ gjithashtu shënuan rënien më të theksuar vjetore të normave të interesit prej 2.0 pikë përqindje.

Figura 64. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas qëllimit




Burimi: BQK (2016)

Figura 65. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas maturimit



Burimi: BQK (2016)

Figura 66. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas veprimtarisë ekonomike



Burimi: BQK (2016)

Normat e interesit në depozita


Norma mesatare e interesit në depozita u rrit në 1.0 përqind në qershor 2016 krahasuar me 0.8 përqind sa ishte në qershor 2015. Trendi rritës i normës së interesit në gjithsej depozitat kryesisht u diktua nga rritja e normës së interesit në depozitat e ndërmarrjeve (figura 68). Norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve u karakterizua me rritje për të dytin vit me radhë, duke qëndruar në nivel më të lartë se sa norma e interesit në depozitat ndaj ekonomive familjare e cila u karakterizua me rënie.

Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve u rrit në 1.5 përqind në 1.0 përqind sa ishte në qershor 2015. Rritja e normës së interesit, ndër tjera, mund të jetë reagim i bankave për të stimuluar rritjen e depozitave të ndërmarrjeve, të cilat këtë vit u karakterizuan me ngadalësimin më të theksuar të rritjes. Niveli i normës së interesit në depozitat e ndërmarrjeve u diktua nga norma e interesit në depozitat e afatizuara, të cilat në qershor 2016 shënuan normën më të lartë të interesit prej 1.8 përqind në kategorinë e maturimit ‘mbi 1 deri 2 vite’. Në depozitat e kursimeve, norma e interesit u zvogëluar në 0.04 përqind nga 0.07 përqind sa ishte në qershor 2015 (figura 69).

Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare në qershor 2016 u zvogëluar në 0.7 përqind nga 0.8 përqind sa ishte në qershor 2015 (figura 69). Zvogëlimi i normës mesatare të interesit në depozita reflekton zvogëlimin e normës së interesit në depozitat e afatizuara ngase depozitat tjera bartin interes shumë të ulët (figura 70). Në kuadër të depozitave të afatizuara të ekonomive familjare, norma më e ulët e interesit prej 0.2 përqind u regjistrua në depozitat me afat maturimi ‘mbi 3 deri në 6 muaj’, përderisa ajo më e larta prej 1.8 përqind u regjistrua në depozitat me afat maturimi ‘mbi 2 vite’.


Zvogëlimi më i theksuar vjetor prej 0.3 pikë përqindje u shënuar tek norma e interesit për depozitat me afat maturimi ‘mbi 1 deri në 3 muaj’. Norma e interesit për këtë kategori të

Figura 67. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare, sipas qëllimit




Burimi: BQK (2016)

Figura 68. Norma mesatare e interesit në depozita



Burimi: BQK (2016)

Figura 69. Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve, sipas kategorive



Burimi: BQK (2016)

depozitave, që njëherit paraqet kategorinë që pësuan rënien më të theksuar vjetore në kuadër të gjithsej depozitave, në qershor 2016 zbriti në 0.4 përqind.

6.3. Performanca e Sektorit Bankar


Sektor i bankar edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 vazhdoi të karakterizohet me performancë të mirë financiare duke mbajtur nivel të lartë të profitabilitetit. Profiti i sektorit në qershor 2016 arriti në 37.7 milionë euro, që paraqet rënie krahasuar me vitin paraprak që u karakterizua me profitin më të lartë në historinë e funksionimit të sektorit bankar, prej 44.9 milionë euro (figura 71). Rënia e të hyrave neto nga interesi në njërën anë, dhe rritja e shpenzimeve për provizionet për humbjet nga kreditë, në anën tjetër, kanë ndikuar që profiti gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 të shënojë rënie vjetore prej 15.9 përqind.

Të hyrat

Të hyrat e sektorit bankar gjatë katër viteve të fundit kanë ndjekur trend rënës. Vlera e të hyrave të akumuluar gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 ishte 113.7 milionë euro, që korrespondon me rënie vjetore prej 4.9 përqind. Ndikimin kryesor në rënien e gjithsej të hyrave e kishin të hyrat nga interesi, të cilat shënuan rënie vjetore prej 5.2 përqind. Rënia e të hyrave nga interesi u shkaktua kryesisht nga rënia e normës së interesit në kredi gjatë viteve të fundit.


Me rënie u karakterizua edhe kategoria e dytë e të hyrave që janë të hyrat nga jointerеси, vlera e të cilave ishte për 1 përqind më e ulët krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2015 (figura 72). Kjo rënie ishte rezultat i rënies së theksuar të të hyrave tjera operative, përderisa të hyrat nga tarifat dhe komisionet shënuan rritje. Të hyrat tjera operative u karakterizuan me rënie vjetore prej 22.7 përqind si rezultat i rënies së fitimit nga këmbimet valutore, ndërsa të hyrat nga tarifat dhe komisionet që përfaqësojnë rreth 93.0 përqind të të hyrave nga jointerеси, shënuan rritje vjetore prej 1.1 përqind

Figura 70. Norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare, sipas kategorive




Burimi: BQK (2016)

Figura 71. Performanca financiare e sektorit bankar



Burimi: BQK (2016)

Figura 72. Struktura e të hyrave të sektorit bankar, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Shpenzimet

Për dallim nga tri vitet paraprake që u karakterizuan me rënie të shpenzimeve, sektori bankar gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 shënoi rritje të shpenzimeve. Vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit arriti në 76.0 milionë euro, duke rezultuar për 1.6 përqind më e lartë se në periudhën e njëjtë të vitit 2015. Rritja e shpenzimeve erdhi si rezultat i rritjes së shpenzimeve në formë të provizioneve për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë.


Struktura e shpenzimeve vazhdoi të dominohet nga kategoria e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative me pjesëmarrje prej 63.4 përqind në gjithsej shpenzimet, pasuar nga shpenzimet e jointerestit me pjesëmarrje prej 18.6 përqind dhe shpenzimet e interesit me pjesëmarrje prej 12.5 përqind (figura 73).

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative deri në qershor 2016 shënuan rënie vjetore prej 2.7 përqind (figura 73). Në rënien e kësaj kategorie kontribuan shpenzimet e tjera jo nga interesi të cilat shënuan rënie vjetore prej 51.0 përqind. Po ashtu, rënie prej 0.1 përqind shënuan shpenzimet e personelit, përderisa kategoria e shpenzimeve të përgjithshme regjistroi rritje vjetore prej 31.9 përqind.

Kategoria e dytë e shpenzimeve, që janë shpenzimet jo nga interesi, u karakterizua me rritje vjetore prej 65.1 përqind deri në qershor 2016. Kjo kategori e shpenzimeve kishte kontributin kryesor në rritjen e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar (figura 74). Rritja e shpenzimeve jo nga interesi kryesisht i atribuohet rritjes së theksuar prej 3.1 milionë në 6.3 milionë euro në qershor 2016 të shpenzimeve për provizionet për humbje të kredive. Kjo rritje e shpenzimeve për provizione është rezultat i rritjes së kredive të shlyera gjatë kësaj periudhe të cilat kanë zvogëluar bilancin e provizioneve. Rrjedhimisht, bankat kanë rritur shpenzimet për provizione, në mënyrë që të vazhdojnë të mbajnë në nivel të lartë raportin e mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione (figura 74).


Përkundër rritjes së lehtë të normës së interesit në depozita, shpenzimet e interesit vazhduan të zvogëlohen, duke shënuar rënie vjetore prej 21.2 përqind në qershor 2016 (figura 74). Rënia e kësaj kategorie të shpenzimeve reflekton rënien e depozitave të reja të afatizuara si dhe zvogëlimin e stokut të depozitave të afatizuara gjatë dy viteve të fundit.

Figura 73. Shpenzimet e sektorit bankar, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Figura 74. Shpenzimet e sektorit bankar, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK (2016)

Profitabiliteti dhe efikasiteti

Treguesit e profitabilitetit vazhdojnë të qëndrojnë në nivel të lartë. Megjithatë, si rezultat i rënies së profitit, Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) zbriti në 2.5 përqind nga 3.2 përqind sa ishte në vitin 2015, ndërsa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) zbriti në 20.6 përqind nga 29.1 përqind sa ishte në vitin 2015²⁰ (figura 75).


Treguesi i përgjithshëm i efikasitetit, i shprehur përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave të përgjithshme, gjithashtu shënoi përkeqësim të lehtë krahasuar me vitin paraprak. Ky raport u rrit në 66.8 përqind nga 62.5 përqind sa ishte në qershor 2015, si rezultat i rritjes së shpenzimeve dhe i rënies së të hyrave (figura 76). Në tabelën 4 janë të paraqitur disa tregues tjerë të cilët masin efikasitetin e sektorit bankar në krijimin e të hyrave nga asetet (kreditë, letrat me vlerë dhe huadhëniet ndaj bankave tjera), dhe menaxhimin e shpenzimeve (të depozitave, borxhit të ndërvarur dhe huazimeve tjera). Raporti i të hyrave nga interesi ndaj mesatares së asetëve që sjellin interes ka shënuar rënie në 3.1 përqind deri në qershor 2016 nga 3.4 përqind sa ishte në periudhën paraprake, që mund të ketë rezultuar nga rënia e normave të interesit në kredi. Po ashtu, edhe raporti i shpenzimeve për interesa ndaj mesatares së detyrimeve që shkaktojnë shpenzime ka shënuar rënie në 0.3 përqind deri në qershor 2016 nga 0.5 përqind deri në qershor 2015, kjo për shkak që shpenzimet për interesa në depozita dhe bilancet nga bankat tjera kanë rënë. Zvogëlimi i normave të interesit në kredi si dhe rritja e lehtë e normave të interesit në depozita ndikuan në rënien e të hyrave neto nga interesi, duke zvogëluar rrjedhimisht marginën neto të interesit në 2.8 përqind nga 3.0 përqind sa ishte në qershor 2015. Rënia vjetore e shpenzimeve operacionale si dhe rritja e asetëve ndikuan që raporti ndërmjet tyre të jetë më i ulët se deri në qershor 2015 (tabela 4).

Figura 75. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



*Profiti për 2016 është i përvitësuar
Burimi: BQK (2016)

Figura 76. Raporti shpenzime/të hyra, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Tabela 4. Treguesit kyç të efikasitetit të sektorit bankar, në përqindje

| Përshkrimi | Qershor 2013 | Qershor 2014 | Qershor 2015 | Qershor 2016 |
|---|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Të hyrat nga interesi / mesatarja e asetëve që sjellin të hyra | 4.2% | 3.7% | 3.4% | 3.1% |
| Shpenzimet për interesa / mesatarja e detyrimeve që shkaktojnë shpenzime | 1.4% | 1.1% | 0.5% | 0.3% |
| Margjina neto e interesit (neto të hyrat nga interesi / mesatarja e asetëve që sjellin interes) | 2.8% | 2.7% | 3.0% | 2.8% |
| Shpenzimet operacionale / gjithsej asetet | 1.8% | 1.6% | 1.5% | 1.4% |

Burimi: BQK (2016)

²⁰ Profiti është para tatimit. Treguesit KMK dhe KMA për qershor 2016 janë llogaritur në bazë të profitit të përvitësuar.

Shfrytëzimi i kapaciteteve të sektorit bankar, shprehur përmes indikatorit të vlerës mesatare të aseteve të menaxhuara nga një punëtor, ka shënuar përmirësim (tabela 5). Ky përmirësim u ndikua nga rritja më e lartë e aktivitetit të sektorit bankar, krahas rënies së numrit të të punësuarve në këtë sektor. Megjithatë, një ndër indikatorët e tjerë të shfrytëzimit të kapaciteteve të sektorit bankar është përkeqësuar. Raporti ndërmjet gjithsej shpenzimeve të personelit dhe numrit të punëtorëve në sektorin bankar shënoi rritje për shkak të zvogëlimit më të theksuar të numrit të të punësuarve, krahas rënies së lehtë të shpenzimeve për të punësuarit, çka nënkupton rritje të shpenzimeve për një punëtor (tabela 5).

Tabela 5. Tregues të kapacitetit të sektorit bankar

| Përshkrimi | Qershor 2013 | Qershor 2014 | Qershor 2015 | Qershor 2016 |
|--|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Asetet / nr i punëtorëve (në mijëra euro) | 766.1 | 877.2 | 926.0 | 1,031.3 |
| Shpenzimet e personelit / nr i punëtorëve (në mijëra euro) | 5.8 | 6.0 | 5.9 | 6.3 |

Burimi: BQK (2016)

6.4 Rreziqet e Sektorit Bankar

Indikatorët kryesorë të rreziqeve bankare dhe performancës së sektorit bankar qëndruan në nivele të kënaqshme edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 (tabela 6). Pozita e likuiditetit të sektorit bankar vazhdon të jetë në nivel të qëndrueshëm, përkundër rritjes së përsheptuar të kreditimit. Rritja e përsheptuar e kredive në njërin anë, si dhe rritja e depozitave të transferueshme të cilat ndikuan në rritjen e detyrimeve afatshkurtëra të sektorit, në anën tjetër, kanë ndikuar në rënien e lehtë të treguesit të aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra. Megjithatë, ky tregues vazhdon të mbetet dukshëm mbi nivelin minimal prej 25 përqind të përcaktuar me kërkesat rregullatore.

Tabela 6. Indikatorët e rreziqeve të sektorit bankar

| Përshkrimi | Qershor 2013 | Qershor 2014 | Qershor 2015 | Qershor 2016 |
|---|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Raporti kredi/depozita | 82.9% | 78.1% | 77.9% | 80.7% |
| Raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra | 38.5% | 43.7% | 41.9% | 41.5% |
| Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (TMK) | 15.3% | 17.4% | 19.0% | 18.7% |
| Raporti i kredive joperformuese (KJP) ndaj gjithsej kredive | 7.8% | 8.2% | 7.2% | 5.3% |
| Mbulueshmëria e KJP-ve me provizione | 113.2% | 116.4% | 119.3% | 119.9% |
| Raport i vlerës së gjithsej ekspozimeve të mëdha kreditore ndaj kapitalit të klasit të parë | 91.0% | 124.0% | 81.2% | 61.9% |

Burimi: BQK (2016)

Po ashtu edhe indikatorët e rrezikut të solvencës treguan nivel të lartë të kapitalizimit të sektorit bankar. Raporti i kapitalit rregullativ ka shënuar rënie të lehtë si rezultat i rënies së kapitalit të klasit të dytë. Por, cilësia e kapitalit rregullativ është rritur si rezultat i rritjes së kapitalit të klasit të parë të mbështetur nga profiti i akumuluar ndër vite. Niveli dhe cilësia aktuale e kapitalit sugjeron qëndrueshmëri dhe aftësi të lartë të sektorit bankar për të përballuar humbjet potenciale. Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor ka vazhduar të bie, duke u pasqyruar me normë më të ulët të kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive. Po ashtu, mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizione për humbje nga kreditë është rritur, që tregon për mbrojtje të mirë të sektorit nga humbjet e mundshme nga kreditë. Koncentrimi i rrezikut kreditor shënoi rënie edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2016. Sektori bankar vazhdon të ketë ekspozim të ulët ndaj rrezikut të tregut. Bilanci i gjendjes së sektorit bankar pothuajse në tërësi është i denominuar në valutë euro dhe rrjedhimisht ka ekspozim të ulët ndaj rrezikut të

kursit të këmbimit. Kreditë dhe depozitat e sktorit kryesisht kanë normë fikse të interesit dhe nuk ndikohen nga luhajtjet e interesit deri në maturim. Sidoqoftë ekziston rrezikut ndaj normës së interesit në aspektin e rikimit të aseteve dhe detyrimeve me ndjeshmëri ndaj normave të interesit. Për intervalin e shkurtër të maturimit 'deri në 30 ditë' kemi ngushtim të hendekut negativ krahasuar me vitin paraprak çka ulë ekspozimin e sektorit bankar ndaj rrezikut të rritjes së mundshme të normës së interesit. Ndërsa hendeku kumulativ deri në 1 vit rezultoj pozitiv dhe më i zgjeruar, duke e rritur ekspozimin ndaj rrezikut të rënies së mundshme të normës së interesit. Bankat kanë krijuar sistem, politika dhe procedura të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut operacional. Edhe në gjysmën e parë të vitit 2016, ky rrezik është menaxhuar në mënyrë adekuate duke mos pasur raste të materializimit të tij, dhe duke ndarë kapitalin e nevojshëm për mbulimin e këtij rreziku në pajtueshmëri me kërkesat rregullatore.


6.4.1 Rreziku i likuiditetit

Sektori bankar vazhdon të ketë pozitë të mirë të likuiditetit, me indikatorët kryesorë të likuiditetit që qëndrojnë mbi nivelet minimale të kërkesave rregullatore. Megjithatë, krahasuar me vitin paraprak, treguesit e likuiditetit kanë shënuar rënie. Deri në qershor 2016, depozitat shënuan rritje, mirëpo me normë më të ulët krahasuar me vitin paraprak. Rrjedhimisht, rritja më e përshpejtuar e kredive krahas rritjes më të ngadalshme të depozitave, bëri që raporti i kredive ndaj depozitave të arrijë në 80.7 përqind nga 77.9 përqind sa ishte në qershor 2015 (figura 77).

Pozita e mirë e likuiditeti të sektorit bankar shprehet edhe përmes nivelit të lartë të raportit të aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra. Megjithatë, ky raport në qershor 2016 u zvogëlu lehtësisht në 41.5 përqind nga 41.9 përqind sa ishte në qershor 2016. Rënia e raportit i atribuohet normës më të lartë të rritjes së detyrimeve afatshkurtra prej 3.8 përqind si rezultat i orientimit të depozitave me afat drejt atyre të transferueshme, në krahasim me rritjen prej 2.7 përqind të aseteve likuide (figura 78).


Niveli i aseteve likuide në bilancin e sektorit bankar mbetet i lartë, duke qenë se në qershor 2016 asetet likuide përbënin 32.0 përqind të gjithëj aseteve të sektorit. Sidoqoftë, ky raport është lehtësisht më i ulët se vitin e kaluar ku asetet likuide përbënin 33.0 përqind të gjithëj aseteve. Kjo për faktin se gjithëj asetet shënuan rritje më të lartë se asetet likuide. Në rritjen e aseteve likuide kontributin më të madh e kishin rritja e parasë së gatshme dhe e llogarive rrjedhëse të mbajtura nga bankat, si dhe rritja e letrave me vlerë të tregtueshme të emetuara nga qeveritë e

Figura 77. Kreditë dhe depozitat e sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Figura 78. Raporti asete likuide 'gjithëpërfshirëse'/ detyrime afatshkurtra



Burimi: BQK (2016)


huaja. Ndërsa përshpejtimi i rritjes së kreditimit ndikoi që norma e rritjes së asetve likuide të ishte më e ulët se norma e rritjes së gjithsej asetëve.

Rezervat e sektorit bankar shënuan rritje vjetore prej 1.2 përqind dhe qëndruan në nivel më të lartë se sa kërkesat rregullatore. Deri në qershor 2016, niveli i kërkuar i rezervës së detyrueshme ishte 239.0 milionë euro, ndërsa vlera e gjithsej rezervave të mbajtura nga bankat tejkaloi nivelin e kërkuar të rezervës së detyrueshme për 46.7 përqind (figura 79). Rritja e rezervave gjatë kësaj periudhe mund të reflektojë rënien e plasmaneve të bankave që operojnë në Kosovë në bankat jashtë vendit si rrjedhojë e ambientit me norma të ulëta të interesit sidomos në vendet e BE-së. Rritja e nivelit të rezervave mund të konsiderohet si zhvillim pozitiv për qëndrueshmërinë e sektorit bankar, mirëpo duhet pasur parasysh edhe koston oportune të mbajtjes së rezervave të tepërta për bankat.

Sektori bankar në qershor 2016 u karakterizua me rritje të ‘rrezikut strukturor të likuiditetit’, që pasqyrohet përmes rritjes së mospërputhjes së afatit të maturimit të asetëve dhe detyrimeve të intervalit të njëjtë të maturimit (figura 80). Hendeku i likuiditetit është zgjeruar për pothuajse të gjitha kategoritë, përveç kategorisë ‘3-6 muaj’ që u karakterizua me ngushtim. Hendeku negativ²¹ rezultoi vetëm në kategorinë e afatit të maturimit ‘1-7 ditë’, vlera e të cilit arriti në -1,405.1 milionë euro nga -1,069.4 milionë euro në qershor 2015. Thellimi i hendekut negativ për këtë kategori të maturimit krahasuar me vitin paraprak erdhi si rezultat i rënies së asetëve afatshkurtëra prej 14.1 përqind, përderisa detyrimet afatshkurtëra u rritën për 12.5 përqind. Ndërsa, për të gjitha kategoritë e tjera të afateve të maturimit hendeku ishte pozitiv si rezultat i rënies së detyrimeve për këto afate të maturimit. Për kategorinë ‘3-6 muaj’, hendeku pozitiv u ngushtua në 115.2 milionë euro në qershor 2016 krahasuar me 174.3 milionë euro në qershor 2015 si rezultat i rënies më të theksuar të asetëve se sa rënies së detyrimeve. Ndërsa, për kategorinë ‘mbi 5 vite’ hendeku ndërroi kahje duke kaluar në pozitiv në vlerën prej 175.2 milionë euro nga hendeku negativ prej -234.5 milionë euro që ishte në periudhën paraprake, si rezultat i rritjes së asetëve dhe rënies së theksuar të detyrimeve të këtij intervali të maturimit.


Rënia e asetëve për kategoritë me interval maturimi ‘1-7 ditë’ dhe ‘3-6 muaj’ rezultoi nga rënia e letrave me vlerë për këto kategori të maturimit si dhe rënia e llogarive rrjedhëse e plasmaneve jashtë vendit. Ndërsa, rritja e asetëve në kategoritë e tjera të afatit të maturimit reflekton rritjen e kreditimit afatgjatë dhe zhvendosjen e investimeve në letra me vlerë drejt afateve më të gjata të maturimit.

Figura 79. Rezervat e sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Figura 80. Hendeku i likuiditetit, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

²¹ Hendeku negativ nënkupton që detyrimet për intervalin e caktuar të maturimit tejkalojnë asetet dhe anasjelltas.

Në anën e detyrimeve, rritja e depozitave me maturim afatshkurtër ndikoi në rritjen e detyrimeve për kategorinë e maturimit ‘1-7 ditë’. Përjashtuar kategorinë ‘1-7 ditë’ dhe atë ‘mbi 5 vite’, depozitat për kategoritë tjera të maturimit shënuan rënie. Rrjedhimisht kjo zhvendosje e asetëve drejt afateve më të gjata të maturimit dhe e detyrimeve drejt afateve më të shkurtëra të maturimit, bëri që hendeku të jetë pozitiv në të gjitha kategoritë mbi 7 ditë maturim, dhe më i zgjeruari për kategorinë ‘1-5 vite’.


Zhvillimet në kuadër të depozitave të cilat kanë shfaqur tendencë të zhvendosjes drejt afateve më të shkurtëra të maturimit mund të paraqesin probleme në menaxhimin e likuiditetit në një afat më të gjatë.

6.4.2. Rreziku kreditor

Norma, edhe ashtu e ulët, e kredive joperformuese në sektorin bankar shënoi rënie të mëtutjeshme gjatë gjysmës së parë të vitit 2016. Raporti i kredive joperformuese (KJP) ndaj gjithsej kredive në qershor 2016 zbriti në 5.3 përqind krahasuar me 7.2 përqind një vit më parë (figura 81). Rënia e normës së KJP-ve reflekton si rritjen vjetore të kreditimit prej 8.8 përqind ashtu edhe përmirësimin e theksuar të cilësisë së portofolit kreditor ku vlera e kredive joperformuese shënoi rënie vjetore prej 21.0 përqind (figura 82). Në përmirësimin e cilësisë së portofolit kreditor ndikim të rëndësishëm kishte, ndër tjera, edhe funksionalizimi i përmbaruesve privat të cilët kanë lehtësuar procesin e zbatimit të kontratave kreditore.


Trendi i rënies së normës së KJP-ve filloi në muajin nëntor të vitit 2014 dhe rënia u theksua gjatë tremujorit të fundit të vitit 2015, duke vazhduar edhe përgjatë gjysmës së parë të vitit 2016. Vlen të theksohet që norma e kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në qershor 2016 ishte në nivelin më të ulët që nga fundi i vitit 2010. Gjithashtu, norma e KJP-ve të sektorit bankar në Kosovë mbetet në nivelin më të ulët krahasuar me vendet e rajonit, që mesatarisht kanë një normë prej 14.9 përqind të kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive (figura 83).

Figura 81. Raporti KJP/gjithsej kreditë, në përqindje




Burimi: BQK (2016)

Figura 82. Gjithsej kreditë dhe KJP-të, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2016)


Figura 83. Raporti KJP/gjithsej kreditë në Kosovë dhe në disa vende të Ballkanit Perëndimor, qershor 2016



Burimi: BQK (2016)

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut kreditor është më i theksuar tek kreditë ndaj ndërmarrjeve që mbajnë normë të KJP-ve prej 6.0 përqind krahasuar me normën e KJP-ve prej 2.5 përqind në kreditë ndaj ekonomive familjare. Mirëpo, të gjithë sektorët ekonomik në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve u karakterizuan me përmirësim të cilësisë së portfolit kreditor. Rënia më e theksuar e normës së kredive joperformuese u shënuar te kreditë ndaj sektorit të shërbimeve financiare, që në qershor 2016 mbanin normë të KJP-ve prej 1.0 përqind krahasuar me 7.9 përqind në qershor 2015. Sektori i tregtisë është i dyti për nga përmirësimi i cilësisë kreditore, duke arritur një normë të KJP-ve prej 5.7 përqind krahasuar me 10 përqind deri në qershor 2015. Normat më të larta të kredive joperformuese u shënuan në portfoliot kreditorë të sektorit të energjisë në nivelin prej 11.5 përqind dhe sektorit të prodhimit në nivelin prej 8.6 përqind (figura 84).


Figura 84. KJP-të sipas veprimtarive ekonomike



Burimi: BQK (2016)

Zvogëlimi i ekspozimit ndaj rrezikut kreditor krahasuar me periudhën paraprake paraqitet edhe përmes migrimit të kredive nga kategoritë me cilësi më të dobët drejt kategorisë së kredive pa vonesa (figura 85). Kreditë ‘standarde’ që klasifikohen si kategori e kredive pa vonesa rritën pjesëmarrjen në gjithsej kreditë për 3.7 pikë përqindje, përderisa kreditë ‘vrotuese’ dhe ‘nënstandarde’ që klasifikohen si kredi me vonesa zvogëluan pjesëmarrjen për 0.5 përqind përkatësisht 1.3 pikë përqindje. Kreditë “e humbura” zvogëluan pjesëmarrjen për 2.1 pikë përqindje, ndërsa kategoria “të dyshimta” rritën lehtësisht pjesëmarrjen për 0.1 pikë përqindje.


Figura 85. Struktura e kredive sipas klasifikimit



Burimi: BQK (2016)

Krahas përmirësimit të përgjithshëm të cilësisë së portfolit kreditor, përmirësim ka shënuar edhe niveli i mbulimit të kredive joperformuese me provizionet për humbjet e mundshme nga kreditë. Raporti i mbulimit të kredive joperformuese me provizione është rritur lehtësisht në 119.9 përqind në qershor 2016 (figura 86). Rritja e raportit ishte efekt i rënies më të theksuar të kredive joperformuese, duke pasur parasysh që vlera e stokut të provizioneve shënoi rënie si rrjedhojë e procesit të shlyerjes së kredive të humbura. Gjithashtu, sektori bankar forcoi kapacitetin për mbulimin me kapital të humbjeve

Figura 86. KJP-të dhe provizionet



Burimi: BQK (2016)

të mundshme nga kreditë. Kjo si rezultat i rënies së vlerës së kredive joperformuese neto nga provizionet si dhe rritjes së kapitalit të bankave, duke ndikuar që raporti ndërmjet tyre të zbres në 2.7 përqind nga 3.1 përqind sa ishte në qershor 2015.

Koncentrimi i rrezikut kreditor

Shkalla e koncentrimit kreditor në sektorin bankar të Kosovës, që matet si raport i vlerës së gjithsej ekspozimeve të mëdha ndaj kapitalit të klasit të parë, ka vazhduar rënien duke zbritur në 61.9 përqind në qershor 2016 (figura 87). Rënia e shkallës së koncentrimit i atribuohet rënies së vlerës së ekspozimeve të mëdha kreditore për 15.2 përqind (në 235.2 milionë euro) dhe, në anën tjetër, rritjes së kapitalit të klasit të parë për 11.2 përqind.

Përveç rënies së vlerës së përgjithshme të ekspozimeve të mëdha, rënie kishte edhe në numrin e ekspozimeve të mëdha kreditore (çdo ekspozim që tejkalon 10 përqind të kapitalit të klasit të parë), në 35 nga 51 sa ishin në qershor 2015. Mirëpo, si rezultat i rënies më të theksuar të numrit në krahasim me rënien e gjithsej vlerës së ekspozimeve të mëdha, vlera mesatare e ekspozimeve të mëdha në qershor 2016 u rrit në 6.7 milionë euro (5.4 milionë në qershor 2015), duke ndjekur kështu trend rritës për të katërtin vit me radhë.

6.4.3. Rreziku i solvencës

Sektori bankar i Kosovës vazhdon të ketë nivel të lartë të kapitalizimit. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (TMK), që paraqet raportin ndërmjet gjithsej kapitalit rregullator dhe aseteve të peshuara ndaj rrezikut, në qershor 2016 ishte 18.7 krahasuar me 19.0 përqind të shënuar një vit më parë, por që mbetet mjaft mbi nivelin rregullator prej 12 përqind (figura 88).²² Rënia e lehtë e raportit ishte rezultat i normës më të lartë të rritjes vjetore të aseteve të peshuara me rrezik (APR) prej 7.8 përqind, në krahasim me rritjen vjetore prej 6.2 përqind të kapitalit rregullator (figura 89).

Figura 87. Koncentrimi i rrezikut kreditor




Figura 88. Kapitalizimi i sektorit bankar





Figura 89. Kapitali rregullator dhe APR-të



²² Sipas rregullores së BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit, bankat janë të obliguara të kenë një normë prej së paku 12 përqind të gjithsej kapitalit rregullator në raport me APR dhe normë prej së paku 8 përqind të kapitalit të klasit të parë në raport me APR.

Kapitali rregullator këtë vit shënoi rritje më të ngadalësuar si pasojë e rënies së theksuar të kapitalit të klasit të dytë prej 19.3 përqind, përderisa kapitali i klasit të parë shënoi rritje vjetore prej 11.2 përqind. Rrjedhimisht, raporti i kapitalit të klasit të parë ndaj asetëve të peshuara me rrezik u rrit në 16.4 përqind nga 15.9 përqind sa ishte në qershor 2015. Niveli i kapitalizimit të sektorit bankar në Kosovë mbetet mbi nivelin mesatar prej 17.3 përqind të vendeve të rajonit (figura 90).


Indikator tjetër për vlerësimin e nivelit të kapitalizimit është raporti i levës, që vlerëson nivelin e mbulimit të aktivitetit të sektorit bankar me ekuitet. Ky raport në qershor 2016 arriti në 12.3 përqind nga 11.7 përqind, që tejkalon kërkesën rregullore për shkallë minimale të levës prej 7 përqind.²³ Raporti i levës shënoi rritje nga viti paraprak kryesisht si rezultat i normës më të lartë të rritjes së gjithsej ekuitetit prej 11.9 përqind, në krahasim me rritjen e gjithsej asetëve prej 6.0 përqind. Niveli aktual i levës është nën nivelin mesatar të vendeve të rajonit, që në qershor 2016 ishte 14.1 përqind (figura 90).

Kapitali rregullator

Vlera e kapitalit rregullator të sektorit bankar arriti në 434.1 milionë euro në qershor 2016, që tejkalon kërkesën minimale për kapital rregullator për 155.3 milionë euro. Cilësia e kapitalit, e shprehur nga pjesëmarrja e kapitalit të klasit të parë në gjithsej kapitalin rregullator, ka shënuar rritje për të dytin vit me radhë si rezultat i rritjes së profitit të mbajtur nga vitet paraprake. Kapitali i klasit të parë përfaqësoi 87.5 përqind të gjithsej kapitalit rregullator, krahasuar me 83.6 përqind një vit më parë (figura 91). Vlera e kapitalit të klasit të parë arriti në 379.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.2 përqind.


Struktura e kapitalit të klasit të parë mbetet e ngjashme me periudhat paraprake. Kapitali aksionar vazhdon të jetë kategoria dominuese e kapitalit të klasit të parë, me gjithë rënien e pjesëmarrjes që shënoi gjatë kësaj periudhe në 72.6 përqind krahasuar me 78.1 përqind sa ishte

Figura 90. TMK në sektorin bankar në Kosovë dhe në vende të rajonit, qershor 2016




Burimi: BQK (2016)

Figura 91. Struktura e kapitalit rregullator, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Figura 92. Struktura e kapitalit të klasit të parë, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

²³ Rregullorja BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit të bankave, Neni 9.

në qershor 2015. Rënia e pjesëmarrjes së kapitalit ishte rezultat i rritjes së pjesëmarrjes së profitit të pashpërndarë nga vitet paraprake (figura 92).


Vlera e kapitalit të klasit të dytë në qershor 2016 ishte 54.2 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 19.3 përqind. Kjo rënie ishte kryesisht si rezultat i rënies së borxhit të ndërvarur për 27.5 përqind, gjë që tregon tendencën e bankave që të shfrytëzojnë më pak instrumente që bartin kosto më të lartë për plotësimin e kërkesave rregullore për kapital. Kjo për faktin se performanca e mirë financiare në vitet e fundit iu ka mundësuar bankave rritjen e kapitalit përmes burimeve të brendshme, përkatësisht profitit të mbajtur. Borxhi i ndërvarur deri në qershor 2016 arriti në 33.0 milionë euro duke përbërë 60.9 përqind të kapitalit të klasit të dytë (figura 93). Pjesa e mbetur prej 39.1 përqind e kapitalit të klasit të dytë përbëhet nga provizionet e përgjithshme për kreditë.²⁴

Asetet e peshuara ndaj rrezikut

Vlera e gjithsej aseteve të peshuara ndaj rrezikut (APR) shënoi rritje prej 7.8 përqind në qershor 2016 (10.5 përqind në qershor 2015). Pjesëmarrja e aseteve me rrezik në gjithsej asetet e sektorit bankar²⁵ shënoi rritje në 63.2 përqind në qershor 2016 (figura 94). Nga gjithsej asetet me rrezik, 91.1 përqind janë asete me rrezik kreditor, ndërsa pjesa tjetër përfaqësohet nga asetet e ndara për menaxhim të rrezikut operacional.


Rritja e APR-ve ishte rezultat i rritjes së aseteve me peshë rreziku 100%, që paraqesin kategorinë dominuese të gjithsej APR-ve me pjesëmarrje 83.2 përqind në qershor 2016 (figura 95). Vlera e këtyre aseteve, të cilat përfshijnë kreditë hipotekare rezidenciale, pajisjet dhe mjetet tjera themelore si dhe pasuritë tjera të patundshme, arriti në 1.9 miliardë euro nga 1.7 miliardë euro në qershor 2015. Përderisa vetëm asetet me peshë rreziku 100% shënuan rritje, të gjitha kategoritë e tjera të aseteve me rrezik kanë shënuar rënie

Figura 93. Struktura e kapitalit të klasit të dytë, në milionë euro




Burimi: BQK (2016)

Figura 94. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej aseteve të sektorit



Burimi: BQK (2016)

Figura 95. Struktura e APR-ve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK (2016)

²⁴ Vlera e provizioneve të ndara nga bankat për kreditë me klasifikim standard dhe vrojtuese llogaritet si pjesë e kapitalit të klasit të dytë, limituar deri në 1.25 përqind të aseteve të peshuara ndaj rrezikut.

²⁵ Përfshirë këtu edhe mjetet jashtëbilanore meqenëse gjithsej vlera e APR-ve përfshinë mjetet jashtëbilanore.

gjatë periudhës në shqyrtim, gjë që u reflektua në ngadalësimin e normës vjetore të rritjes së gjithsej APR-ve.

Rënia e asetete me peshë rreziku 75% (kreditë e mbuluara me kolateral në formë të hipotekave të prioritetit të parë si dhe kreditë e destinuar për ndërtime të pasurive të patundshme), që paraqet kategorinë e dytë dominuese në strukturën e gjithsej APR-ve, ndikoi që pjesëmarrja e kësaj kategorie të bie në 6.0 përqind nga 9.7 përqind në vitin paraprak. Kategoritë tjera të rrezikut shënuan rënie por pa ndonjë ndryshim të theksuar në pjesëmarrje.

6.4.4 Rreziku i tregut

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tregut, që nënkupton ekspozimin ndaj rrezikut nga lëvizjet e kursit të këmbimit valutor si dhe nga lëvizjet në normat e interesit, vazhdon të mbetet në nivel të ulët. Raporti i pozicionit të agreguar neto të hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë ka shënuar rritje në 1.8 përqind nga 0.8 përqind në qershor 2015, por që mbetet në nivel të ulët. Kreditë në valutë të huaj kanë zvogëluar edhe më tej pjesëmarrjen mjaft të ulët (0.2 përqind në qershor 2016) në gjithsej portofolin kreditor, gjë që zvogëlon më tutje ekspozimin ndaj rrezikut valutor.

Kreditë dhe depozitat vazhdojnë të mbajnë pothuajse në tërësi normë fikse të interesit, duke u ndikuar nga lëvizjet e normave të interesit vetëm në maturim. Hendeku negativ ndërmjet asetëve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit për intervalin e shkurtër të maturimit 'deri në 30 ditë' është ngushtuar, duke zvogëluar ekspozimin ndaj rritjes së mundshme të normës së interesit që do të reflektohej më shumë në shpenzimet e refinancimit se në të hyrat nga riinvestimi. Në anën tjetër, hendeku kumulativ pozitiv për periudhën deri në 1 vit pothuajse është dyfishuar, gjë që paraqet ekspozim më lartë ndaj rrezikut të rënies së mundshme të normës së interesit.

Rreziku i këmbimit valutor

Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj është rritur gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo si rezultat i rritjes së asetëve në valutë të huaj në 148.4 nga 129.1 milionë euro vlerë ekuivalente. Po ashtu, detyrimet në valutë të huaj u rritën në 143.0 nga 130.0 milionë euro vlerë ekuivalente sa ishin në qershor 2015. Asetet në valutë të huaj në qershor 2016 ishin më të larta se detyrimet për të tri valutat kryesore për dallim nga periudha e kaluar kur detyrimet ishin më të larta se asetet. Rrjedhimisht, rritja më e theksuar e asetëve se sa rritja e detyrimeve në valutë të huaj ka bërë që pozicioni i hapur neto të arrijë vlerën pozitive prej 5.4 milionë euro vlerë ekuivalente nga -0.977 milionë euro vlerë ekuivalente në qershor 2015. Pozicioni i hapur neto pozitiv në valutë të huaj do të thotë që ndryshimet e mundshme në këmbimet valutore do të reflektohen më shumë në anën e asetëve, ku efekti i devalvimit të valutave në të cilat janë të denominuara asetet do të ishte negativ, pasi që vlera e këtyre asetëve ekuivalente në euro do të rezultonte më e ulët.

Në anën tjetër, pozicioni i agreguar neto i hapur për të gjitha valutat²⁶ shënoi rritje në 6.9 milionë euro vlerë ekuivalente në qershor 2016, nga 2.8 milionë euro vlerë në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rritja më e theksuar e pozicionit të agreguar në valutë të huaj se sa rritja e nivelit të kapitalit të klasit të parë të sektorit bankar gjatë kësaj periudhe bëri që raporti ndërmjet tyre të rritet në 1.8 përqind nga 0.8 përqind në periudhën paraprake, që megjithatë tregon nivel të ulët të ndjeshmërisë së sektorit ndaj ndryshimeve në kurset e këmbimit (figura 96).

²⁶ Pozicioni i agreguar neto i hapur nënkupton shumën e pozicioneve të gjata dhe të shkurta në të gjitha valutat. Për shembull, një pozicion neto i shkurtër (-) në dollar prej 1 milionë vlerë ekuivalente të euros dhe një pozicion neto i gjatë (+) në franga zvicerane prej një milionë vlerë ekuivalente të euros rezulton në neto pozicion të agreguar prej 2 milionë euro, përderisa pozicioni neto i hapur do të ishte 0.

Shikuar sipas valutave të veçanta, pozicionin më të lartë neto të disagreguar ndaj kapitalit të klasit të parë e arriti dollari amerikan në 1.3 përqind (nga 0.01 përqind në qershor 2015). Për funtën britanike, raporti u rrit në 0.1 përqind (nga 0.01 përqind deri në qershor 2015), ndërsa për frangun zviceran ky raport ndërroi kahje nga -0.2 përqind në 0.1 përqind në qershor 2016. Raporti i pozicioneve neto të hapura për çdo valutë individuale ndaj kapitalit të klasit të parë vazhdon të mbetet mjaft nën nivelin maksimal prej 15 përqind të lejuar sipas rregullores përkatëse.

Kreditimi në valutë të huaj vazhdon të jetë në nivel mjaft të ulët dhe madje ka shënuar rënie të mëtejme që nga viti paraprak. Në qershor 2016, vlera e gjithsej kredive në valutë jo-euro ishte 4.4 milionë euro vlerë ekuivalente, në krahasim me 6.3 milionë euro vlerë ekuivalente një vit më parë. Rritja e kreditimit në valutë euro si dhe rënia e kreditimit në valutë jo-euro bëri që raporti i kredive në valutë jo-euro ndaj gjithsej portofolit kreditor të zvogëlohet lehtësisht në 0.2 përqind nga 0.3 përqind sa ishte deri në qershor të vitit 2015.


Në anën tjetër, vlera e depozitave në valutë të huaj arriti në 133.6 nga 117.7 milionë euro vlerë ekuivalente në qershor të vitit 2015. Kjo ndikoi në rritjen e pjesëmarrjes së depozitave jo-euro ndaj gjithsej depozitave në 5.0 përqind nga 4.6 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rënia e kredive në valutë jo-euro kundrejt rritjes së depozitave në valutë jo-euro ndikoi që raporti i kredive në valutë të huaj ndaj depozitave në valutë të huaj të zvogëlohet në 3.3 përqind në qershor 2016 nga 5.3 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 97).

Rreziku i normave të interesit

Sektori bankar i Kosovës vazhdon të jetë i ekspozuar ndaj rrezikut të normave të interesit vetëm në kuptimin e rrezikut të rifinancimit dhe riinvestimit të aseteve, duke konsideruar që kreditë dhe depozitat sipas trendit historik kanë kryesisht normë fikse të interesit dhe nuk ndikohen nga lëvizjet në norma të interesit deri në maturim. Megjithatë, lëvizjet në normat e interesit mund të kenë ndikim në qëndrueshmërinë e sektorit bankar kur merret parasysh rreziku i rifinancimit dhe i riinvestimit të aseteve, varësisht nga kompozicioni i afatit të maturimit të aseteve dhe detyrimeve që bartin interes (figura 98), si dhe kahut të lëvizjes së normës së interesit.


Hendeku në mes të aseteve dhe detyrimeve që bartin interes është negativ vetëm për kategorinë e maturimit 'deri në 30 ditë', gjë që ekspozon sektorin ndaj rritjes së mundshme të normës së interesit në afat të shkurtër pasi që kostoja e rifinancimit nga depozitat do të rritej më shumë se që mund të rriten të hyrat nga interesi i riinvestimit të aseteve. Në qershor 2016, hendeku negativ për këtë interval të maturimit është ngushtuar në 277.7 nga 393.1 milionë euro në vitin

Figura 96. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë



Burimi: BQK (2016)

Figura 97. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj




Burimi: BQK (2016)

paraprak, duke zbritur ekspozimin e sektorit ndaj këtij rreziku. Ndërsa, hendeku kumulativ për periudhën e maturimit ‘deri në 1 vit’ është pozitiv dhe është zgjeruar në 525.8 milionë euro nga 250.1 milionë euro. Kjo rritë ekspozimin e sektorit ndaj rënies së mundshme të normës së interesit ngase të hyrat nga interesi të sektorit ndikohen më shumë se shpenzimet e interesit.

Për të gjitha afatet e tjera të maturimit, hendeku i aseteve dhe detyrimeve që bartin interes është pozitiv dhe më i zgjeruar krahasuar me vitin paraprak. Hendeku për intervalin e maturimit '1 deri në 5 vite' mbetet më i zgjeruari, vlera e të cilit arriti deri në 754.5 milionë euro. Ndërsa hendeku kumulativ ndërmjet aseteve dhe detyrimeve për të gjitha afatet e maturimit arriti në 1.4 miliardë euro nga 1.1 miliardë euro sa ishte në qershor 2015. Zhvendosja e depozitave nga të afatizuara drejt atyre të transferueshme në njërën anë si dhe përshpejtimi i rritjes së kreditimit në anën tjetër, ndikuan në zgjerimin e hendekut kumulativ pozitiv ndërmjet aseteve dhe detyrimeve.

Figura 98. Hendeku i aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Rezultatet e stres-testit sugjerojnë që efekti i zvogëlimit të mundshëm të normës së interesit në asete dhe i rritjes së normës së interesit për detyrimet, do të ishte negativ, çka do t'i shkaktonte humbje sektorit. Mirëpo, si rezultat i nivelit të lartë të kapitalit dhe profitit të sektorit, nuk do të paraqitej nevoja për rikapitalizim.

Kutia 2. Identifikimi i bankave me rëndësi sistemike në Kosovë

Modeli për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike paraqet një vegël të rëndësishme për vlerësimin e vazhdueshëm të shkallës së rëndësisë sistemike të bankave komerciale në vend. Në përgjithësi, një bankë konsiderohet të ketë rëndësi sistemike nëse dështimi i mundshëm i saj pritet të manifestohet me pasoja të rëndësishme negative në funksionimin dhe stabilitetin e tërë sektorit dhe në ekonomi në tërësi. Andaj, monitorimi i vazhdueshëm i shkallës së rëndësisë sistemike konsiderohet të jetë i rëndësishëm së veçantë për stabilitetin financiar për shkak se mundëson identifikimin e bankave dështimi i mundshëm i të cilave do të kishte ndikim më të madh për sektorin financiar dhe ekonominë në përgjithësi. Gjithashtu, ky model mundëson hartimin e rekomandimeve për politikën dhe masat e nevojshme për sigurimin adekuat të kapaciteteve absorbuese të humbjeve të mundshme të bankave konform shkallës së rëndësisë së tyre sistemike.

Tabela 7. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë

| Kriteri | Indikatorët |
|--|--|
| Madhësia (pesha 40%) | Asetet (pa provizione) |
| Zëvendësueshmëria (pesha 40%) | Numri i transaksioneve në raport me gjithsej transaksionet përmes sistemit të pagesave Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj ekonomive familjare Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj korporatave jo-financiare Pjesëmarrja në gjithsej depozitat e ekonomive familjare |
| Ndërlidhshmëria (pesha 10%) | Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj korporatave tjera financiare dhe plasmaneve në bankat tjera (duke mos përfshirë bankat amë) Pjesëmarrja në gjithsej depozitat e korporatave tjera financiare dhe huazimeve tjera (duke përfshirë edhe depozitat e bankave tjera) Pjesëmarrja në letrat me vlerë |
| Aktiviteti ndërshtetëror (pesha 5%) | Kërkesat ndaj sektorit të jashtëm Detyrimet ndaj sektorit të jashtëm |
| Kompleksiteti (pesha 5%) | Pjesëmarrja e zërave jashtë-bilancor |

Burimi: BQK (2016)

Kjo kuti paraqet vlerësimin e shkallës së rëndësisë sistemike për të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja që operojnë në Kosovë duke u bazuar në të dhënat e muajit qershor 2016 të bilanceve të gjendjes së bankave përkatëse. Për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave, modeli mbështetet në pesë kriterë bazë: kriterin e madhësisë, zëvendësueshmërisë, ndërlidhjes, aktivitetit ndërshtetëror dhe kompleksitetit. Kriteri i madhësisë dhe kriteri i zëvendësueshmërisë janë konsideruar kriterë të rëndësishme pasi që përfaqësojnë pjesën më të madhe të aktivitetit bankar, andaj u është dhënë më shumë peshë në përcaktimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë (tabela 7).

Kriteri i ndërlidhjes në këtë model ka peshë 10 përqind për faktin që sektori bankar i Kosovës ka shkallë të ulët të ndërlidhshmërisë së institucioneve në kuptimin e kreditimit dhe huazimeve të ndërsjella. Ndërsa, kriterit të aktivitetit ndërshtetëror i është dhënë pesha 5 përqind, bazuar në faktin që sektori bankar në Kosovë ka ndërveprim të ulët me sektorin financiar të vendeve tjera. Po ashtu edhe kriteri i kompleksitetit është peshuar me 5 përqind, pasi që aktiviteti i sektori bankar nuk është kompleks, ku produkti kryesor i ofruar janë kreditë dhe burimi i financimit janë kryesisht depozitat.

Për secilin nga kriteret janë përcaktuar indikatorët përmes të cilëve matet shkalla e rëndësisë sistemike të bankave individuale. Indikatorët e përdorur janë paraqitur në tabelën 8, dhe secilit prej indikatorëve brenda kriterit të caktuar i është dhënë peshë e barabartë. Përzgjedhja e indikatorëve është bërë konform teorive përkatëse dhe sugjerimeve të kornizës mbi të cilin është zhvilluar ky model.

Një bankë konsiderohet me rëndësi të përgjithshme sistemike nëse mesatarja e peshuar e të gjitha kriterëve për bankën përkatëse tejkalon mesataren e peshuar të sektorit. Po ashtu edhe në kriterë të caktuara, një bankë identifikohet me rëndësi sistemike nëse mesatarja e peshuar e një kriteri për bankën përkatëse tejkalon mesataren e peshuar të sektorit në këtë kriter.

Në vijim janë përshkrimi i kriterëve dhe mënyra e matjes së tyre:

Kriteri i madhësisë, konsiderohet kriter shumë i rëndësishëm në matjen e rëndësisë sistemike të një institucioni, pasi që sa më e madhe të jetë pjesëmarrja e një banke në gjithsej sektorin, aq më e madhe do të jetë rëndësia e saj sistemike, me që palët e ndikuara në rast të tronditjeve në këtë bankë janë më të shumta dhe kostot për tërë sektorin dhe ekonominë janë më të mëdha. Madhësia e institucioneve matet si raport i aseteve të secilit institucion ndaj gjithsej aseteve të sektorit.

Kriteri i zëvendësueshmërisë matë shkallën e zëvendësueshmërisë së ofrimit të produkteve dhe shërbimeve të bankës përkatëse nga bankat tjera në treg, në rast të dështimit të saj. Kriteri i zëvendësueshmërisë përfaqëson kriterin tjetër të rëndësishëm në matjen e rëndësisë sistemike të bankave. Sa më e madhe pjesëmarrja e një banke në një segment të caktuar të tregut apo në ofrimin e një lloji të caktuar të shërbimit, aq më të larta janë kapacitetet teknike dhe njohuritë për funksionim në sektorin përkatës (p.sh. të sistemit të pagesave), gjë që e bëjnë më të vështirë zëvendësimin e rolit të saj në ofrimin e këtyre shërbimeve bankare. Andaj, edhe rëndësia sistemike e një institucioni rritet kur vështirësitë për zëvendësimin e ofrimit të shërbimeve dhe produkteve të saj janë më të mëdha.

Kriteri i ndërlidhshmërisë ka për qëllim që të masë shkallën e ndërlidhshmërisë së institucioneve bankare ndërmjet vete si dhe ndërlidhshmërisë me institucionet tjera financiare në vend në mënyrë që të identifikojë rrezikun e efektit shpërndarës së krizës së një institucioni tek institucionet tjera financiare dhe sektori real. Ky kriter është i një rëndësie të veçantë për matjen e rrezikut sistematik në vendet me sektorë të zhvilluar financiar ku ndërlidhjet mes institucioneve janë të shumta dhe komplekse. Në Kosovë, tregu ndërbankar është pothuajse joekzistent dhe ndërlidhjet mes institucioneve financiare kryesisht kufizohen në depozitat dhe kreditë që institucionet tjera financiare si kompanitë e sigurimeve, institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit tjerë financiar mbajnë në bankat komerciale në vend. Rrjedhimisht, ndërlidhja mes institucioneve financiare matet përmes pjesëmarrjes së plasmanëve në bankat tjera dhe ekspozimit kreditor ndaj korporatave tjera financiare, si dhe pjesëmarrjes së depozitave dhe huamarrjeve nga korporatat tjera financiare. Në këtë kriter janë përfshirë edhe investimet në letra me vlerë të bankave, të cilat kryesisht përbëhen nga investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe të qeverive tjera jashtë vendit.

Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror matë shkallën e ndërveprimit të një banke me sektorin e jashtëm si në kuadër të aseteve ashtu dhe në kuadër të detyrimeve. Ky kriter ka për qëllim të paraqesë nivelin e rrezikut të një banke ndaj ekspozimeve të saj në sektorin e jashtëm. Sa më i lartë të jetë niveli i ekspozimit

të një banke në sektorin e jashtëm aq më shumë do të kishte rrezik që të ketë ndikim negativ në sektorin e brendshëm bankar. Kosova vazhdon të ketë nivel mjaft të ulët të ndërveprimit bankar me vendet tjera, andaj është më rezistente ndaj rreziqeve të mundshme të cilat vijnë nga sektori i jashtëm.

Kriteri i kompleksitetit matë shkallën e kompleksitetit të modelit të biznesit dhe operacioneve të një banke nën supozimin se sa më kompleks aktiviteti i një banke, aq më të shumta janë ndërlidhjet dhe marrëveshjet me palë të treta, të cilat i rrisin kostot dhe kohën e adresimit të problemeve në rast të falimentimit. Në rastin e Kosovës, si indikator i përafërt për matjen e kompleksitetit të një banke është marrë pjesëmarrja e zërave jashtëbilancorë në gjithsej portfolion e asetëve të asaj banke.

Rezultatet

Rezultatet e përgjithshme të modelit, me të dhëna të muajit qershor 2016, sugjerojnë që katër banka janë me rëndësi të përgjithshme sistemike. Tri nga këto banka kanë rezultuar me rëndësi sistemike në të gjitha kriteret, përderisa banka tjetër nuk rezultoi me rëndësi sistemike në kriterin e aktivitetit ndërshtetëror. Rezultatet po ashtu tregojnë që një bankë e cila nuk është me rëndësi të përgjithshme sistemike ka rezultuar me rëndësi sistemike në dy kriteret, atë të ndërlidhshmërisë dhe të zëvendësueshmërisë.

Megjithatë, në gjysmën e parë të vitit 2016, është shënuar një rënie e lehtë e peshës së bankave me rëndësi të përgjithshme sistemike, çka do të thotë se bankat që nuk janë me rëndësi sistemike janë duke e rritur pjesëmarrjen e tyre në aktivitetin e përgjithshëm bankar. Rezultatet e modelit në përgjithësi sugjerojnë se rënia e shkallës së rëndësisë sistemike rezultoi nga rënia e kërkesave të bankave me rëndësi të përgjithshme sistemike ndaj bankave jashtë vendit, rënia e kreditimit ndaj institucioneve tjera financiare dhe plasmaneve në bankat tjera, ngadalësimi i rritjes së kreditimit ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare si dhe ngadalësimi i rritjes së depozitave të këtyre bankave me rëndësi të përgjithshme sistemike.

Tabela 8. Rezultatet e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë, sipas kriterëve

| Bankat*/Kriteri | Madhësia | Zëvendësueshmëria | Ndërlidhshmëria | Aktiviteti ndërshtetëror | Kompleksiteti | TOTAL |
|-----------------|----------|-------------------|-----------------|--------------------------|---------------|-------|
| Banka 1 | | | | | | |
| Banka 2 | √ | √ | √ | √ | √ | √ |
| Banka 3 | | √ | √ | | | |
| Banka 4 | √ | √ | √ | √ | √ | √ |
| Banka 5 | | | | | | |
| Banka 6 | √ | √ | √ | | √ | √ |
| Banka 7 | | | | | | |
| Banka 8 | √ | √ | √ | √ | √ | √ |
| Banka 9 | | | | | | |

* Radhitja e bankave është bërë sipas rastësisë
Burimi: BQK (2016)

Kriteri i madhësisë – Në kriterin e madhësisë me rëndësi sistemike rezultuan katër bankat, të cilat kanë rëndësi të përgjithshme sistemike. Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 13.2 përqind në 25.7 përqind, megjithëse u zvogëlua krahasuar me vitin paraprak, për shkak të rritjes së lehtë të pjesëmarrjes në aktivitetin bankar të bankave që nuk kanë rëndësi të përgjithshme sistemike. Në dy vitet e fundit bankat që nuk kanë rëndësi sistemike kanë përsheptuar rritjen e aktivitetit të tyre kredihënës, për dallim nga bankat e rëndësisë sistemike të cilat shënuan ngadalësim të rritjes për të dytin vit me radhë..

Kriteri i zëvendësueshmërisë – Në kriterin e zëvendësueshmërisë me rëndësi sistemike rezultuan katër bankat që kanë rëndësi të përgjithshme sistemike dhe një bankë që nuk ka rëndësi të përgjithshme sistemike. Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter në qershor 2016 shtrihet nga 11.7 përqind në 21.0 përqind. Krahasuar me vitin paraprak, kjo shkallë u zvogëlua si rezultat i rritjes më të ngadalësuar të kreditimit (të bizneseve dhe ekonomive familjare) nga bankat me rëndësi të përgjithshme sistemike, krahasuar me rritjen më të përsheptuar të kreditimit në këto dy kategori nga bankat që nuk janë me

rëndësi të përgjithshme sistemike. Ngjashëm, edhe në depozita, bankat që nuk janë me rëndësi të përgjithshme sistemike u karakterizuan me rritje më të lartë të depozitave të ekonomive familjare krahasuar me rritjen e ngadalësuar të bankat me rëndësi të përgjithshme sistemike. Vlenë të ceket që banka e cila nuk është me rëndësi të përgjithshme sistemike por që rezultoi e rëndësishme sistemikisht në kriterin e zëvendësueshmërisë, paraqet bankën e dytë me numrin më të lartë të transaksioneve të procesuara përmes sistemit elektronik të pagesave.

Kriteri i ndërlidhjes – Me rëndësi sistemike në kriterin e ndërlidhjes rezultuan katër bankat me rëndësi të përgjithshme sistemike si dhe një bankë e cila nuk është e rëndësishme së përgjithshme sistemike. Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 12.5 përqind në 26.2 përqind. Krahasuar me vitin paraprak shkalla e rëndësisë sistemike u zvogëluar si rezultat i rënies së aktivitetit kreditues nga bankat me rëndësi të përgjithshme sistemike ndaj institucioneve tjera financiare si dhe rënies së plasmaneve të këtyre bankave sistemike në bankat e tjera.

Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror – Tri nga katër bankat e rëndësishme së përgjithshme sistemike kanë rezultuar të jenë me rëndësi sistemike në kriterin e aktivitetit ndërshtetëror. Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 15.3 përqind në 34.3 përqind. Krahasuar me vitin paraprak shkalla e rëndësisë sistemike është zvogëluar si rezultat i zvogëlimit të investimeve të bankave me rëndësi sistemike në sektorin e jashtëm, përderisa, bankat që nuk janë të rëndësishme sistemikisht shënuan rritje të aktiviteteve me sektorin e jashtëm si në kuadër të aseteve ashtu edhe të detyrimeve.

Kriteri i kompleksitetit - Katër bankat e rëndësishme së përgjithshme sistemike kanë rezultuar të jenë sistemike në kriterin e kompleksitetit. Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 15.8 përqind në 30.1 përqind dhe krahasuar me vitin e kaluar është rritur. Rritja erdhi si rezultat i rritjes së lehtë të aseteve jashtëbilancore të këto banka, krahasuar me rënien e theksuar të aseteve jashtëbilancore të bankave që nuk janë me rëndësi të përgjithshme sistemike.

6.5. Analiza Stres-Test

Analiza stres-test paraqet një vegël të rëndësishme të vlerësimit të qëndrueshmërisë së sektorit bankar ndaj tronditjeve të mundshme në portofolin kreditor si dhe në pozitën e likuiditetit, të cilat mund të pasojnë nga zhvillimet e pafavorshme makroekonomike dhe ndryshimet në kushtet e tregut. Përmes kësaj analize vlerësohet ndikimi i këtyre tronditjeve në kualitetin e portofolit kreditor, në nivelin e kapitalizimit si dhe në pozitën e likuiditetit.

Analiza e prezantuar më poshtë ka për bazë të dhënat e sektorit bankar të Kosovës për muajin qershor 2016, të cilat janë shfrytëzuar për vlerësimin e qëndrueshmërisë së sektorit ndaj rrezikut kreditor, të kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe nga norma e këmbimit valutor (rreziku i tregut). Në analizë është testuar gjithashtu aftësia e sektorit që të ruaj gjendjen e likuiditetit nën supozime hipotetike për tërheqje të konsiderueshme të depozitave (rreziku i likuiditetit).

Rezultatet e analizës stres-test në vazhdimësi sugjerojnë aftësi të kënaqshme të sektorit për të përballuar 'situatat ekstreme' të ekspozimit ndaj këtyre rreziqeve.

6.5.1 Vlerësimi i qëndrueshmërisë së sektorit bankar ndaj goditjeve në portofolin kreditor

Metodologjia

Skenari bazë: Analiza mbështetet në skenarin hipotetik se gjendja ekonomike në eurozonë dhe në rajon do të përkeqësohet, dhe kjo do të reflektohet në ekonominë e Kosovës kryesisht përmes zvogëlimit të dërgesave të emigrantëve dhe eksporteve, duke dekurajuar kështu kërkesën e përgjithshme në vend. Si rezultat, supozohet të ketë rënie ekonomike, gjë e cila e zgjeron hendekun negativ të prodhimit dhe ndikon në rritjen e kredive joperformuese. Në këtë skenar

është marrë parasysh norma mesatare e rritjes ekonomike në Kosovë prej rreth 3.1 përqind në gjashtë vitet e fundit si dhe është supozuar rënie ekonomike prej 2.6 përqind për vitin 2016. Në këtë situatë, hendeku negativ i prodhimit do të ishte 5.7 përqind, ndërsa ndikimi në cilësinë e portofolit kreditor, gjegjësisht në kreditë joperformuese (KJP), është vlerësuar duke konsideruar një koeficient të elasticitetit të KJP-ve ndaj hendekut të prodhimit prej 0.8,²⁷ që nënkupton rritje prej 4.6pp të pjesëmarrjes së KJP-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar. Si pasojë e tronditjeve në sektorin real, është supozuar që kreditimi nuk do të shënojë rritje në vitin vijues.

Në një skenar shtesë ndaj skenarit bazë, krahas rrezikut kreditor, janë konsideruar edhe efektet e rrezikut të tregut në të hyrat e sektorit. Pra, rreziku kreditor është kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe nga norma e këmbimit. Normat e interesit për pjesën e aseteve janë supozuar të bien për 2.0pp, ndërsa për pjesën e detyrimeve të ngritën për 1.5pp kryesisht si rezultat i konkurrencës ndërbankare. Zhvlerësimi i valutës euro ndaj valutave të tjera është supozuar të jetë 20 përqind.

Efektet e supozimeve të mësipërme në sektorin bankar reflektohen si në vijim: rritja e pjesëmarrjes së KJP-ve në gjithsej kreditë ndikon në rritjen e provizioneve; zhvlerësimi i euros ndikon në rivlerësimin e humbjes/fitimit nga pozicionet e hapura neto, si dhe ndryshimi i normave të interesit ndikon në humbjet/fitimet e të hyrave neto nga interesi duke marrë parasysh afatin e maturimit të aseteve dhe detyrimeve dhe riinvestimin/rifinancimin e tyre.

Krahas këtyre supozimeve, është marrë parasysh profiti i pritur si një absorbues i humbjeve nga këto tronditje. Në këtë kontekst, është supozuar se profiti gjithashtu do të ndikohet nga tronditjet e lartpërmendura, kryesisht përmes rënies së aftësisë së gjenerimit të të hyrave nga interesi si rezultat i mos rritjes së kreditimit si dhe dështimit të kredive (rritjes së KJP-ve). Andaj, profiti i pritshëm i bankave për periudhën e mbetur të vitit është llogaritur duke marrë për bazë profitin neto pas tatimit të realizuar deri në fund të qershor 2016, ndaj të cilit fillimisht është aplikuar tronditje prej 40 përqind për të reflektuar efektin e mos rritjes së kreditimit, dhe pastaj janë zbritur edhe të hyrat që do të realizoheshin po qe se KJP nuk do të rritej.²⁸

Rritja e supozuar e KJP-ve është shprehur përmes migrimit të kredive nga kategoritë performuese (standarde, në vëzhgim, nënstandarde) drejtë kategorive jo-performuese (të dyshimta dhe të humbura). Kjo rritje është shpërndarë proporcionalisht në kuadër të kategorisë së kredive të dyshimta dhe të kredive të humbura, duke marrë për bazë pjesëmarrjen fillestare të këtyre kategorive në gjithsej KJP-të. Rritja e KJP-ve reflektohet në nivelin e provizioneve bazuar në rregulloren e BQK-së për provizionimin e kredive sipas klasifikimit. Supozimi për rritjen e KJP-ve aplikohet edhe te zërat jashtë-bilancor që përfshijnë zotimet e pashfrytëzuara, garancionet, letër kreditë në dispozicion, dhe letër kreditë komerciale.

Me gjithë faktin se në skenarin shtesë është konsideruar zhvlerësimi i euros ndaj valutave të huaja për të vlerësuar rrezikun e normës së këmbimit valutator, është me rëndësi të potencohet se ndikimi i këtij rreziku në bilancin e gjendjes së sektorit bankar vazhdon të jetë minor për shkak të vlerës së ulët të pozicioneve të hapura neto në valutë të huaj.

Skenari mbi rrezikun nga norma e interesit nënkupton zvogëlimin e normave të interesit për 2pp për asetet dhe rritjen për 1.5pp për detyrimet në bilancin e gjendjes. Zvogëlimi i normave të interesit mund të ndikojë në margjinën neto të interesit (angl. Net Interest Margin: NIM), kryesisht duke marrë parasysh afatin e maturimit të kredive dhe depozitave ngase pjesa dërmuese e kredive dhe depozitave në sektorin bankar të Kosovës kanë normë fikse të interesit dhe ndryshimet në norma të interesit nuk reflektohen deri në maturim. Efekti negativ në të hyra

²⁷ Material kërkimor i FMN-së, i papublikuar, 'CESE Bank Loss Projection and Stress Testing Exercise', Korrik 2009.

²⁸ Vlerësimi i të hyrave të 'humbura' si pasojë e rritjes së KJP-ve është bërë fillimisht duke llogaritur ex-post normën e përgjithshme të interesit në kredi për secilën bankë, e cila më pastaj është shumëzuar me vlerën e shtuar të KJP-ve.

nga rënia e normës së interesit në anën e aseteve theksohet edhe më tutje nga efekti negativ që ka rritja e normës së interesit për detyrimet.

Skenarë tjerë shtesë: Krahas skenarëve bazë të lartpërmendur, skenarë shtesë në analizën mbi rrezikun kreditor janë konsideruar edhe dështimi i kredimarrësve më të mëdhenj në secilën prej bankave, si dhe niveli përballues i KJP-ve për secilën bankë para se të shfaqen problemet me kapitalizim.

Përfundimisht, qëndrueshmëria e sektorit bankar në këtë analizë është vlerësuar në kuptim të ndikimit të skenarëve hipotetik në nivelin e kapitalit rregullator të sektorit bankar, mjeteve të peshuara me rrezik dhe rrjedhimisht, treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (TMK).

Rezultatet

Gjendja e sektorit bankar të Kosovës për sa i përket kapitalizimit në qershor 2016 ishte mjaft e favorshme, me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit prej 18.4 përqind²⁹ (tabela 9). Sektori bankar vazhdoi të qëndrojë mirë edhe për sa i përket nivelit të kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive, të cilat qëndruan në 5.3 përqind, si dhe mbulimit të kredive joperformuese me provizionet e ndara për humbjet e mundshme nga kreditë të cila arritën në 119.9 përqind.

Nën supozimet e skenarit bazë për vlerësimin e rrezikut kreditor (përfshirë edhe zërat jashtë bilancor), në të cilin pjesëmarrja e KJP-ve në portfolion kreditor do të rritej për 4.6pp, ndërsa profiti i mbetur pas shokut do të shfrytëzohej për absorbimin e humbjeve, TMK i sektorit bankar do të zbriste në 18.1 përqind (krahasuar me minimumin prej 12 përqind të kërkuar me rregullore të BQK-së). Gjithsej humbja e sektorit bankar do të arrinte vlerën prej 58.4 milionë euro (1.0 përqind të vlerës reale të BPV-së të parashikuar për vitin 2016). Megjithatë, kjo vlerë nuk mund të konsiderohet në tërësi si humbje eventuale e sektorit duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e kësaj humbje do të absorbohej nga profiti i realizuar gjatë këtij viti. Gjithashtu, një pjesë e humbjeve supozohet se mund të kompensohet nga realizimi i kolateralit apo nga riprogramimi i kredive, por që ky aspekt nuk është konsideruar për qëllim të kësaj analize.

Në nivel të bankave individuale, vetëm një bankë do të përballlej me probleme kapitalizimi, me ç'rast TMK do të zbriste nën minimumin rregullator prej 12.0 përqind dhe mjetet shtesë të nevojshme për ngritjen e kapitalit në nivelin minimal të kërkuar do të ishin 237.5 mijë euro. TMK për bankën me nivelin më të ulët të kapitalizimit do të ishte 11.9 përqind, kurse për bankën me nivelin më të lartë të kapitalizimit do të ishte 22.6 përqind. Pra, nën supozimin e skenarit bazë për vlerësimin e rrezikut kreditor, sektori bankar do të mund të përballonte ngritjen e nivelit të KJP-ve prej 4.6pp pa rrezikuar aftësinë e përmbushjes së kërkesave të mjaftueshmërisë së kapitalit të përcaktuara nga BQK. Në këto rrethana, pjesëmarrja e KJP-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar do të arrinte në 9.8 përqind, ndërsa në nivel të bankave individuale, niveli më i lartë i normës së KJP-ve do të ishte 12.2 përqind.

Rezultatet e skenarit shtesë, në të cilin rreziku kreditor kombinohet me rrezikun e tregut, ku krahas rritjes së normës së KJP-ve për 4.6pp, përfshihet edhe zhvlerësimi i euros dhe lëvizja e normave të interesit në nivelet e supozuara më lartë, TMK e sektorit bankar do të zbriste në 17.4 përqind. Në këtë rast, një bankë do të zbriste nën minimumin rregullator të TMK-së prej 12 përqind, dhe nevojat për rikapitalizim do ishin 1.60 milionë euro (0.03 përqind të vlerës reale të BPV-së për vitin 2016). Në këtë skenar, efekti i zhvlerësimit të euros në të hyrat e sektorit paraqitet në nivel të ulët por pozitiv si rezultat i pozicionit të hapur neto pozitiv. Ndërsa efekti nga rënia e normës së interesit në të hyrat e sektorit dhe i rritjes së normës së interesit në shpenzime do të jetë negativ dhe më i theksuar. Mirëpo, përkundër humbjeve shtesë nga

²⁹ Në analizë janë përfshirë nëntë banka për të evituar indikatorët me vlera të larta ose të ulëta që karakterizojnë bankën në fillim të veprimtarisë.

ndryshimet në kushte të tregut – ndryshimi i normave të interesit, sektori bankar rezulton stabil me nivel të kapitalizimit mbi 12 përqind.

Një skenar tjetër shtesë supozon dështimin e ekspozimeve të mëdha kreditore. Rezultatet e skenarit në të cilin supozohet dështimi i tre kredimarrësve më të mëdhenj në secilën nga bankat, sugjeron që TMK i sektorit do të zbriste në 17.2 përqind. Në këto rrethana, në dy banka TMK do të zbriste nën nivelin minimal të kërkuar prej 12 përqind dhe mjetet shtesë të nevojshme për ngritjen e kapitalit në nivelin minimal të kërkuar do të arrinin në 12.36 milionë euro (vlerë ekuivalente me 0.21 përqind të vlerës reale të BPV-së). Në supozimin e dështimit të pesë kredimarrësve më të mëdhenj në secilën bankë, TMK i sektorit do të zbriste në 16.2 përqind, dhe dy banka do të paraqiteshin të nënkapitalizuara. Vlera e nevojshme për rikapitalizim do të arrinte në 18.67 milionë euro (vlerë ekuivalente me 0.31 përqind të vlerës reale të BPV-së për vitin 2016).

Sektori bankar është në gjendje të përballojë një raport të KJP-ve ndaj gjithsej kredive deri në 22.7 përqind pa u paraqitur nevoja për injektim të kapitalit shtesë për mbajtjen e TMK-së aë sektorit në nivelin e kërkuar rregullator prej 12 përqind. Po ashtu, nivelet përballuese të KJP-ve të secilës bankë para se të shfaqen probleme me kapitalizim (para se TMK të zbres nën nivelin 12 përqind) paraqiten të larta për shumicën e bankave. Në një prej bankave, KJP do të mund të rritej deri në 34.2 përqind të gjithsej portofolit të kredive të asaj banke para se të paraqitet nevoja për kapital shtesë. Në disa banka, nivelet përballuese të normës së KJP-ve janë më të ulëta, ku niveli më i ulët në njërin nga bankat është 12.1 përqind.

Tabela 9. Përmbledhje e rezultateve të stres-testit: rreziku kreditor

| Përshkrimi | Numri i bankave 1/ | | | TMK | | | KJP | | | Rikapitalizimi 2/ | | |
|----------------------------------|--------------------|----------|-----------|------------------|-------------------|-------------------|------------------|-------------------|-------------------|-------------------|---------------|-------|
| | TMK <0 | TMK 0-8% | TMK 8-12% | Niveli më i ulët | Niveli më i lartë | Niveli i sektorit | Niveli më i ulët | Niveli më i lartë | Niveli i sektorit | Në milionë | Si % e BPV-së | |
| Nivelet aktuale (para goditjeve) | 0 | 0 | 0 | 13.5% | 23.6% | 18.4% | 3.0% | 7.6% | 5.3% | | | |
| Rezultatet e makroskenarëve: | | | | | | | | | | | | |
| Skenari bazë | 0 | 0 | 1 | 11.9% | 22.6% | 18.1% | 4.6% | 12.2% | 9.8% | € | 0.24 | 0.00% |
| Kombinimi me rrezik të tregut | 0 | 0 | 1 | 11.1% | 21.9% | 17.4% | 4.6% | 12.2% | 9.8% | € | 1.60 | 0.03% |
| Dështimi i tre kredimarrësve | 1 | 0 | 1 | -4.5% | 20.5% | 17.2% | 6.5% | 61.2% | 11.9% | € | 12.36 | 0.21% |
| Dështimi i pesë kredimarrësve | 1 | 1 | 0 | -10.3% | 20.5% | 16.2% | 6.5% | 73.2% | 14.0% | € | 18.67 | 0.31% |

Shënim:1/ Nga nëntë bankat e konsideruara në analizën stres-test, numri i bankave të cilat bien nën nivelin e nevojshëm rregullator, i ndarë sipas kategorive.
Shënim: 2/ Në raportim të vlerave minimale dhe maksimale të indikatorëve në nivel të bankave, në disa raste janë përjashtuar vlerat e larta të TMK si dhe norma e KJP prej 0 përqind, të cilat karakterizojnë bankat në fillim të veprimtarisë.

Burimi: BQK (2016)

6.5.2. Vlerësimi i qëndrueshmërisë së sektorit bankar ndaj goditjeve në pozitën e likuiditetit

Metodologjia

Skenari bazë: Analiza e qëndrueshmërisë së sektorit bankar ndaj goditjeve në pozitën e likuiditetit mbështetet në skenarin bazë të tërheqjes së një vlere të theksuar të depozitave nga sektori bankar, duke vlerësuar kështu aftësinë e sektorit që të përballojë një tronditje të tillë. Më specifikisht, është konsideruar tërheqja e 8 përqind të depozitave në baza ditore, për pesë ditë radhazi, duke ndarë 5 përqind të depozitave të mbetura pas çdo dite për qëllime të operimit të bankës në ditët vijuese. Ndarja e 5 përqind të depozitave për qëllime operacionale nënkupton që, nën paraqitjen e skenarëve të supozuar, rezerva e detyrueshme prej 10 përqind do të përgjysmohej. Skenari po ashtu është ndërtuar mbi supozimin se gjatë kësaj periudhe mundësia e shndërrimit të mjeteve likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind e mjeteve likuide, përderisa mundësia e kthimit të mjeteve jo-likuide në para të gatshme do të ishte vetëm 1 përqind e këtyre mjeteve brenda ditës. Skenari në të cilin bazohet kjo analizë është mjaft konservativ edhe për faktin se nuk është marrë parasysh mundësia që bankat të plotësojnë një pjesë të nevojave të likuiditetit përmes burimeve të jashtme të financimit.

Skenarët shtesë: Krahas skenarit të lartpërmendur, si skenarë shtesë në analizën mbi rrezikun kreditor janë konsideruar edhe dështimi i depozitorëve më të mëdhenj në secilën prej bankave, si dhe niveli përbalues i tërheqjes së depozitave për secilën bankë para se të paraqitet nevoja për likuiditet shtesë.

Përfundimisht, qëndrueshmëria e sektorit bankar në këtë analizë është testuar në kuptim të vlerësimit të mjaftueshmërisë së aseteve likuide të bankave për të përballuar tërheqje mjaft të mëdha të depozitave si dhe mjaftueshmërinë e aseteve likuide për të përballuar rrezikun e mundshëm nga koncentrimi i depozitave.

Rezultatet

Spektori bankar i Kosovës u karakterizua me likuiditet të lartë edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2016, ku indikator kyç i likuiditetit (raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra) qëndroi në 41.1 përqind. Andaj, si rezultat i pozitës së mirë të likuiditetit, sektori bankar në tërësi tregoi aftësi të kënaqshme të përballimit të skenarëve të supozuar të tërheqjes së depozitave.

Rezultatet e skenarit bazë të tërheqjes së 8 përqind të depozitave në ditë, për pesë ditë radhazi, sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës do të fillonte të ketë nevojë për likuiditet shtesë vetëm në ditën e katërt, ku vetëm një bankë do të kishte mungesë të mjeteve likuide prej gjithsej 1.89 milionë euro (tabela 10). Në fund të ditës së pestë, problemet do të shfaqeshin edhe në katër banka të tjera, duke rritur në pesë numrin e bankave që do të kishin mungesë të mjeteve likuide për përballim të tërheqjeve të supozuara të depozitave. Shkalla e tërheqjes së përgjithshme të depozitave në ditën e pestë do të arrinte në 34.1 përqind, dhe shuma e mjeteve likuide shtesë të nevojshme për tejkalimin e problemeve të likuiditetit do të arrinte në 39.57 milionë euro (0.66 përqind e vlerës reale të BPV-së për vitin 2016).

Tabela 10. Përmbledhje e rezultateve të stres-testit: rreziku i likuiditetit

| Përshkrimi | Numri i bankave 1/ | Mjetet likuide shtesë të nevojshme (në milionë) | Kredi/Depozitë | Mjetet likuide shtesë të nevojshme si % e BPV-së |
|---------------------|--------------------|---|----------------|--|
| Pas ditës së parë | 0 | € - | 87.4% | 0.00% |
| Pas ditës së dytë | 0 | € - | 95.0% | 0.00% |
| Pas ditës së tretë | 0 | € - | 103.2% | 0.00% |
| Pas ditës së katërt | 1 | € 1.89 | 112.2% | 0.03% |
| Pas ditës së pestë | 5 | € 39.57 | 122.0% | 0.66% |

Shënim:1/ Nga nëntë bankat e konsideruara në analizën stres-test, numri i bankave të cilat bien nën nivelin e nevojshëm rregullator, i ndarë sipas kategorive

Burimi: BQK (2016)

Supozimi i dështimit të depozitorëve më të mëdhenj në secilën nga bankat paraqitet të mos jetë shqetësues për gjendjen e përgjithshme të likuiditetit në sektorin bankar. Rezultatet e këtij skenari sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës nuk ka koncentrim të theksuar të burimeve të financimit (depozitat si përbërësit kryesorë të detyrimeve). Prandaj, tërheqja e menjëhershme e të gjithë depozitorëve më të mëdhenj në secilën bankë nuk paraqet rrezik serioz për pozicionin e përgjithshëm të likuiditetit të sektorit bankar, ku shuma e mjeteve likuide shtesë të nevojshme për tejkalimin e problemeve të likuiditetit do të arrinte në 1.14 milionë euro.

Niveli përbalues i tërheqjes së depozitave për tërë sektorin bankar para se të shfaqen probleme me likuiditet rezulton të jetë 27.8 përqind, që nënkupton se sektori bankar mund të jetë në gjendje të përballojë tërheqjen e afër një të tretës (1/3) së gjithsej depozitave pa pasur nevojë për mjete likuide shtesë. Në këtë rast, nën supozimin që vlera e kredive nuk do të rritet, raporti kredi/depozita për sektorin bankar do të arrinte në 111.3 përqind. Po ashtu, nivelet përbaluese të tërheqjes së depozitave për secilën bankë para se të shfaqen probleme me likuiditet rezultojnë

të jenë të larta në përgjithësi. Banka me pragun më të ulët qëndron në 17.2 përqind, ndërsa ajo me pragun më të lartë qëndron në 42.5 përqind.

6.6. Infrastruktura Financiare në Kosovë

6.6.1. Sistemi i Pagesave

Sistemet e pagesave luajnë rol të rëndësishëm në sistemin financiar dhe ekonominë e një vendi, duke marrë parasysh që funksionimi efikas dhe i sigurt i tyre paraqet një faktor shumë të rëndësishëm në ruajtjen dhe promovimin e stabilitetit financiar të vendit. Në Kosovë funksionon një sistem i vetëm për pagesa ndërbankare, Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar (SEKN), operuar dhe mbikëqyrur nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Një ndër hapat me rëndësi që BQK ka ndërmarrë gjatë këtij viti në fushën e sistemit të pagesave është implementimi i një sistemi tërësisht të ri ndërbankar të pagesave, i quajtur ATS (Automat Transfer System/Sistem i Transferit Automatik). Ky sistem i cili nga data 1 korrik 2016 do të zëvendësojë sistemin ekzistues SEKN, përbëhet nga dy komponente të cilat do të mundësojnë transferimin e fondeve në kohë reale (komponenti RTGS) dhe procesimin e pagesave në grup dhe shuma të vogla (komponenti ACH).

Numri i transaksioneve të përpunuara nga SEKN gjatë gjysmës së parë të vitit 2016, arriti në 5.4 milionë (4.7 milionë deri në qershor 2015), duke shënuar rritje vjetore prej 16.1 përqind. Kurse, në të njëjtën periudhë, vlera e gjithsej transaksioneve arriti në 3.9 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 15.7 përqind. Mesatarja ditore e transaksioneve përmes SEKN arriti në 44.6 mijë, ndërsa vlera e tyre në 31.7 milionë euro.

Pagesat prioritare masive përfaqësojnë kategorinë me pjesëmarrjen më të lartë në numrin e transaksioneve të realizuara ndërbankare (tabela 11). Këto pagesa përfaqësojnë 37.7 përqind të gjithsej numrit të transaksioneve të realizuara dhe janë kryesisht pagesa nga institucionet qeveritare (siç janë pagat dhe pensionet). Më pas vijnë pagesat masive të rregullta, që kanë pjesëmarrje prej 36.8 përqind dhe janë kryesisht pagesa për institucionet qeveritare dhe pagesat xhiro që kanë një pjesëmarrje prej 13.2 përqind, dedikuar kryesisht pagesave të shërbimeve publike. Pagesat e letrave me vlerë, edhe pse kanë peshën më të vogël në numrin e gjithsej pagesave, janë pagesat të cilat kanë shënuar rritjen më të shpejtë në numër (786 deri në qershor 2016 nga 403 deri në qershor 2015).

Tabela 11. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SEKN-së, në përqindje

| Përshkrimi | Numri i gjithsej transaksioneve | | Vlera e gjithsej transaksioneve | |
|-----------------------|---------------------------------|--------------|---------------------------------|--------------|
| | Qershor 2015 | Qershor 2016 | Qershor 2015 | Qershor 2016 |
| Të rregullta | 10.5% | 11.8% | 46.6% | 46.0% |
| Prioritare | 0.3% | 0.2% | 10.0% | 8.1% |
| Të rregullta - masive | 39.1% | 36.8% | 8.5% | 8.2% |
| Prioritare - masive | 36.2% | 37.7% | 10.3% | 10.2% |
| Pagesat giro | 13.7% | 13.2% | 13.5% | 13.7% |
| Letrat me vlerë | 0.0% | 0.0% | 10.9% | 13.7% |
| Debitim direkt | 0.2% | 0.2% | 0.1% | 0.1% |

Burimi: BQK (2016)

Ndërsa sa i përket vlerës së transaksioneve, pagesat e rregullta paraqesin kategorinë kryesore të gjithsej vlerës së pagesave të realizuara me pjesëmarrje prej 46.0 përqind. Vlera e tyre arriti në 1.8 miliardë euro. Pagesat xhiro dhe letrat me vlerë kanë pjesëmarrje të njëjtë prej 13.7 përqind, dhe vlera e tyre arriti në 528.1 dhe 530.7 milionë euro, respektivisht. Pagesat prioritare masive

arritën vlerën prej 392.7 milionë euro, me pjesëmarrje prej 10.2 përqind në gjithsej vlerën e transaksioneve të realizuara. Ndërsa pagesat e rregullta masive arritën vlerën prej 317.4 milionë euro, pjesëmarrja e të cilave është 8.2 përqind.

Rritja më e theksuar e vlerës së transaksioneve u shënuar në letra me vlerë (46.1 përqind), pagesat xhiro (16.7 përqind) dhe pagesat e rregullta (14.3 përqind). Ndërsa rënie të vlerës së transaksioneve shënuan debitimi direkt (-9.0 përqind) dhe pagesat prioritare (-6.4 përqind).

Numri i gjithsej llogarive të vlefshme bankare³⁰ në qershor 2016 arriti në 1.94 milionë, që krahasuar me vitin paraprak paraqet një rritje prej 3.6 përqind.

Llogaritë bankare E-banking, përmes të cilave shërbimet bankare kryhen 'online', kanë vazhduar të rriten. Në qershor 2016 numri i gjithsej llogarive E-banking arriti në 215.2 mijë, duke shënuar rritje vjetore prej 30.8 përqind. Poashtu, numri dhe vëllimi i transaksioneve përmes shërbimit E-banking është rritur. Numri i gjithsej transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking arriti në 1.33 milionë deri në qershor 2016 (1.03 milionë deri në qershor 2015), përderisa vlera e gjithsej transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking arriti në 2.80 miliardë euro (2.44 miliardë deri në qershor 2015).

Struktura e llogarive E-banking vazhdon të dominohet nga llogaritë rezidente me një pjesëmarrje prej 97.8 përqind. Në kuadër të llogarive të rezidentëve, llogaritë individuale bankare përbëjnë 79.7 përqind të gjithsej llogarive përderisa pjesa e mbetur prej 20.3 përqind nga llogaritë afariste. Ngjashëm, struktura e llogarive të jo-rezidentëve dominohet nga llogaritë individuale me pjesëmarrje prej 91.6 përqind, përderisa llogaritë afariste kanë një pjesëmarrje prej 8.4 përqind.

Numri i gjithsej kartelave (kartela debiti dhe krediti) që ofrojnë shërbime për tërheqje të parave të gatshme dhe pagesa të ndryshme shënoi rritje vjetore prej 19.9 përqind në qershor 2016. Në kuadër të kartelave, numri i kartelave me funksion debiti arriti në 804,862 kurse me funksion krediti në 149,406. Numri i kartelave të debitit u karakterizua me rritje vjetore prej 22.2 përqind, përderisa kartelat e kreditit me rritje vjetore prej 8.9 përqind. Pjesëmarrjen më të lartë në kartelat e debitit dhe kreditit në qershor 2016 e kishin kartelat Visa (76.1 përqind përkatësisht 89.7 përqind), pasuar nga kartelat Master Card (21.6 përqind përkatësisht 9.4 përqind).

Infrastruktura bankare në vend është zgjeruar në kontekst të rrjetit të bankomatëve (angl. Automated Teller Machine: ATM) dhe pajisjeve POS (angl. Point-of-Sale). Numri i pajisjeve ATM dhe POS (që mundësojnë pagesat në pika të shitjes) shënuan rritje vjetore prej 5.7 përqind përkatësisht rritje prej 3.4 përqind në qershor 2016. Numri i ATM-ve të instaluar nga bankat komerciale në qershor 2016 ishte 534 përderisa numri i POS ishte 9,785 (tabela 12). Numri i tërheqjeve përmes ATM-ve arriti në 5.8 milionë (5.0 milionë deri në qershor 2015), me një qarkullim prej 718.3 milionë euro (533.6 milionë deri në qershor 2015). Në të njëjtën periudhë, numri i pagesave përmes pikave të shitjeve me kartela në терминаlet POS arriti në 3.2 milionë në vlerë prej 121.4 milionë euro.

Vlera e tërheqjes së parave përmes ATM-ve ndaj gjithsej transaksioneve me kartela arriti në 63.4 përqind në qershor 2016, që tregon për nivel të lartë të përdorimit të parasë së gatshme.

³⁰ Numri i gjithsej llogarive bankare përfshinë: numrin e llogarive rrjedhëse, të kursimit dhe të tjera në bankë.

Tabela 12. Rrjeti i sektorit bankar

| Përshkrimi | Qershor 2013 | Qershor 2014 | Qershor 2015 | Qershor 2016 |
|-------------------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Numri i degëve bankare | 43 | 44 | 45 | 45 |
| Numri i nëndegëve bankare | 253 | 226 | 219 | 207 |
| Numri i ATM-ve | 493 | 487 | 505 | 534 |
| Numri i POS-ve | 9,039 | 9,191 | 9,459 | 9,785 |
| Numri i llogarive 'e-banking' | 113,171 | 147,739 | 164,583 | 215,233 |

Burimi: BQK (2016)

Ndërsa, vlera e pagesave përmes POS ndaj gjithsej transaksioneve me kartela arrit në 10.7 përqind (tabela 13).

Tabela 13. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela, në përqindje

| Përshkrimi | Qershor 2013 | Qershor 2014 | Qershor 2015 | Qershor 2016 |
|------------------------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| ATM tërheqje në para të gatshme | 81.1% | 79.7% | 74.6% | 63.4% |
| ATM depozitime | 0.1% | 0.6% | 4.4% | 25.4% |
| Kredit transfere nëpërmjet ATM | 0.1% | 0.1% | 0.0% | 0.0% |
| Tërheqje cash në terminale POS | 1.7% | 1.3% | 0.9% | 0.5% |
| Pagesa me kartela në terminale POS | 17.1% | 18.3% | 20.1% | 10.7% |

Burimi: BQK (2016)

Përkundër pjesëmarrjes së lartë të tërheqjeve në para të gatshme në vlerën e përgjithshme të transaksioneve me kartela, krahasuar me vitet paraprake është shënuar një rënie e pjesëmarrjes. Rritja e numrit të ATM-ve, të cilët mundësojnë depozitimin e parave në llogaritë e klientëve, ka ndikuar që kjo kategori të rris pjesëmarrjen në 25.4 përqind nga 4.4 përqind sa ishte në qershor 2015.

7. Sektori Pensional

Vlera e aseteve të sektorit pensional në qershor 2016 arriti në 1.33 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 12.4 përqind (figura 99). Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) përfaqëson pjesën më të madhe të aseteve të sektorit (99.5 përqind), ndërsa pjesa e mbetur menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP) (tabela 14).

Tabela 14. Struktura e sektorit pensional

| Përshkrimi | Qershor 2012 | Qershor 2013 | Qershor 2014 | Qershor 2015 | Qershor 2016 |
|-----------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Kosovë | 99.3% | 99.4% | 99.4% | 99.5% | 99.5% |
| Slloveni-Kosovë | 0.7% | 0.6% | 0.6% | 0.5% | 0.5% |


Burimi: BQK (2016)

Asetet e FKPK-së arritën në 1.32 miliardë euro, duke shënuar normë vjetore të rritjes prej 12.4 përqind, krahasuar me rritjen vjetore prej 18.2 përqind të regjistruar në vitin 2015. Arkëtimet e reja shënuan rritje vjetore prej 11.4 përqind, krahasuar me rritjen 6.6 përqind në vitin paraprak. Vlera e tyre arriti në 74.1 milionë euro nga rreth 14.8 mijë kontribuues të rinj (figura 100).

Struktura e aseteve të FKPK-së vazhdon të dominohet nga investimet në tregun e jashtëm, të cilat kryesisht mbahen në formë të aksioneve dhe bonove të thesarit të qeverive të huaja. Megjithatë, vërehet tendencë e zhvendosjes së investimeve të FKPK-së nga ato jashtë vendit në investimet brenda vendit (figura 101). Kjo tendencë mund t'i atribuohet kthimit më të lartë të investimeve brenda vendit, në kohën kur kthimi i investimeve jashtë vendit është karakterizuar me rënie. Investimet jashtë vendit zvogëluan pjesëmarrjen në 81.1 përqind (89.5 përqind në qershor 2015), ndërsa investimet brenda vendit rritën pjesëmarrjen në 18.9 përqind (10.5 përqind në qershor 2015). Në kuadër të investimet brenda vendit, po ashtu kemi zhvendosje të pjesëmarrjes nga letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës, pesha e të cilave zbriti në 41.3 përqind (64.6 përqind në qershor 2015), në depozita në BQK me pjesëmarrje prej 56.2 përqind (35.4 përqind në qershor 2015) dhe çertifikata të depozitave në bankat komerciale me pjesëmarrje 2.4 përqind (pa pjesëmarrje në qershor 2015).


Në qershor 2016, vlera e gjithsej aseteve të FSKP-së arriti në 6.3 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 4.1 përqind (6.5 përqind në qershor 2015). Arkëtimet e reja, për dallim prej vitit

Figura 99. Asetet e sektorit pensional, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Figura 100. Kontributet e arkëtuara sipas fondeve pensionale




Burimi: BQK (2016)

të kaluar kur shënuan rënie vjetore, këtë vit rritën vlerën në 228.5 mijë euro nga 4,058 kontribues të rinj, që përkon me një rritje vjetore prej 16.4 përqind (figura 100).

Struktura e asetëve të FSKP-së po ashtu dominohet nga investimet jashtë vendit, kryesisht në formë të letrave me vlerë, aksioneve dhe letrave komerciale, të cilat në përgjithësi përbëjnë 95.9 përqind të gjithsej asetëve. Ndërsa, investimet në Kosovë janë të përfaqësuara me 4.1 përqind dhe janë të shpërndara në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës (81.6 përqind) dhe depozita (12.2 përqind). Duhet theksuar se investimet brenda vendit kanë shënuar rënie të pjesëmarrjes në vitin e fundit, duke vazhduar kështu trendin disa vjeçar të rënies së pjesëmarrjes së tyre në gjithsej asetet e fondit (figura 101).

Figura 101. Struktura e investimeve të sektorit pensionale, në përqindje



Burimi: BQK (2016)


Burimi: BQK (2016)

Performanca financiar e sektorit pensional

Sektori pensional shënoi performancë pozitive financiare në gjysmën e parë të vitit si rezultat i kthimit pozitiv në investime dhe ngritjes së çmimit të aksionit të dy fondeve pensionale.


Kthimi në investime i FKPK-së në qershor 2016 arriti vlerën 33.4 milion euro, që megjithatë është për 4.1 milion euro më i ulët se vitin paraprak (figura 102). Zvogëlimi i përgjithshëm i kthimit në investime ishte pasojë e performancës më të dobët të investimeve të FKPK-së në sektorin e jashtëm. Shkak për këtë performancë ishin lëkundjet e forta në tregjet financiare ndërkombëtare të ndikuara kryesisht nga rënia e çmimit të naftës gjatë muajve të parë të këtij viti dhe rezultati i papritur i referendumit në Mbretërinë e Bashkuar për dalje nga BE-ja. Përkundër këtyre zhvillimeve, FKPK mbylli ditën e fundit të qershorit 2016 me çmim më të lartë të aksionit krahasuar me vitin paraprak. Më saktësisht, çmimi i aksionit arriti në 1.347 euro në krahasim me 1.329 euro në qershor 2015.

Figura 102. Performanca financiare e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës



Burimi: BQK (2016)

Figura 103. Performanca financiare e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve



Burimi: BQK (2016)

Ngjashëm, edhe FSKP shënoi kthim pozitiv nga investimet. Në qershor 2016, kthimi bruto nga investimet arriti në 183.0 mijë euro, që është për 18.2 mijë euro më i lartë se kthimi i regjistruar

një vit më parë (figura 103). Gjithashtu, çmimi i aksionit të FSKP-së në ditën e fundit të qershorit 2016 ishte më i lartë se vitin paraprak, 148.4 euro krahasuar me 147.9 euro në qershor 2015.³¹

³¹ Vlera bazë e aksionit të FSKP-së është 100 për dallim nga ajo e FKPK-së që është 1.

8. Sektori i Sigurimeve

Struktura e sektorit të sigurimeve vazhdon të dominohet nga shërbimet e sigurimit ‘jo-jetë’ i cili përfaqëson 90.4 përqind të aseteve të tregut të sigurimeve, ndërsa pjesa e mbetur përbëhet nga asetet e kompanive të sigurimit ‘jetë’. Në tregun vendor operojnë 12 kompani që ofrojnë produkte të sigurimit ‘jo-jetë’, ndërsa tri kompani ofrojnë produkte të sigurimit ‘jetë’.

Kompanitë me pronësi të huaj vazhdojnë të dominojnë tregun. Megjithatë, gjatë gjashtëmuajt të parë të vitit 2016 u aprovua shitja e një kompanie me pronësi të huaj tek pronarët vendor, me ç’rast kemi rritje të numrit të kompanive vendore të sigurimit në gjashtë nga pesë sa ishin vitin paraprak.

Pjesëmarrja e aseteve të menaxhuara nga të huajt zbriti në 64.1 përqind të gjithsej aseteve nga 72.5 përqind një vit më parë. Sa i përket origjinës së pronësisë së huaj, 29.3 përqind e aseteve të sektorit janë në menaxhim të katër institucioneve me origjinë të kombinuar nga Austria dhe Shqipëria. Nga Sllovenia dhe Shqipëria veprojnë nga dy kompani të cilat menaxhojnë 13.6 përqind dhe 14.1 përqind, të aseteve të sektorit. Nga Turqia vepron një kompani e cila menaxhon 7.1 përqind të gjithsej aseteve të sektorit (figura 104).

Shkalla e koncentrimit të tregut në sektorin e sigurimeve mund të konsiderohet e ulët, sidomos në krahasim me shkallën e koncentrimit të tregut bankar. Indeksi Herfindahl-Hirschman i kalkuluar për asetet e kompanive të sigurimeve tregon 797 pikë në qershor 2016 (818 pikë në qershor 2015). Shprehur përmes pjesëmarrjes së tri kompanive më të mëdha në gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve, shkalla e koncentrimit qëndroi në 33.3 përqind që paraqet nivel të ngjashëm me vitin paraprak.

8.1. Aktiviteti i sektorit të sigurimeve

Asetet e sektorit të sigurimeve arritën vlerën 163.6 milionë, që përkon me një rritje vjetore prej 8.3 përqind (11.4 përqind në qershor 2016) (figura 105). Asetet e kompanive të sigurimeve ‘jo-jetë’

Figura 104. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve, sipas pronësisë




Figura 105. Asetet e sektorit të sigurimeve





Figura 106. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve, në përqindje



u rritën për 8.5 përqind (11.8 përqind në qershor 2015), përdërisa asetet në kuadër të sigurimit ‘jetë’ shënuan rritje vjetore prej 6.5 përqind (8.2 përqind në qershor 2015).

Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve vazhdoi të dominohet nga paraaja e gatshme dhe depozitat, të cilat megjithatë shënuan rënie të pjesëmarrjes në këtë periudhë. Nga 65 përqind në qershor 2015, pjesëmarrja e tyre u zvogëlua në 50.9 përqind të gjithsej aseteve në qershor 2016 (figura 106). Në anën tjetër, kategoria e aseteve financiare rriti pjesëmarrjen në 13.3 përqind nga pjesëmarrja prej 3.0 përqind në qershor 2015. Kategorinë e aseteve financiare e përbëjnë investimet e kompanive të sigurimit në letrat me vlerë të qeverisë së Kosovës, andaj dhe një pjesë e parasë së gatshme dhe depozitave mund të jetë zhvendosur në investime në letra me vlerë të qeverisë së Kosovës si pasojë e normave më të larta të interesit në këto të fundit.

Në kuadër të detyrimeve dhe burimeve vetanake, rezervat teknike kryesojnë strukturën e përgjithshme me pjesëmarrje prej 65.6 përqind, ndërsa në pjesën e mbetur bëjnë pjesë kapitali vetanak, detyrimet tjera dhe kreditë (figura 107). Rezervat teknike shënuan rritjen më të theksuar vjetore prej 25.2 përqind, pasuar nga detyrimet tjera që shënuan rritje vjetore prej 15.5 përqind. Në anën tjetër, kapitali vetanak shënoi rënie prej 19.4 përqind, ndikuar kryesisht nga humbja e kompanive të sigurimit.

Vlera e gjithsej primeve të shkruara të sektorit deri në qershor 2016 arriti në 41.1 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 1.9 përqind. Struktura e primeve të shkruara dominohet nga primet e sigurimit ‘jo-jetë’ të cilat përfaqësojnë 96.7 përqind të gjithsej primeve të shkruara. Në qershor 2016, këto prime arritën vlerën 39.7 milionë euro që përkon me një rritje vjetore prej 2.0 përqind. Pjesa e mbetur prej 3.3 përqind e gjithsej primeve të shkruara përbëhet nga primet e sigurimit ‘jetë’, të cilat shënuan rënie të lehtë vjetore prej 0.3 përqind (figura 108). Në kuadër të strukturës së gjithsej primeve të shkruara nuk pati ndryshime të mëdha. Kategoria e Përgjegjësive ndaj Palës së Tretë (PPT) vazhdon të jetë kategoria kryesore me pjesëmarrje mbi 50 përqind. Kategoritë që pësoan ndryshim më të theksuar të pjesëmarrjes ishin ajo e primeve për sigurim kufitar dhe ajo e aksidenteve personale dhe shëndetit (figura 109). Rënia e pjesëmarrjes së sigurimeve kufitare

Figura 107. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve, në përqindje






Figura 108. Primet bruto të arkëtuara, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Figura 109. Struktura e primeve bruto të shkruara



Burimi: BQK (2016)

në 5.3 përqind nga 13.3 në qershor 2015 është rezultat i rënies së theksuar të vlerës së primeve të shkruara gjatë kësaj periudhe (59.5 përqind më pak se vitin paraprak), si rrjedhojë e përgjysmimit të tarifave për policat e sigurimit kufitar të autopërgjegjësive të paguara kryesisht nga bashkatdhetarët që jetojnë në diasporë. Sa i përket ecurisë së kategorive tjera të primeve, rritjen më të madhe e shënuan kategoritë PPT+ (63.1 përqind), aksidentet personale dhe shëndeti (34.4 përqind) dhe kasko (27.4 përqind), përderisa kategoria kryesore PPT shënoi rritje vjetore prej 4.8 përqind.

Gjithsej dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) deri në qershor 2016 arritën vlerën 18.2 milionë euro, duke shënuar rënie vjetore prej 9.3 përqind (figura 110). Rënie vjetore më të lartë e kishin dëmet e paguara për sigurimet 'jo-jetë', 11.1 përqind, të ndikuara kryesisht nga rënia e dëmeve të paguara për produktin e detyrueshëm të autopërgjegjësive. Dëmet e paguara nga Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) regjistruan rënie vjetore prej 0.2 përqind. Ndërsa, pagesat për dëmet e paguara për sigurimet e jetës, të cilat kanë bazë të ulët, shënuan rritje duke dyfishuar vlerën e tyre vjetore (figura 111).

Rënia e dëmeve të paguara dhe rritja e vlerës së primeve të shkruara rezultoi në zvogëlim të raportit të gjithsej dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara. Në qershor 2016, ky raport zbriti në 44.3 përqind krahasuar me 49.8 përqind sa ishte në qershor 2015.

8.2. Performanca financiare e sektorit të sigurimeve

Indikatorët e performancës së sektorit të sigurimeve deri në qershor 2016 u përkeqësuan në krahasim me qershorin e vitit paraprak. Profiti negativ vazhdon të paraqes shqetësimin kryesor për sa i përket performancës së këtij sektori. Të hyrat neto të sektorit të sigurimeve gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 shënuan rënie vjetore prej 1.0 përqind, ndërsa shpenzimet shënuan rritje vjetore prej 24.0 përqind. Si rrjedhojë e kësaj, humbja e regjistruar nga sektori i sigurimeve gjatë kësaj periudhe u thellua në 11.5 milionë euro nga humbja prej 2.5 milionë deri në qershor 2015.³² Thellimi i humbjes ishte rrjedhojë e humbjes së shënuar në kuadër të sigurimit 'jo-jetë', përderisa performanca financiare e sigurimit jetë ishte pozitive. Deri në qershor 2016, sigurimi 'jo-jetë' shënoi humbje neto prej 11.7 milionë euro (humbje prej 2.8 milionë në qershor 2015), ndërsa sigurimi jetë regjistroi fitim neto në vlerë prej 186.2 mijë euro (236.3 mijë euro në qershor 2015). Humbjet e sigurimit 'jo-jetë' kryesisht i atribuohen rritjes së shpenzimeve për provizionet

Figura 110. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara, në milionë euro





Figura 111. Dëmet e paguara, në milionë euro



³² Bazuar në të dhënat e paaudituar.

teknike, kryesisht për kategorinë e PPT, dhe rritjes së dëmeve nga Fondi i Kompensimit, i cili i dedikohet mjeteve motorike të pasiguruara dhe paidentifikuar.

Rënia vjetore e parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj prej 15.3 përqind, dhe rritja prej 25.2 përqind e rezervave teknike të sektorit të sigurimeve ndikuan në zvogëlimin e nivelit të likuiditetit. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave zbriti në 77.6 përqind në qershor 2016 (114.6 në qershor 2015), përderisa raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve u zvogëlua në 68.4 përqind (99.0 në qershor 2015). Rënia e nivelit të likuiditetit, ndër tjera, reflekton edhe ndryshimin në strukturën e aseteve të kompanive të sigurimit, ku u regjistrua zhvendosje e një pjesë të investimeve që mbahej në formë të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj në drejtim të investimeve në letra me vlerë.

Raporti i kapitalizimit, i shprehur përmes raportit të borxhit në gjithsej detyrimet dhe kapitalin e sektorit, është përkeqësuar duke arritur në 74.3 përqind në qershor 2016 nga 65.6 përqind një vit më parë. Ngritja e raportit të borxhit në gjithsej detyrimet tregon për mbështetje më të lartë të sektorit në instrumente borxhi për financimin e aseteve, dhe njëherit nivel më të ulët të kapitalit si formë më e qëndrueshme e financimit.

9. Sektori mikrofinanciar dhe Ndhmësit Financiar


Sektori mikrofinanciar u karakterizua me rritje të përshpejtuar të aktivitetit, Asetet e sektorit arritën vlerën 136.0 milionë euro në qershor 2016, që korrespondon me rritje vjetore prej 16.9 përqind (figura 112). Në tregun vendor operojnë 18 institucione mikrofinanciare,³³ nga të cilat 13 kanë pronësi të huaj dhe përfaqësojnë 93.3 përqind të gjithsej aseteve të sektorit.

Indeksi Herfindahl-Hirschman i kalkuluar për asetet e sektorit mikrofinanciar tregoi 1,336 pikë në qershor 2016, që paraqet rritje të koncentrimin nga periudha e njëjtë e vitit paraprak (1,298 pikë). Ndërsa, pjesëmarrja e aseteve të tri institucioneve më të mëdha në gjithsej asetet e sektorit zbriti në 51.3 përqind nga 52.3 përqind sa ishte në qershor 2015.

9.1. Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar

Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar dominohet nga kreditë që përbëjnë 71.8 përqind të gjithsej aseteve të sektorit (67.0 përqind në qershor 2015). Kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha janë lizingjet me pjesëmarrje prej 16.2 përqind (19.8 përqind në qershor 2015) (figura 113).

Figura 112. Asetet e sektorit mikrofinanciar, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

³³ Këtu përfshihen edhe pesë institucione financiare jo-bankare që kryejnë aktivitete të kredidhënies, lizingut dhe faktoringut.


Në vitin e fundit, vërehet tendencë e ndryshimit të strukturës së aseteve të sektorit mikrofinanciar, me ç’rast lizingjet u karakterizuan me rënie të pjesëmarrjes ndërsa kreditë me rritje të pjesëmarrjes në gjithsej asetet. Sa i përket detyrimeve, aktiviteti i sektorit mikrofinanciar financohet kryesisht nga huamarrjet prej sektorit të jashtëm, të cilat përbëjnë 50.2 përqind të gjithsej detyrimeve dhe kapitalit. Gjatë këtij viti, huamarrjet nga sektori i jashtëm përshpejtuan rritjen vjetore në 9.4 përqind nga 0.4 përqind vitin paraprak, dhe arritën vlerën prej 68.2 milionë euro.

Kreditë

Vlera e gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar në qershor 2016 arriti në 97.6 milionë euro, që paraqet rritje të përshpejtuar vjetore prej 25.2 përqind krahasuar me 2.8 përqind në qershor 2015. Përshpejtimi i rritjes së kreditimit mund t’i atribuohet rritjes së burimit të financimit të institucioneve mikrofinanciare, kryesisht rritjes së financimit nga jashtë dhe kapitalit vetanak të ndikuar nga rritja e fitimit të mbajtur. Shuma mesatare e kredisë së aprovuar, shprehur si raport i gjithsej vlerës së kredive ndaj numrit të kredive, u ngrit në 2,661 euro në krahasim me shumën prej 2,280 euro në qershor 2015. Kjo u ndikua nga rritja më e shpejtë e vlerës së aprovuar të kredive në krahasim me rritjen më të ngadalshme të numrit të kredive, gjë që mund të sugjeroj për rritje të kapacitetit absorbues të huamarrësve.


Ngjashëm me sjelljen e kreditimit të sektorit bankar, edhe te IMF-të kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan normë më të lartë të rritjes, 28.7 përqind, krahasuar me kreditë ndaj ndërmarrjeve të cilat u rritën për 18.7 përqind. Kreditë ndaj ekonomive familjare në qershor 2016 përfaqësuan 67.0 përqind të gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar. Sipas afatit të maturimit, kreditë e ekonomive familjare me afat maturimi ‘mbi 2 deri në 5 vite’ në vazhdimësi kanë rritur pjesëmarrjen dhe këtë vit

Figura 113. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar, qershor 2016




Burimi: BQK (2016)

Figura 114. Kreditë e ekonomive familjare sipas maturitetit



Burimi: BQK (2016)

Figura 115. Struktura e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik, qershor 2016




Burimi: BQK (2016)

dominojnë strukturën e kredive sipas maturitimit për dallim nga vitet e kaluara ku dominonin kreditë ‘mbi 1 deri në 2 vite’ (figura 114).

Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike mbetet e ngjashme me periudhat paraprake. Për dallim nga sektori bankar, ku kreditë për bujqësinë paraqesin kategorinë me pjesëmarrjen më të ulët, tek institucionet mikrofinanciare bujqësia gëzon një mbështetje më të madhe duke përfaqësuar kategorinë më të madhe për nga pesha, me pjesëmarrje prej 28.5 përqind. Kategoritë tjera me qasje të lartë në financim mikrofinanciar janë kreditë e destinuar për shërbime tjera dhe kreditë për sektorin e ndërtimitarisë (figura 115).

Sa i përket ecurisë së kreditimit sipas sektorëve të ekonomisë, deri në qershor 2016 kreditë për sektorin e bujqësisë regjistruan rritjen më të lartë vjetore (figura 116). Rritje të theksuar të kreditimit kishte edhe sektori i industrisë dhe i shërbimeve të tjera. Ndërsa, kreditimi i sektorit të ndërtimitarisë shënoi ngadalësim të rritjes vjetore. Ngjashëm me kreditë e ekonomive familjare, kreditë e lëshuara për ndërmarrjet vazhdojnë të kenë kryesisht maturim ‘mbi 2 deri në 5 vite’, dhe pjesëmarrja e kredive të këtij maturiteti ka vazhduar trendin rritës ndër vite (figura 117).

Figura 116. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2016)


Lizingjet

Akviteti i lizingut në institucionet mikrofinanciare shënoi rënie. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar zbriti në 22.0 milionë euro, duke shënuar rënie vjetore prej 4.1 përqind (figura 118). Kontributin më të madh në rënie e gjithsej lizingjeve e kishin lizingjet për ndërmarrjet, vlera e të cilave ishte për 8.3 përqind më e ulët se në qershor 2015.

Lizingjet për ekonomitë familjare përbëjnë kategorinë kryesore me pjesëmarrje prej 54.0 përqind në strukturën e përgjithshme të lizingjeve (figura 119). Në kuadër të lizingjeve për ekonomitë familjare, lizingjet hipotekare shënuan një rënie të lehtë vjetore prej 0.1 përqind për dallim nga rritja vjetore prej 71.6 përqind në qershor 2015. Lizingjet tjera po ashtu regjistruan një rënie të lehtë vjetore prej 0.9 përqind në krahasim me rritjen vjetore prej 12.0 përqind një vit më parë. Lizingjet për ekonomitë familjare vazhdojnë


regjistruan rritjen më të lartë vjetore (figura 116). Rritje të theksuar të kreditimit kishte edhe sektori i industrisë dhe i shërbimeve të tjera. Ndërsa, kreditimi i sektorit të ndërtimitarisë shënoi ngadalësim të rritjes vjetore.

Figura 117. Kreditë e ndërmarrjeve sipas maturitetit



Burimi: BQK (2016)

Figura 118. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2016)

të dominohen nga lizingjet afatgjata ‘mbi 10 vite’ të cilat kanë pjesëmarrje prej 48.3 përqind, pasuar nga lizingjet me afat maturimi ‘mbi 5 deri në 10 vite’ me pjesëmarrje prej 38.9 përqind.


Në kuadër të lizingjeve për ndërmarrjet, lizingjet hipotekare shënuan rënie vjetore më të theksuar prej 36.2 përqind. Megjithatë, për shkak të bazës më të lartë, lizingjet për pajisje, të cilat shënuan rënie prej 34.7 përqind, kishin kontributin kryesor në rënie e gjithsej lizingjeve të ndërmarrjeve. Lizingjet tjera u karakterizuan me rënie të lehtë prej 1.5 përqind. Sipas maturitetit të lizingjeve për ndërmarrjet, pjesën më të madhe e përbëjnë lizingjet afatmesme ‘mbi 2 deri në 5 vite’ me pjesëmarrje prej 89.7 përqind, pasuar nga lizingjet me afat maturimi ‘mbi 1 deri në 2 vite’ me pjesëmarrje prej 9.0 përqind.

Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar shënoi rënie gjatë gjashtëmujorit të parë 2016, duke zbritur në nivelin më të ulët në tre vitet e fundit, përkatësisht në 21.9 përqind (figura 120). Me rënie të normës mesatare të interesit në kredi u karakterizua si sektori i ekonomive familjare, ashtu edhe ai i ndërmarrjeve.


Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare zbriti në 23.4 përqind në qershor 2016, nga 24.6 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kurse, mesatarja e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në qershor 2016 zbriti në 19.3 përqind nga 23.5 përqind në qershor 2015 (figura 120). Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i shërbimeve regjistroi normën mesatare të interesit më të ulët si rezultat i rënies më të theksuar prej 3.9 pikë përqindje. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të industrisë shënoi rënie, duke zbritur për 1.7 pp. Ndërsa, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë regjistroi nivel të ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit paraprak duke qëndruar në 25.0 përqind, që njëherit paraqet normën më të lartë të interesit për ndërmarrje (figura 121).

Figura 119. Struktura e lizingut, në përqindje




Burimi: BQK (2016)

Figura 120. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2016)

Figura 121. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2016)

9.2. Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektor i mikrofinanciar u karakterizua me përmirësim të performancës financiare në krahasim me tre vitet e fundit. Në qershor 2016, profiti i realizuar arriti vlerën prej 1.6 milionë euro, krahasuar me profitin prej 1.2 milionë euro në gjashtëmujorin e parë të vitit paraprak. Rritja e profitit ishte rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave në krahasim me rritjen që shënuan shpenzimet.


Të hyrat e sektorit mikrofinanciar shënuan rritje prej 16.0 përqind nga 7.1 përqind në qershor 2015. Të gjitha kategoritë e të hyrave shënuan rritje, mirëpo kontributin më të madh në rritjen e gjithsej të hyrave e kishin të hyrat nga interesi për shkak të peshës së tyre më të lartë. Shpenzimet apo ashtu shënuan rritje prej 13.6 përqind, për dallim nga rënia prej 5.6 përqind deri në qershor 2015 (figura 122). Të gjitha kategoritë e shpenzimeve gjithashtu u karakterizuan me rritje, mirëpo kontributin më të madh në rritjen e gjithsej shpenzimeve e kishin shpenzimet nga jo-interesi me rritje prej 9.7 përqind.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit mikrofinanciar ka shënuar përmirësim krahasuar me vitin e kaluar, si rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave të sektorit mikrofinanciar në krahasim me rritjen e shpenzimeve. Në qershor 2016, ky indikator u zvogëluar në 86.2 përqind, krahasuar me 88.0 përqind në vitin paraprak.

Profiti i realizuar deri në qershor 2016 ndikoi në përmirësimin e treguesve të profitabilitetit ku Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) arriti në 2.5 përqind (2.1 përqind në qershor 2015), ndërsa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) në 9.0 përqind (7.6 përqind në qershor 2015) (figura 123).


Sektor i mikrofinanciar vazhdon të karakterizohet me nivel relativisht të ulët të kredive joperformuese dhe nivel të kënaqshëm të provizioneve për mbulimin e kredive joperformuese. Në qershor 2016, pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej kreditë u zvogëluar në 4.3 përqind, në krahasim me normën prej 5.4 përqind sa ishte në qershor 2015, ndikuar kryesisht nga ritmi

Figura 122. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2016)

Figura 123. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



*Për vitin 2016 profiti është analizuar me performancën deri në qershor 2016
Burimi: BQK (2016)

Figura 124. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore



Burimi: BQK (2016)

më i lartë i rritjes së stokut të kredive krahas rritjes së vlerës së kredive joperformuese. Gjithashtu, mbulueshmëria me provizione u përmirësua konsiderueshëm në 159.7 përqind krahasuar me nivelin prej 109.5 përqind në qershor 2015 (figura 124).

9.3 Ndhmësit Financiar

Sektori i ndihmësve financiar përbëhet nga byrotë e këmbimit dhe agjensionet për transferim të parave (ATP). Ky sektor përbënë numrin më të madh të institucioneve financiare në vend, mirëpo menaxhon pjesën më të vogël të aseteve të sistemit financiar (0.2 përqind në qershor 2016). Vlera e aseteve të ndihmësve financiarë në qershor 2016 arriti në 12.5 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 23.9 përqind. Përkundër rritjes së aseteve, të hyrat e ndihmësve financiar shënuan rënie vjetore prej 4.7 përqind duke zbritur në 3.3 milionë euro. Struktura e të hyrave të ndihmësve financiar dominohet nga të hyrat nga transferet (pjesëmarrje 72.1 përqind në qershor 2016), të cilat u karakterizuan me rënie vjetore prej 5.6 përqind. Në anën tjetër, shpenzimet shënuan rritje vjetore prej prej 9.9 përqind duke arritur në 1.9 milionë euro. Rënia e të hyrave dhe rritja e shpenzimeve të sektorit ndikuan që neto fitimi të zbrësë në 1.4 milionë euro, rënie vjetore prej 19.5 përqind.

10. Shtojca statistikore

Tabela 1. Indikatorët e qëndrueshmërisë financiare, në përqind

| Sektori bankar | Grupi bazë i indikatorëve | Qershor 2013 | Qershor 2014 | Qershor 2015 | Qershor 2016 |
|--|--|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Mjaftueshmëria e kapitalit | Kapitali rregullativ ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut | 15.0 | 17.4 | 19.0 | 18.7 |
| | Kapitali i klasit të parë ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut | 12.2 | 13.5 | 15.9 | 16.4 |
| | Kreditë jo-performuese neto ndaj kapitalit | 7.3 | 5.9 | 3.1 | 2.7 |
| Cilësia e asetëve | Kreditë joperformuese ndaj totalit të kredive | 7.8 | 8.2 | 7.2 | 5.3 |
| Shpërndarja sektoriale e kredive ndaj totalit të kredive | Korporatat tjera financiare | 1.0 | 1.1 | 0.4 | 0.5 |
| | Korporatat publike jofinanciare | 0.02 | 0.01 | 0.03 | 0.10 |
| | Korporatat tjera jofinanciare | 67.0 | 66.4 | 66.4 | 64.4 |
| | Ekonomitë familjare | 30.8 | 31.5 | 33.1 | 35.0 |
| | QJSHF | 0.04 | 0.04 | 0.01 | 0.02 |
| | Jo-rezidente | 1.1 | 1.0 | 0.0 | 0.0 |
| | Gjithsej | 100.0 | 100.0 | 100.0 | 100.0 |
| Profitabiliteti | Kthimi në asete (KNA)* | 1.0 | 2.2 | 2.5 | 2.6 |
| | Kthimi në kapital (KNK)* | 10.6 | 22.5 | 21.6 | 20.8 |
| | Margjina e interesit ndaj të hyrave bruto | 74.0 | 74.5 | 76.4 | 74.4 |
| | Shpenzimet e jo-interesit ndaj të hyrave bruto | 82.0 | 68.8 | 52.7 | 47.1 |
| Likuiditeti | Asetet likuide (bazë) ndaj totalit të asetëve | 21.9 | 23.0 | 22.9 | 26.6 |
| | Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj totalit të asetëve | 29.3 | 32.4 | 28.8 | 31.9 |
| | Asetet likuide (bazë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra | 27.9 | 29.2 | 29.0 | 34.4 |
| | Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra | 37.3 | 41.2 | 36.5 | 41.3 |
| Senzitiviteti ndaj riskut të tregut | Pozicionet neto të hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit | 0.3 | 2.4 | 0.8 | 1.7 |
| Grupi i zgjeruar i indikatorëve | | | | | |
| | Kapitali ndaj asetëve | 10.5 | 10.1 | 11.7 | 12.3 |
| | Ekspozimi kreditor ndaj kapitalit | 79.0 | 89.6 | 77.1 | 48.1 |
| | Shpenzimet e personelit ndaj shpenzimeve nga jointeresi | 39.2 | 38.5 | 38.1 | 41.3 |
| | Dallimi në mes të normës së interesit për kredi dhe depozita | 8.5 | 10.0 | 6.8 | 6.2 |
| | Depozitat e klientëve ndaj totalit të kredive (jo ndërbankare) | 116.3 | 124.4 | 126.0 | 120.4 |
| | Detyrimet në valutë të huaj ndaj gjithsej të detyrimeve | 4.6 | 4.7 | 3.7 | 4.5 |

*Anualizuar për qershor 2016, janë konsideruar të hyrat neto para taksës.
Udhëzuesi: Financial Soundness Indicators, Compilation Guide, IMF (2006)

Tabela 2. Bilancet e gjendjes së bankave komerciale, qershor 2016, në milionë euro

Raiffeisen Bank

(Në milionë euro)

| Asetet | | Detyrimet | |
|-------------------------------------|--------------|--|--------------|
| Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK | 86.9 | Bilanci nga bankat tjera | 2.1 |
| Bilanci me bankat komerciale | 57.0 | Depozitat | 693.7 |
| Letrat me vlerë | 214.1 | Huamarrjet tjera | - |
| Kreditë | 506.2 | Detyrimet tjera | 47.3 |
| Asetet fikse | 8.3 | Borxhi i ndërvuarur | 19.3 |
| Asetet tjera | 2.5 | Burimet vetanake | 112.6 |
| GJITHSEJ ASETET | 875.1 | GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE | 875.1 |

Burimi: BQK (2016)

Procredit Bank

(Në milionë euro)

| Asetet | | Detyrimet | |
|-------------------------------------|--------------|--|--------------|
| Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK | 121.3 | Bilanci nga bankat tjera | 0.5 |
| Bilanci me bankat komerciale | 60.6 | Depozitat | 647.0 |
| Letrat me vlerë | 103.5 | Huamarrjet tjera | 10.0 |
| Kreditë | 471.2 | Detyrimet tjera | 29.0 |
| Asetet fikse | 16.7 | Borxhi i ndërvuarur | 7.5 |
| Asetet tjera | 8.7 | Burimet vetanake | 88.0 |
| GJITHSEJ ASETET | 781.9 | GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE | 781.9 |

Burimi: BQK (2016)

NLB Prishtina

(Në milionë euro)

| Asetet | | Detyrimet | |
|-------------------------------------|--------------|--|--------------|
| Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK | 49.6 | Bilanci nga bankat tjera | 4.1 |
| Bilanci me bankat komerciale | 33.2 | Depozitat | 402.2 |
| Letrat me vlerë | 53.8 | Huamarrjet tjera | 0.1 |
| Kreditë | 347.3 | Detyrimet tjera | 34.9 |
| Asetet fikse | 11.9 | Borxhi i ndërvuarur | - |
| Asetet tjera | 2.6 | Burimet vetanake | 57.0 |
| GJITHSEJ ASETET | 498.4 | GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE | 498.4 |

Burimi: BQK (2016)

TEB Bank

(Në milionë euro)

| Asetet | | Detyrimet | |
|-------------------------------------|--------------|--|--------------|
| Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK | 59.4 | Bilanci nga bankat tjera | 42.6 |
| Bilanci me bankat komerciale | 15.7 | Depozitat | 313.0 |
| Letrat me vlerë | 14.2 | Huamarrjet tjera | - |
| Kreditë | 353.4 | Detyrimet tjera | 29.6 |
| Asetet fikse | 5.5 | Borxhi i ndërvarur | 4.5 |
| Asetet tjera | 5.0 | Burimet vetanake | 63.5 |
| GJITHSEJ ASETET | 453.1 | GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE | 453.1 |

Burimi: BQK (2016)

Banka Kombëtare Tregtare

(Në milionë euro)

| Asetet | | Detyrimet | |
|-------------------------------------|--------------|--|--------------|
| Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK | 35.5 | Bilanci nga bankat tjera | 0.2 |
| Bilanci me bankat komerciale | 52.7 | Depozitat | 254.1 |
| Letrat me vlerë | 34.9 | Huamarrjet tjera | 8.6 |
| Kreditë | 173.8 | Detyrimet tjera | 17.2 |
| Asetet fikse | 2.4 | Borxhi i ndërvarur | 0.0 |
| Asetet tjera | 4.3 | Burimet vetanake | 23.5 |
| GJITHSEJ ASETET | 303.6 | GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE | 303.6 |

Burimi: BQK (2016)

Banka Ekonomike

(Në milionë euro)

| Asetet | | Detyrimet | |
|-------------------------------------|--------------|--|--------------|
| Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK | 29.6 | Bilanci nga bankat tjera | 2.3 |
| Bilanci me bankat komerciale | 7.0 | Depozitat | 167.4 |
| Letrat me vlerë | 16.8 | Huamarrjet tjera | 0.0 |
| Kreditë | 140.0 | Detyrimet tjera | 10.5 |
| Asetet fikse | 6.5 | Borxhi i ndërvarur | 1.0 |
| Asetet tjera | 0.9 | Burimet vetanake | 19.6 |
| GJITHSEJ ASETET | 200.8 | GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE | 200.8 |

Burimi: BQK (2016)

Banka për Biznes

(Në milionë euro)

| Asetet | | Detyrimet | |
|-------------------------------------|--------------|--|--------------|
| Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK | 30.5 | Bilanci nga bankat tjera | 1.0 |
| Bilanci me bankat komerciale | 7.3 | Depozitat | 120.3 |
| Letrat me vlerë | 4.6 | Huamarrjet tjera | 0.0 |
| Kreditë | 102.5 | Detyrimet tjera | 7.1 |
| Asetet fikse | 1.1 | Borxhi i ndërruarur | 5.8 |
| Asetet tjera | 1.4 | Burimet vetanake | 13.0 |
| GJITHSEJ ASETET | 147.3 | GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE | 147.3 |

Burimi: BQK (2016)

Komerçijalna Banka

(Në milionë euro)

| Asetet | | Detyrimet | |
|-------------------------------------|-------------|--|-------------|
| Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK | 6.7 | Bilanci nga bankat tjera | 0.0 |
| Bilanci me bankat komerciale | 50.4 | Depozitat | 53.8 |
| Letrat me vlerë | 0.0 | Huamarrjet tjera | 0.0 |
| Kreditë | 3.3 | Detyrimet tjera | 0.6 |
| Asetet fikse | 0.0 | Borxhi i ndërruarur | 0.0 |
| Asetet tjera | 1.2 | Burimet vetanake | 7.1 |
| GJITHSEJ ASETET | 61.5 | GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE | 61.5 |

Burimi: BQK (2016)

Türkiye İş Bankası

(Në milionë euro)

| Asetet | | Detyrimet | |
|-------------------------------------|-------------|--|-------------|
| Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK | 10.0 | Bilanci nga bankat tjera | 32.3 |
| Bilanci me bankat komerciale | 1.3 | Depozitat | 24.6 |
| Letrat me vlerë | 5.2 | Huamarrjet tjera | 0.0 |
| Kreditë | 49.9 | Detyrimet tjera | 1.4 |
| Asetet fikse | 1.0 | Borxhi i ndërruarur | 0.0 |
| Asetet tjera | 0.3 | Burimet vetanake | 9.4 |
| GJITHSEJ ASETET | 67.6 | GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE | 67.6 |

Burimi: BQK (2016)

Ziraat Bank

(Në milionë euro)

| Asetet | | Detyrimet | |
|-------------------------------------|-------------|--|-------------|
| Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK | 3.8 | Bilanci nga bankat tjera | 5.0 |
| Bilanci me bankat komerciale | 0.6 | Depozitat | 3.4 |
| Letrat me vlerë | 6.0 | Huamarrjet tjera | 0.0 |
| Kreditë | 5.9 | Detyrimet tjera | 0.1 |
| Asetet fikse | 1.2 | Borxhi i ndërvuarur | 0.0 |
| Asetet tjera | 0.0 | Burimet vetanake | 8.9 |
| GJITHSEJ ASETET | 17.5 | GJITHSEJ DETYRIMET DHE BURIMET VETANAKE | 17.5 |

Burimi: BQK (2016)

Tabela 3.1. Pasqyra e korporatave financiare - asetet e jashtme neto dhe kërkesat e brendshme

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

| Përshkrimi | Asetet e jashtme neto | | | | | | | | Kërkesat e brendshme | | | | | | | |
|--------------|----------------------------|----------------|----------------------------------|--------------------------|-----------------|--------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------|---------------------------------|----------------------------------|-------------------------------|-----------------|---------|---------|-------|
| | Kërkesat ndaj jorzidentëve | | | | | | | Detyrimet ndaj jorzidentëve | Kërkesat ndaj qeverisë | | | Kërkesat ndaj sektorëve tjerë | Kreditë | | | |
| | Ari monetar dhe DST-të | Depozita | Letrat me vlerë përveç aksioneve | prej të cilave: | | Kuota në FMN | Asetet dhe ekuivalente tjera | | Kërkesat ndaj qendrore | Kërkesat ndaj qeverisë qendrore | Detyrimet ndaj qeverisë qendrore | | prej të cilave: | | | |
| | | | | Korporat. tjera jofinan. | Ekon.fami-ljare | | | | | | | | | | | |
| 2007 | 1,622.4 | 1,704.6 | — | 955.0 | 408.9 | — | 175.4 | 82.3 | 124.5 | -853.3 | — | 853.3 | 977.8 | 965.9 | 765.1 | 200.6 |
| 2008 | 1,593.1 | 1,726.7 | — | 795.1 | 661.6 | — | 128.2 | 133.6 | 419.6 | -871.8 | — | 871.8 | 1,291.5 | 1,276.8 | 995.7 | 281.0 |
| 2009 | 1,700.5 | 2,036.2 | 60.3 | 910.1 | 724.5 | 64.3 | 144.3 | 335.7 | 571.5 | -846.3 | — | 846.3 | 1,417.8 | 1,396.1 | 1,052.3 | 343.5 |
| 2010 | 1,935.4 | 2,365.6 | 64.0 | 1,235.7 | 525.2 | 68.5 | 269.3 | 430.2 | 788.9 | -802.7 | 22.1 | 824.8 | 1,591.6 | 1,568.3 | 1,127.7 | 434.2 |
| 2011 | 2,047.3 | 2,425.6 | 65.1 | 1,338.9 | 230.0 | 70.1 | 533.1 | 378.2 | 998.8 | -778.0 | 20.5 | 798.4 | 1,785.8 | 1,785.8 | 1,242.1 | 514.6 |
| 2012 Shtator | 2,203.5 | 2,618.6 | 65.0 | 1,030.9 | 598.8 | 70.7 | 622.1 | 415.1 | 1,083.8 | -750.7 | 171.7 | 922.3 | 1,834.5 | 1,809.6 | 1,260.9 | 546.3 |
| Dhjetor | 2,224.1 | 2,660.4 | 63.3 | 1,147.7 | 486.0 | 68.8 | 666.5 | 436.3 | 1,195.5 | -651.7 | 186.8 | 838.5 | 1,847.2 | 1,819.4 | 1,271.3 | 546.3 |
| 2013 Mars | 2,263.4 | 2,708.3 | 63.3 | 1,076.5 | 515.7 | 69.0 | 734.5 | 444.8 | 1,1225.0 | -638.7 | 187.0 | 825.7 | 1,863.8 | 1,838.7 | 1,287.5 | 549.8 |
| Qershor | 2,240.6 | 2,681.0 | 61.9 | 896.6 | 646.2 | 67.8 | 777.9 | 440.4 | 1,222.8 | -686.6 | 222.9 | 909.5 | 1,909.4 | 1,882.0 | 1,314.8 | 566.1 |
| Shtator | 2,429.1 | 2,891.2 | 60.7 | 870.4 | 826.8 | 66.8 | 816.9 | 462.1 | 1,207.2 | -671.8 | 242.8 | 914.6 | 1,879.0 | 1,853.2 | 1,291.5 | 560.6 |
| Dhjetor | 2,452.7 | 2,908.3 | 59.6 | 1,037.9 | 818.7 | 65.9 | 651.2 | 455.6 | 1,369.1 | -515.0 | 258.9 | 774.0 | 1,884.2 | 1,859.9 | 1,291.1 | 567.7 |
| 2014 Mars | 2,489.0 | 2,975.3 | 59.5 | 1,000.6 | 899.8 | 66.2 | 660.9 | 468.2 | 1,389.6 | -517.3 | 293.5 | 810.8 | 1,906.9 | 1,883.2 | 1,313.4 | 568.5 |
| Qershor | 2,426.7 | 2,900.3 | 59.9 | 943.2 | 803.3 | 66.9 | 752.4 | 473.6 | 1,495.2 | -478.6 | 332.2 | 810.8 | 1,973.8 | 1,949.3 | 1,351.3 | 597.0 |
| Shtator | 2,599.8 | 3,058.1 | 61.6 | 1,142.9 | 574.9 | 69.1 | 967.4 | 458.2 | 1,474.6 | -488.3 | 327.8 | 816.1 | 1,962.9 | 1,939.2 | 1,325.5 | 613.4 |
| Dhjetor | 2,546.6 | 3,011.6 | 62.5 | 1,313.0 | 315.7 | 70.4 | 1,024.4 | 465.0 | 1,609.0 | -386.7 | 349.2 | 735.9 | 1,995.8 | 1,971.5 | 1,345.5 | 625.3 |
| 2015 Mars | 2,661.0 | 3,147.3 | 66.5 | 1,363.5 | 329.0 | 75.3 | 1,078.7 | 486.3 | 1,634.4 | -386.0 | 374.9 | 760.9 | 2,020.4 | 1,991.9 | 1,361.8 | 629.3 |
| Qershor | 2,551.4 | 3,047.3 | 65.4 | 1,212.9 | 400.3 | 74.4 | 1,055.8 | 495.9 | 1,761.4 | -365.4 | 400.2 | 763.1 | 2,126.8 | 2,096.8 | 1,431.4 | 664.6 |
| Shtator | 2,643.6 | 3,154.5 | 64.5 | 1,303.7 | 396.4 | 74.0 | 1,045.6 | 510.9 | 1,717.8 | -399.9 | 449.8 | 849.7 | 2,117.7 | 2,086.6 | 1,417.7 | 668.2 |
| Dhjetor | 2,637.1 | 3,160.3 | 65.1 | 1,271.6 | 378.2 | 75.1 | 1,086.3 | 523.2 | 1,837.9 | -305.3 | 454.3 | 759.6 | 2,143.2 | 2,114.8 | 1,416.3 | 697.7 |
| 2016 Mars | 2,672.1 | 3,239.9 | 56.2 | 1,106.4 | 592.4 | 103.4 | 1,083.7 | 567.3 | 1,863.9 | -337.9 | 470.3 | 808.2 | 2,201.8 | 2,170.7 | 1,451.1 | 717.6 |
| Qershor | 2,673.0 | 3,248.0 | 56.2 | 952.0 | 759.6 | 104.1 | 1,077.4 | 575.0 | 1,944.9 | -359.8 | 467.3 | 827.1 | 2,304.7 | 2,274.9 | 1,508.1 | 764.7 |

Burimi: BQK (2016)

Tabela 3.2. Pasqyra e korporatave financiare - detyrimet

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

| Përshkrimi | Depozitat | | | | | | | | | Kreditë | Rezervat teknike të sigurimit | | | Asetet dhe ekuitete tjera | Zëra tjerë (neto) |
|--------------|----------------------------|-------------------------|---------------------|----------------|----------------|-----------------------------|---------------------------|------------------|--|---------|--------------------------------|----------------|--------------|---------------------------|-------------------|
| | Depozitat e transferueshme | prej të cilave: | | | Depozita tjera | prej të cilave: | | | Ekuiteti neto i ekonomive familjare ne fondet e pension. | | Pagesa e premive dhe rezervave | | | | |
| | | Korp. publike jofinanc. | Korp. tjera financ. | Eko. familjare | | Korpo. publike jofinanciare | Korpo. tjera jofinanciare | Ekono. familjare | | | | | | | |
| 2007 | 1,110.9 | 386.1 | 49.6 | 133.5 | 187.5 | 724.8 | 188.4 | 43.8 | 489.3 | ... | 316.1 | 286.2 | 29.9 | 273.8 | 46.0 |
| 2008 | 1,351.9 | 390.9 | 15.4 | 176.0 | 186.2 | 961.0 | 250.1 | 51.4 | 656.7 | ... | 288.6 | 256.3 | 32.3 | 311.1 | 61.1 |
| 2009 | 1,444.3 | 483.2 | 50.1 | 184.0 | 237.7 | 961.0 | 73.9 | 82.9 | 801.9 | ... | 422.3 | 380.8 | 41.5 | 326.1 | 79.3 |
| 2010 | 1,744.2 | 621.2 | 83.8 | 218.6 | 303.5 | 1,123.1 | 42.8 | 83.4 | 995.9 | ... | 540.5 | 493.7 | 46.8 | 361.0 | 78.6 |
| 2011 | 1,933.6 | 658.4 | 68.1 | 208.1 | 360.9 | 1,275.1 | 60.8 | 79.7 | 1,129.6 | ... | 647.8 | 593.3 | 54.5 | 389.7 | 75.0 |
| 2012 Shtator | 2,004.5 | 667.2 | 16.1 | 245.0 | 384.1 | 1,337.3 | 63.3 | 74.1 | 1,195.7 | ... | 767.8 | 708.1 | 59.7 | 397.2 | 117.9 |
| Dhjetor | 2,076.6 | 700.2 | 13.8 | 257.5 | 407.2 | 1,376.5 | 61.8 | 78.2 | 1,232.9 | ... | 814.9 | 745.1 | 69.8 | 399.2 | 128.9 |
| 2013 Mars | 2,077.8 | 692.3 | 19.1 | 234.4 | 415.8 | 1,385.5 | 50.9 | 74.2 | 1,255.5 | ... | 866.8 | 800.3 | 66.2 | 403.6 | 140.0 |
| Qershor | 2,048.9 | 698.9 | 16.0 | 231.8 | 425.2 | 1,350.1 | 48.8 | 75.4 | 1,221.3 | ... | 880.0 | 808.8 | 41.2 | 398.0 | 137.0 |
| Shtator | 2,169.0 | 761.8 | 14.4 | 270.8 | 450.9 | 1,407.2 | 72.9 | 73.6 | 1,255.6 | ... | 932.2 | 859.5 | 72.7 | 397.5 | 137.6 |
| Dhjetor | 2,275.3 | 848.0 | 16.4 | 299.6 | 506.6 | 1,427.3 | 55.7 | 98.2 | 1,268.4 | ... | 990.3 | 919.0 | 71.3 | 403.9 | 152.4 |
| 2014 Mars | 2,255.3 | 873.1 | 39.9 | 260.9 | 536.1 | 1,382.2 | 42.5 | 79.2 | 1,255.6 | ... | 1,026.9 | 954.3 | 72.6 | 415.8 | 180.7 |
| Qershor | 2,243.3 | 917.9 | 33.3 | 256.3 | 602.7 | 1,325.3 | 58.2 | 67.7 | 1,194.3 | ... | 1,078.2 | 1,002.6 | 75.6 | 419.5 | 180.8 |
| Shtator | 2,329.2 | 1,047.3 | 32.5 | 300.9 | 683.8 | 1,281.9 | 53.9 | 75.3 | 1,150.2 | ... | 1,123.4 | 1,044.6 | 78.8 | 441.4 | 180.5 |
| Dhjetor | 2,354.4 | 1,134.6 | 21.1 | 338.4 | 743.5 | 1,219.8 | 51.6 | 58.0 | 1,104.8 | ... | 1,173.8 | 1,094.1 | 79.7 | 453.2 | 175.8 |
| 2015 Mars | 2,380.8 | 1,184.9 | 30.9 | 306.0 | 818.7 | 1,196.0 | 37.8 | 66.6 | 1,086.5 | ... | 1,256.3 | 1,175.0 | 81.3 | 479.8 | 178.5 |
| Qershor | 2,393.0 | 1,217.7 | 10.9 | 335.3 | 841.8 | 1,175.3 | 36.7 | 72.4 | 1,062.8 | ... | 1,270.0 | 1,184.3 | 85.7 | 484.3 | 165.5 |
| Shtator | 2,466.9 | 1,342.9 | 21.8 | 386.4 | 897.6 | 1,124.0 | 24.1 | 60.0 | 1,037.1 | ... | 1,253.6 | 1,163.7 | 89.8 | 496.0 | 144.8 |
| Dhjetor | 2,514.6 | 1,378.4 | 11.2 | 413.8 | 919.0 | 1,136.3 | 20.6 | 68.3 | 1,046.8 | ... | 1329.6 | 1,237.3 | 92.3 | 530.5 | 100.2 |
